

ANASTAS KONDO

BIBLIOTEKA

85H-32

K87

**KUR MBARON
DHE KUR
VDES BURRI**

8SH-32

K 87

Anastas
Kondo

KUR
MBARON
DHE
KUR
VDES
BURRI

SHKURTËJA E MËDHE
SHKURTËJA E MËDHE
008 SH
45800

Tregime
novela
dhe
përshkrime

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Kur mbaron dhe kur vdes burri

1

Bon Duka i parë dhe Bon Duka i dytë qe në fshatarë. Boni i parë lalëzoti ka këngën e vet, që i mbeti dhe këndohet dhe sot e kësaj dite, qysh kur vrau mylazimin. Ai ka hyrë në pllakën e gurtë të kujtesës së popullit, në folklor, dhe mbeti i pavdekshëm. Ju mbase e njihni këngën e tij, ndoshta e keni dëgjuar diku. Po mbase dhe s'dini gjë fare për të a, kushedi, dhe në keni pasur rast ndonjëherë ta dëgjoni, e keni harruar. Për ata që s'dinë erësëgjeri për të dhe për ata që nuk e mbajnë mend, unë po e kujtoj. Kënga thotë:

*Të shtunë, shtatë sahati,
Në bregdet u bë fesati,
U vra Mylazim Berati,
Meshollë e mustaqegjati,
E theri Bon Duk xhelati!*

Bon Duka i parë nuk ishte dukë, as i mirë e as i keq, qe fshatar i lirë, që s'duronte dot tak-sat as për vete e as për fshatin. Ndaj e vrau oficerin osman. Jo se kishte hall se mos i merrte ofiqet. Ofiqi i vetëm i tij ishte të qe njeri i lirë. Nuk ishte, pra, as xhelat e as kasap. U bë detar, si mori aratinë pas vrasjes që kreu. Kur u bë me djalë, domethënë kur lindi babai i Bon Dukës së dytë, kaloi e jetoj në stere. U kthye në origjinë nga halli e jo nga malli. Deti është për beqarët e toka për familjarët. Ishte viti që dhe Turqia s'ishte më Turqi tamam dhe s'kishte si merrte hak më. Plaku i Vlorës kish shpallur më-vetësinë e Shqipërisë.

Burri plak i kthyer në stere filloi të shtypte fort ullinjtë në letërvë e nxirrte vaj flori të verdhë dhe, kur i dilte hesapi e fali në derë, pinte dhe një kartuç verë me koce Dukati.

Nga i kish mbetur ky emër i fismë, as ai dhe as Bon Duka i parë nuk dinin gjë. Të parin nuk e kam njohtur, se s'kisha lërë edhe kur ie-tonte ai. Të dytin Bon e kisha mik për kokë dhe sa nër emrin, niëherë, kur e pata cingrisur, më tha, si ata fëmiët e zënë në fai, se «emër si gjithë bota. Ja, dhe deles i thonë beikë, por s'është nga soj beilerësh. Edhe mua më thërrasin Dukë, por siam fis e as gjak kontësh. Kështu është puna me emrin. Vetë nuk e zgjedhim dhe

vetë nuk e heqim dot. Ta dhanë, mbaje! E ke peshqesh për tërë jetën. Halli është që ta mbash me nder. Lalëzoti e mbajti hak, pati fat. Kurse unë sa të më punojë këmba e dora, kam kohë të turpërohem, sado plak qofsha!»

Dhe ja, para një jave, mora telegramin që Bon Duka i riu vdiq. Bon Duka i riu jetoi shumë. Dhe jam i bindur që nuk iku me merakun në shpirt se qysh u nda nga kjo botë, i nderuar apo i harruar, sesa për i turpëruar, jo e jo!

E kisha mik. Më besoni, në nuk paçi provuar, që miqësitë nuk lidhen gjithnjë vetëm me moshatarët a vërsnikët e tu. Ne kishim lerë gati gjysmë shekulli larg njëri-tjetrit e, megjithatë, e pata mik për ditë gëzimi e hidhërimi dhe përgjërohesh me miqësinë e tij, si unë e mosnjeri. Kur u njohëm bashkë, njëzet vjet të shkuar, ai s'kishte ç'të përfitonte nga unë, qeshë djalë i ri e pa vënë brisk në faqe. Kurse unë po! Përfitova pa hesap. Duke pasur mik atë, pata mik jetën dhe detin. Pasuri që s'ka kalem ta shkruajë.

U nisa atë çast nga Kapinova e Beratit. S'mund të rrija gjatë në vela. Ngjithnim e zbritnim çdo ditë, pa dirë e pa ngrysur dita, malin e lartë të Tomorit. Qoftë i bekuar ai mal, që ka hije e uië të ftohtë si Tomori! Lodheshja çdo ditë aq shumë, sa kur mbaruam ekspeditën e stratigrafisë së gëlqerorëve të tij, mbas dy muajsh. kisha humbur pesëmbëdhjetë kile peshë. Kjo është e vërteta e pacme, nuk shtoj gjë nga xhepi. Në malet tona vështirësitë e ekspeditave gjeologjike i kam matur gjithnjë me kilogramë peshë të gjallë të ulur. Mbas Çikës e Korabit

Tomori është më i rëndi. Por edhe më i bukuri në shokë, jo se i këndoi Naimi i dhembshur e Çajupi i mençur, por se e kam provuar vetë mikpritjen e tij.

Pra, u mora lejë shpejt shokëve, kolegëve pedagogë të fakultetit, u ndava me studentët, u gatita rrët e fët dhe u nisa për në Bregdet, që të ngushëlloja për vdekjen e hidhur të mikut tim.

Në varrim isha i bindur që s'arrija dot, dhe vërtet nuk arrita. E kishin kallur një ditë më parë. Më pritën djemtë dhe nipat e tij. Një tabor me meshkuj.

Miku im i vdekur prehej në Shën Spiridhon me të vdekurit, unë rrija me filxhanin e kafesë në dorë në dhomën e zjarrit të Bon Dukës. Ishim vetëm burra, gratë e qanin me ligje në dhomën matanë. Njëpër derën e hapur në të dy kanatet shihja një pjesë të grave që qanin. Qenë të veshura gjithë në të zeza dhe dhoma matanë ngjante me një manastir kallogresh. Një palë sy gruaje më shihnin herë pas here me habi. Ç'doja vallë unë këtu? Herë-herë njërin sy ia mbulonte shamia e zezë e kokës dhe tjetri më ndiqte si një elektrik dore.

Shumica e burrave qemë ulur në porshqefalle, jastëkë të mbushur me rrecka, të fortë shumë, që shëmbëllenin me sedile kamionësh. Bëheshim dy rrathë burrash. Ne, të ulurit në jastëkët e mbushur me rrecka dhe rrethi tjetër, pas nesh, ulur rehat në karrige.

Unë e kisha vështirë të rrija gjatë ulur sheshazi, por nderi im e kërkonte të hiqesha sikur gjë më të bukur sesa të rrije këmbëkryq nuk kisha provuar. Ishim si një amfiteatër i vo-

gël, në zemër të të cilit nuk luhej asgjë nga teatri antik, përveç cigareve, shumë të dredhura me dorë e më shumë të nxjerra nga paketa, filxhanëve të kafeve dhe gotave të rakisë. Cigaret ngjanin si cironka të vogla, kurse kutitë metalike të duhanit si kuti sardelesh. Mbase më dukeshin mua kështu, ngaqë më pëlqente të rikujtoja kësisoj të zotin e konakut, Bon Dukën, që kish pasë qenë detar.

Televizori qëndronte i heshtur, vuv, mbi tryezën me syprinë xhami në qoshe të dhomës. Ai dukej i turpshëm, si gratë myslimane të hershme, mbase dhe se ishte i mbuluar e futur në këllëf cohe të zi, si në ferexhe. Zjarrin në buhari e ushqente me dru djali i madh i shtëpisë. Digjeshin kucura ulliri dhe të ngjante vetja si në natën e buzmit. Gjethet e ullirit herë pas here hidheshin përpjetë si fishekzjarre të vecërr, gati si gështenja të papjekura e të paplasura, që shpërthejnë me zhurmë. Ishte një maji i vitit 1978 dhe zjarri mbahej ndezur jo se qe moti i ftohtë, megjithëse dhe vapë nuk bënte, por ngaqë muret e gurtë njëmetroshe të trashë të kullës së Dukës, nuk e linin të hynte akoma erën e ngrohtë të majit. Por vërtet kishte ardhur maji, muaji i mbarsjeve të koshereve të mjaltit, sepse jashtë kundërmonte aromë lulesh portokalli e sherebeli, që herë pas here, tek hapeshin dritaret (për të ajrosur duhmën e duhanit të burrave), ndihej edhe në odat e konakut të Bon Dukës.

Më ka qëlluar shpesh të marr pjesë në ngushëllime. Jam djalë i vetëm në fisin tonë dhe mua më bie gjithnjë të bëj zakonin. Por atë ditë

maji nuk ishte puna thjesht për të larë një borxh të përcjelljes së të vdekurve në përgjithësi, por për t'i bërë nderet e fundit një miku të dhembshur që kisha. Mik e deli mik.

Pranë meje, në krah të djathtë, kisha të ulur uratën. Ai kishte qenë prift i fshatit dhe tashti, pa mjekër, i rruar taze, dukej tjetër njeri. Emrin *uratë* e trashëgonte jo aq nga respekti, sesa ngaqë njërezit ishin mësuar një jetë të tërë ta thërrisnin kështu dhe tani e kishin vështirë të gjenin një nom tjetër, ashtu sikundër çdo zanatçi të vjetër, që, megjithëse ka kohë që ka lënë zanatin, vazhdojnë ta thërrasin usta.

Urata do të kish dashur të ligjëronte në varrimin e mikut tim, para lipsanës së Bon Dukës, por e kuptonte që nuk i takonte më ky nder atij. Për Bonin fjalën e duhur e kish mbajtur kryetari i këshillit të fshatit, që ishte ulur në krahun tjetër timin. Urata pinte mirë. Ai dinte të pinte me dinjitet. Ja dhe tani e surbte raketalin e rakisë gjithë lezet. Zakonisht, edhe në sebepe, jo më në një vaki si e sotmja, ai shtrohej qetë dhe pa bujë. Kur të tjerët shpesh mburreshin që kanë pirë një okë raki, ai turpërohej dhe, si më i humburi i fshatit, pohonte me «mòdesti» që «një cërrë raki sa e kish vënë në gojë!» Në fakt, ashtu urtë e butë, si qengji i mirë që pi dy nëna, ai pinte dyfishin e rakisë që pinin të gjithë burrat që qenë këtu. Dhe, sa për raki fshati Bunovë dallohet mbi gjithë fshatrat e Bregut. Për çdo frymë nxierr gjysmë kuintal raki dhe, po të heqim gjysmën e fshatit, që janë gra e vajza, dhe cerekun tjetër, që janë fëmijë e nuk e vënë kurrë në gojë, gjithë ç'del nga dhri-

të e rrushit të Bunovës, e pinë burrat. Hiç më pak se dy kuintalë raki secili. Dhe, që të mos nisem për në Tiranë e të mbaj vrapin në Sarandë, le të vazhdoj me uratën. Gjithnjë, dhe kur kish qenë prift, ai pinte në klub të fshatit, pranë banakut, më këmbë. Nuk ulej në tryezë kurrë dhe pinte kësisoj një ose dy orë, e megjithatë dukej sikur thoshte: «Ja, sa të kthej një të bekuar, o të uruar, dhe ika,» dhe kthente një shishe raki! Pëlqente më shumë uzon. Por, meqë ajo ishte pjellë e Danajt, kishte frikë, sidomos tani që s'ishte më prift, por qe vetëm kaon e pellazg, se mos të tjerët e merrnin këtë dëshirë të tij si paragjykim e parapëlqim të shijeve e prodhimeve të «Metaksait». Shfajësohej e thoshte gjithnjë, kur gjente uzo në klub, se «e pi për aromë». Dhe aroma dihet që s'ka të bëjë as me fenë e as me politikën. Aroma ka të bëjë vetëm me nuhatjen e hundëve dhe avujt e stomakut, thoshin sevdallinjët e rakisë, në mbëshetje të uratës fjalëpakë.

Dhe ja, në këtë çast që unë mendoja për huqet e ish-priftit, erdhi gjithë zhurmë, jo si për vdekje, por për festë, barba Fotoja. Ishte qibar nga vëshët. ndaj fliste ngaherë me zë të lartë si gratë e Bunovës kur venë për shkarpa malit. Kujtonte barba, si gjithë ata që dëgjojnë ligisht, se dhe të gjithë të tjerët kishin kusurin e hallit të tij. Ai erdhi dhe, akoma pa u unjur, uroi: «Gëzuar nië majin, o djem!» U habita me të, shtanga fare. se cvsh në nië vdekje fshati ai uronte nië majin. Nuk u përgjigj njeri. Por ai s'priste përgjigje. Nuk dëgjonte.

Kryetari i këshillit u zbyth më tej dhe i li-

i zoti, që i hahej muhabeti me ty. Ke sevda detin, zotrote, si ne.

— E kam vërtet qejf, — pohova unë. — Por s'më kish thënë ndonjëherë që kish përkrahur Revolucionin e Tetorit.

— Ama, mendje! — thirri plaku. — S'ishte çoban për të shkundur këmborë, Boni! Jo! E si të të thoshte për këtë! Se mos që i vetmi në këtë dynja me Leninin! Apo të kujtoje zotrote se ta thoshte këtë që t'i kërreje pensionin e luftës? Jo, mor bir, s'binte kollaj Boni në dërrasë të kalbur.

— Këtu s'ishte puna për dërrasë të kalbur, — kundërshtoi kryetari i këshillit, që m'u gjet krah kur s'më shkoi mendja. — Çështja është për një akt të veçantë të veprimtarisë së tij revolucionare.

— Mirë, mirë, — tha plaku, — Boni kishte gjithë jetën që luftonte. Vetë jeta për të që e gjitha luftë. Ishte nga ata levendër që thotë kënga: «Aherë kur ishte halli, i merrte plumbat zorkadh!» Ai që zorkadh mbi zorqej, që s'i dridhej as dora e as këmba. I kishte plagët të rënda! — Plaku vazhdoi vargëzimin: — Ai që trim, e jo kur ndahet malli e ha e pi Ali Avdalli, ç'i do llafet! Ai që shpirto, si uzoja greke. Ne jemi të detit, kurse ju jeni të steresë! — përfundoi plaku me një lloj nënçmimi, duke bërë me dorë nga të gjithë ne burrat që qemë rreth tij.

— E dëgjon? — më pëshpëriti urata. — E sheh! Të thashë apo s'të thashë! Përsëri lavdëron grekun!

— E dëgjoj, — thashë unë.

Por unë doja të dëgjoja për mikun tim, që

ishte shkaktari i ardhjes sime këtu. Unë doja të
dëgjoja dhe të kujtoja Bon Dukën... Ai ishte
nga ata burra, për të cilët nuk thua dot kurrë
«kur lahej palla me gjak, Bon i Duket qe bajrak.
Tashti thonë vdiq një plak!» Jo!

2

... Dhe erdhi ambasadori. Ai u kryeshën-
dosh me djemtë e Bonit. Tha fjalët më të za-
konshme të ngushëllimit: «Të rroni vetë!» Mori
përgjigjen e të zotërve të shtëpisë: «Miqtë shën-
doshë!» Dhe zuri vend pranë nesh, ulur. Ai
thirrej kështu, ambasador, se dikur, disa vite të
shkuara, kishte pasë qenë vërtet i tillë: amba-
sador. Dhe tani, megjithëse kish dalë në pension,
njerëzia vazhdonin ta thërrisnin përsëri amba-
sador. Ishte i shëndoshë, i fortë boll për moshën
që kishte dhe, me gjithë kokën e shogët, ato
pak leshra që i kishin mbetur, i mbante pas, të
gjata, si çepe e grave. I prunë rakinë e zakonit,
i hodhën cigaren dhe vazhdoi biseda për dhritë
e rrushit, që këtë vit qe i mbarë, dhe për ra-
kinë, që këtë vjeshtë do të bëhej sa të laheshe
me të, por që ç'e do, të uruarën, kur pleqtë e
fshatit do ta pinin pa Bon Dukën.

Ambasadori nxori një paketë «Porti» të kuq,
eksporti, e lëshoi bashkë me shoqet e tjera në
pirgun e duhanit, pilaf në mes të dhomës dhe,
tek surbte me shije rakinë, tha:

— Jetoj e gëzoi Bon Duka. Vdekjen e Kemi
borxh të gjithë. Ju e kishit babë e unë e kisha

mik. Ju humbët prindin, unë humba shokun e luftës. E madhe plaga që na la.

— As i pari e as i fundit, — ia ktheu plaku i Goxhet, barba Fotoja, vuvi. Dhe nuk u kuptua për kë e kishte: për vdekjen e Bonit, apo për ambasadorin që pat humbur mikun dhe shokun.

Ambasadori dhe Boni kishin qenë të dy partizanë. Jo në një çetë, se ahëre vetëm Boni luftonte, por në një brigadë, kur doli dhe tjetri në mal me shokët. Boni, pas luftës, ngriti kooperativën në dheun tonë, ambasadori ngriti një e dy ambasada në dherat e huaj. Nuk e di ç'e lidhte më vonë ambasadorin e shkathët me Bonin e urtë. Tani mora vesh që i gjalli paska pësuar mik të vdekurin. Këtë e tha i gjalli, ambasadori. Megjithëse nuk më besohet. Me siguri ishte ndonjë e fshehtë e të gjallit, që tashmë e ruante përjetësisht, thellë shumë, i vdekuri. Patjetër, po shokë zor se qenë. Pse?

3

... Këtu e tre vjet të shkuar më kish grisur të kaloja pushimet e beharit, bashkë me fëmijët, në shtëpinë e tij. «Konakun e kam të madh e njerëz të mirë mban sa të duash», më pati thënë, kur unë i kujtova se ai qe bark i shumë dhe do ta ngushtoja po të zija shtëpinë e tij. «Hadje, lëri llafet, se janë fukarallëk. Hajde, se do të kënaqen çiliminjtë!» — ngulmoi ai. Dhe unë vajta dhe fëmijët vërtet u kënaqën.

... Shtëpia e Bonit, e rrethuar me portokalle dhe mbuluar nga pjergulla, është buzë detit, aq

pranë, sa në verë dëgjohet kënga e gëzuar e tij dhe kënga e përzishme e cinxurit. Shtëpia ngre krye si thëllëza mbi shkëmb në bregun verbues të gëlqerorëve të Jonit. Shtëpia e bardhë qumësht, çatia e kuqe flakë, shkëmbi teleshir dhe deti i thellë mavi oktapodi. Lart qielli blu, i hapët pa anë. Ullinj të dhe qiparisat. Diçka si në peizazhet e Van Gogut. Pranë shtëpisë shtrihet gjiri i vogël, tepër intim, familjar i Duket, që është objekt zilie e gërnje për pushuesit e tjerë të ardhur në Bunovë.

Eh, ky sy det sa i pëlqente Bon Dukës! Mund të mos më besoni, është puna juaj, por sikur Boni të kish jetuar diku thellë në stere, goftë dhe në kryeqytet, s'do të kishte jetuar fare, jo më tetëdhjetë e shtatë vjet. Një shekull, thuaj! Dikur, në rini të tij, kur deti s'kishte zot e ai s'kishte aq kujdes për të, kish nxjerrë ujët e zi me dinamit dhe kocet e sinagridhet e arta barkpërpjeta mbushnin gjirin. Aq shumë vriste. Por erdhi një ditë që deti u sakatua dhe ai u moshua, aq sa t'i vinte keq për detin. Dhe s'ho-dhi e s'la njeri të lëshonte më dinamit në të. Ishte kjo kohë kur nga sevdaja për ditët e rinisë një ditë bleu në Vlorë rasat të vocërr qefulli. Mbushi një botile me rasat, e pruri në fshat dhe e hodhi në pus të shtëpisë. Kaluan muaj, qefulli me siguri qe rritur. Boni gremiste kovën në pus, por qefulli, paçka se më tuhafi i peshqve, nuk qe aq budalla sa të futej vetë në kovë të ujit. Qefulli poshtë në fund të pusit, Boni lart në grykë të pusit. Qefulli rritej e Boni mërzhitej. Pa ç'pa dhe gjeti një llokum dinamit nga bran-konierët e fshatit, që vazhdonin hajdutçe të

GRADISTIA
45800

vrisnin peshk me të pabesë, se, sado rregulla të forta që të ketë shteti, ka që gjejnë shtegun e i shkelin ato. I ndezi fitilin llokumes dhe e flakëriu në pus. U hodh pusi përpjetë, se s'ishte deti varfri për atë thelë llokumi. Gjëmoi pusi, gjëmoi fshati dhe u shkulën pllakat e gurta të pusit bashkë me qefujt përpjetë mbi çati e mbi pjergull. Ishte dita e gjëmimit të Bonit, që fshatarët e kujtonin: «Atë ditë që ra atomi i Bonit». Mallkoi veten Bon Duka, u mallkua keq nga e shoqja për dëmin që bëri, e uruan dhe e bekuan macet dhe maçokët e fshatit, thua ish shkurti, muaji i dashurisë së tyre, dhe jo korriku, muaji i urtësisë së tyre. U ngopën peshk...

E donte shumë detin Boni, si ai dhe asnjëri në botë. Si kish ngritur kooperativën dhe ish in ndarë njëdynymshet e kopshteve personale, kur Boni qe tashmë jo palca e fshatit për punë, ai i bëri një kërkesë të çuditshme kryesisë së re të kooperativës. Nuk pranoi të merrte tokë, por u lut që t'i jepnin vetëm një dynym det. Ja, atë sy det, ku ishte gjiri i vogël. Nuk e besoi njeri lutjen e tij dhe e morën për shaka me kripë. Por, në të vërtetë, ai s'bënte shaka me kripë, por donte një dynym ujë të kripur deti. Nuk ia dha njeri atë ç'kërkoi. Por të gjithë e dinin që për Bonin jeta ishte deti dhe për detin ai linte kokën.

Ishte, pra, pasdite. Boni dhe unë nga veranda, tarraca e mbuluar me vile rrushi si vathë nusesh, në çip të gjirit të vocërr, kundronim diellin që, i kënaqur për punën që kish bërë gjithë ditën, po kumbisej të këpuste një sy gjumë diku thellë në det, larg në vise të tjera. Fë-

mijët s'ngopeshin me det dhe, paçka se kishin tërë ditën, dhe aherë kur dielli vetë u lodh, pra-pë vazhdonin të hidheshin kokëposhtë zhyt në ujë, te Guri i Devesë. Hidheshin e merrnin «pa-to» në fund të detit, siç thonë bregasit. Guri i madh vërtet ngjante me një deve të madhe, i lodhur, ardhur nga ana e anës, nga një rrugë e gjatë, që ish përgjunjur e freskohej me ujin e detit. Valët e buta të detit vaj lëpiheshin si ko-telet pas Gurit të madh dhe dukeshin të velura sikur s'kishin kthetra fare!

Një çift i ri, me siguri i sapomartuar, i nxi-rë si jevgjit dhe që s'kishte mbaruar edhe cipën e mjaltit të martesës, bënte dashuri mbi rërën e nxehtë strallore.

Valët lëpiheshin si mace të ngopura. Ishte fundi i gushtit dhe gjithkush përpiquej t'i merrte sa më shumë motit të bukur.

Ne me Bonin ishim ulur në divanin e ve-randës së gjerë si kuvertë vapori të shtëpisë së tij dhe si nga kapiteneria e lartë, shihnim ske-nën pa fund të detit. Pinim rakinë me rrushin e dhrisë, që na bënte hije. Pranë detit dhe pranë mikut dhe rakia më e keqe të shijon, jo më ajo raki, e bërë për sevda për vete e jo për botë, e Bonit.

Kuvendonim shtruar përpara njëdynymshit të detit të Bonit. Vërtet Boni nuk e fitoi kop-shtin personal të detit as me gjysmë shaka e as me gjysmë të vërtetë. Deti mbeti i të gjithëve, por qysh atë vitin që e shtroi për zgjidhje cësh-tjen e tij detësore. lindi dhe ai mikrotoponimi i ri për gjirin e vogël të Duket, që rinia tashmë e quan Deti i Bonit». Çdo hartë gjeografike, e pa-

qes a e luftës qoftë, detin tonë e quan «Jon», por këtë sy deti këtu fshati e thërret «Deti Bon».

Dhe, ndërsa mëma e djemët, e shoqja e Bonit, sillte pjatancën e dytë me djathë e qepë të njoma, me patate të ziera me maja kungulli të lara me vaj ulliri flori, ia mbërriti ai, ambasadori. Nuk e njihja, por kisha lëçitur në gazetë herë pas here për pritjet që jepte diku në raste fëstash kombëtare, atje tej në ato vise ku ishte akredituar. Kishte kohë që s'jepte pritje e emri në gazeta nuk i dilte më. Kish dalë në pension dhe, siç ndodh rëndom me njeriun kur fillon të plakët, i ish shtuar fort dashuria e malli për vendlindjen, linte Tiranën dhe vinte e kalonte gjithë beharin në fshatin e tatës, në gurët e shtëpisë së vjetër të tij.

Duhej të kishte ditë që kish ardhur në Bunovë, përderisa Boni, si u ngrit në këmbë, e priti me këto fjalë:

— Mirë se e gjete udhën për në konakun tim! Sot e paska «portokalli» yt ditën e vizitës për tek unë. Luante në fjalën portokoll.

Tjetri e puthi në të dyja faqet e parruara Bonin dhe ia ktheu:

— Nuk i le shakatë, o Bon i Duket.

— Jo! — tha Boni. — Nuk bëj shaka. Ku humbe kështu si sëpata pa bisht? Ke një iavë që ke ulur spirancën në breg tënë dhe s'të pashë të më shkelie derën.

— Më mirë vonë se kurrë, apo jo? — tha tjetri jo pa dinjitet, duke m'u drejtuar mua. Ishte e qartë që donte mbështetje.

— Te miku shkohet gjithnië më mirë shpejt se vonë, — e ndreqi Boni fjalën e urtë dhe i

vuri vulën me: — Këmbe rrobat, por jo zakonin!

— Interesante! — tha ambasadori duke përsëritur atë formulën as mish e as peshk të diplomatëve, kur nuk duan të japin një mendim të përcaktuar për një çështje të caktuar.

Nikoqirja e shtëpisë nxitoi e shtoi një gotë tjetër rakië, pruri pecetën dhe takëmet e mezes për mikun që kish parë botë. Peceta e bardhë dritë, e ngrirë me hekur, sa të vinte keq ta ndotje, shtrihej e kënaqur mbi gjunjët e fortë të ambasadorit, si një destemel i sermët nusesh të turpshme.

Ambasadori ishte tepër i fismë në të ngrënë, linte hise edhe për të tjerët, por në raki që i fortë.

— Ball i kazanit! — hetoi ambasadori. — Është më e mirë se uiski i Skocisë!

— Ç'ka, — tha Boni, — jo dhe aq.

— Ke frikë mos ta ha me sy!

— Nuk më tremb. Por ky vit pati shira shumë e diell pak. Mot i mirë për çobanin, por i prapë për vreshtarin.

— U ka dalë turpi disave. U ka plasur cipa fare, — tha ambasadori, si për të ndërruar muhabetin, tek u ngop së pari çiftin e ri, të nxirë si jevgjit, që gudulisej e gajasej buzë detit.

— Mirë ai, se djalë është, e ai stan atë bulmet ka, — e mbështeti gruaja e Bonit ambasadorin, — por ajo korbëza ç'ka që harliset ashtu, cipëçjerra!

— Si gjithë bota, — e mbrojti Boni çiftin. — Çdo moshë ka gëzimet e saj.

— Gëzimi i gruas është nderi, — tha ambasadori.

— E po burrë e grua janë, — tha Boni. — Se ç'bëjnë të tjerët, ua di krevati. Këta vetëm me lodra kënaqen. Ju, në keni frikë, mbyllni sytë.

— Ti predikon indiferentizmin, Bon Duka, — tha duke qeshur ambasadori.

— Jo. Por gëzimin e jetës tjetrit, nëse nuk je i zoti t'ia shtoj, të paktën mos ia hiq. Kaq dhe e lëmë, se, po kujtuam rininë tonë, do të dalim me këpucë të kuqe. Apo jo, o mëma e djemmet? — tha plaku duke iu drejtuar plakës.

— Pu, pu! — nduku plaka faqet. — Shih ç'kujton i paudhi! — dhe iku.

— E bëre me turp nikoqiren. Ia skuqe faqen, — tha ambasadori.

— Ka gjak të ngrohtë akoma, qënia, — ia ktheu i gëzuar Boni. — Jo si disa.

Biseda midis tyre filloi disi keq dhe kisha frikë mos mbaronte më keq. E pra, dita kish qenë aq e bukur! Dhe, si për të mënjanuar sherrin e panisur tamam, pra për ta mbytur atë qysh në djep, unë i bëra një kthesë njëqindtetëdhjetëgradshe bisedës dhe e pyeta ambasadorin si ca studentë naivë për borxhet e shtetit të huaj të Afrikës, ku kish punuar vitet e fundit të karrierës së tij. Gazetat shkruanin e thoshin ato ditë se borxhi i atjeshëm që i madh shumë, saqë i binte dy mijë dollarë për frymë.

— Janë para falimentimit. Pas moratoriumit që shpallën sivjet, tashti që amerikanët ulën artificialisht çmimin e naftës, ua kanë vënë lita-

rin në fyt, — miu përgjigj ambasadori me kompetencë.

— Dy duar për një kokë janë, — tha Boni.
— Po s'qenë të zotë të çalltisin vetë, harram e paçin.

Ambasadori rrinte si më gjemba. Herë pas here shihte orën e dorës, si ata çunat e rinj që sapo e kanë blerë.

Më në fund, edhe fëmijët e mi u kthyen nga plazhi. Të vetmit ithtarë të detit mbetën ata të dy, çifti i sapomartuar. Muzgu i mbrëmjes u ul këmbëkryq në buzëdet dhe po ngjitej qetë, i gjithpushtetshëm, lart në majat e maleve. Fëmijët e mi të zhurmshëm, Adi dhe Ana u përshëndetën me të panjohurin, ambasadorin. Çuni i entuziazmuar më tha:

— Ba, ky është det për së mbari. Hak det!

Ambasadori shfaqti habinë dhe dashurinë për fëmijët e mi:

— Qenkan bërë goxha burra... Dhe sa të sjellshëm! — tha ai dhe, megjithëse njëri prej tyre qe vajzë, nuk kish si thoshte «qenkan bërë burra dhe gra»!

Dhe, si shtoi «po ikin vitet», u ngrit të na linte shëndetin.

— Prit, — thirri Boni, — ku nxiton! Rri të pimë kafën.

— U bë vonë, — tha tjetri dhe shtoi me të qeshur: — Po të rri dhe ca, do të më mbash për darkë.

— Një lugë më shumë e asgjë më tepër, — tha Boni.

— Vau, — briti nikoqirja, — c'është ai llaf! Ti je si në shtëpinë tënde, o jetë. Hajde kur të

duash e rri sa të duash. Na gëzove që erdhe. Të lumshin këmbët. Dhe, sa për darkën, me pahir s'të mban njeri.

Nikoqirja e Bonit, mëma e djemve, duhej të ishte moshatare me ambasadorin dhe të dukej e çuditshme se si ajo i drejtohej atij si fëmijëve të saj: «O jetë!» Por këtu në Breg jo vetëm ajo, por të gjitha gratë kështu u thërrasin djemve, qofshin edhe burra. Nuk jam etnograf, por nuk druaj ta them që kjo mënyrë trajtimi i bijve dhe e shokëve të tyre do të jetë e trashëguar qysh nga matriarkati.

Ambasadori u ul përsëri. Nikoqirja vuri kukumenë, xhezven e kafes në plitkën e korentit. Nuk e di pse këtu i thonë kukumë, ndoshta se edhe kafja dhe xhezveja janë të zeza si qyqe, si kukuja e saj. A mbase, që kur ka ardhur xhezveja dhe kafja e parë në këto vise, u ka kujtuar kukumjaçkën. Kot po bëj hamendje. Tek dëgjohej si ziente kafja në plitkë, Boni pyeti si shkarazi, me zë të ulët, sa mezi u dëgjua.

— Po tek ai miku i Operacionit të Dimrit, në Arbër, a vete ndonjëherë? Për të mirë a për të keq!

— Jo, — tha ambasadori, se atij i drejtohej pyetja. — Jo. Sa isha jashtë shtetit, nuk kisha si të veja. Tashti që jam këtej, s'më ka goditur rasti. Por kam dëgjuar nga shokët që fëmijët i ka martuar dhe halle s'ka. Partia ia ka siguruar të gjitha.

— Mirë Partia, po ti? Njeri të gjallë pa halle s'ka. Vetëm i vdekuri s'ka halle. Po hallet në pazar nuk nxirren.

— Po të kishte halle, do të kish ardhur. —
tha i sigurt ambasadori.

— Jo! E ke praptas këtë punë. Burri i fortë
qëndron si ariu në strofkën e vet. Nuk falet ko-
llaj në botë. Përderës a lypsar nuk bëhet. Burrin
kjo burrëri e mban. Ca më tepër, si të vinte ai
te ti, kur ti shërbeje në anë të anës. Kurse, kur
ktheheshe nga kurbeti, jo e jo, se do të pandehje
se vinte për ndonjë rraçe të jashtme, si ca rrec-
kaxhinj sot, që kërkojnë kushërinjtë e shtatë në
Evropë.

— Nuk besoj. Nuk ke të drejtë, — tha tjetri.
— Kur ka hall njeriu, përplasat dhe te dera e
atij që është në hasmëri me të e jo tek e mikut,
sikur dhe në fund të botës të jetë.

— Varet ç'njeri është! — tha Boni.

Nuk e kuptova dot për kë e kishte fjalën
Boni, për hallexhiun apo për hasmin. Më ngjan-
te sikur ishin dy vetë që flisnin gjuhë të ndry-
shme dhe s'krijonin dot një dialog.

— Të lumshin duart, — uroi ambasadori ni-
koqiren. — E ke bërë si kafe Peruje.

— Puro kafe, vërtet, — pohoi nikoqirja.

— Ika, se mbeta në vela, — tha ambasado-
ri. — Do të shihemi prapë e do të çmallemi.

— Mirë, mirë, — mermëriti Boni. — Unë
këtu jam dhe shtëpinë këtu e kam.

Ambasadori na shtrëngoi dorën të gjithëve.
Nikoqirja e shoqëroi deri te pragu i derës në
xhade. Unë prita ta përcillte Bon Duka, po pla-
ku u ngrit vetëm sa për t'i dhënë dorën dhe kaq.

Mbetëm të dy vetëm përsëri. Ne të dy edhe
deti përkundruall. Por mua duhej të më kishte

harruar, se Boni tha sikur fliste me vete, me keqardhje të madhe:

— Ky njeri ka mbaruar. Vetëm sa bën hije mbi këtë dhé, fatziu. Ishte dhe s'është më.

— Si ka mbaruar? — u shqetësova unë për ish-ambasadorin. Mos ka kancer dhe nuk e di?

— Jo! — buzëqeshi pikëllueshëm Boni. — Jo! Më keq se sëmundja e ligë. Ka mbetur pa miq e pa shokë.

— Po ti a nuk je mik i tij? — pyeta i çuditur unë.

— Kam qenë. Tashti jam një i njohur i tij. Nuk qe fare i keq në luftë. As i pari e as i fundit. Por kishte brumë të thartuar, i varfri! U prish shpejt. E bëri qeveria lajmës të saj në botë. Mësoi diçka edhe nga gjuhët e botës, si millonai, që, për t'u ngopur, s'ngopet, por pa bukë s'mbetet. Dhe e gënjeu mendja e kujtoi se ai qe e s'kishte tjetër Shqipëria. Erdhi e u fry, aq sa i harroi miqtë dhe shokët. Brumë i lig, të thashë. Nuk la më vend në mësallë për të tjerët. E shpoi pastaj qeveria me biçak dhe u shfry e firasi menjëherë, si mulla e djathit. Mbase i erdhën mendtë, por qe vonë, e tashti s'ia hanë as qentë.

Unë dëgjoja me vëmendje, i mbërthyer pas çdo fjale të tij dhe jo pa habi. Fjalët ai i nxirrte ngadalë nga goja, me një dhimbje të tmerrshme, sa ngjante se nxirrte prej saj jo fjalë gjuhe, por hekur të skuqur kudhre.

Boni e kapi shpejt hutimin tim, papritmas çoku gotën e rakisë dhe uroi «shëndet e nder, o djalë!» dhe vazhdoi nësëri të nxirrte hekur të skuqur nga goja, jo fjalë.

E di kush është ai miku i tij i Operacionit të Dimrit? S'ke si ta dish, paçka se për të ti ke bërë një shërbesë, kur qe nevoja. Vure një gur në teqenë e së drejtës. Të kujtohet atë vit, kur sapo kishe martuar motrën? Ne kishim kaluar tok darkën e dasmës si krushq dhe unë erdha të nesërmen që menatë. Patjetër ke menduar atë çast se ç'zakone të çuditshme kanë këta krushqit e tu, që të zënë derën sapo kanë marrë nuse bijën e shtëpisë.

— Mund të të thosha që në darkë, hallin e kisha tamam dhe s'më vinte as turp e as rëndë. Por ishte dasmë e në ziafet premtion shumë njeriu, ndërsa, kur i del rakia, i harron të gjitha. Të doja esëll, ndaj të shkela zilen që pa gdhirë. Ja, kështu! U kujtove, besoj!

— Erdha, pra, dhe të qava hallin e një djali vendi të mikut tim. Të thashë që djali ishte nga një fshat i Këlcyrës. I ati ka qenë me luftën. Djali ka dalë i pari në garën e aritmetikës të gjithë Shqipërisë dhe shkollën atje në Këlcyrë e ka mbyllur vetëm me dhjeta. Me diplomë ari, i thonë. Kërkoj t'i dilte bursa për degën e matematikës, ia dhanë për miniera. Hallall! Vate mbaroi vitin e parë në shkollë të lartë, prapë me gjithë dhjeta e mbaroi. Të dytin po e mbylli si të parin. Tashti është hapur llafi që do të dërgojnë për specialistë jashtë, për naftë, në Paris, thonë. disa djem të matematikës e ca të degës së naftës. Këtë këlcyrasin nuk e dërgojnë, se nuk qenka as për matematikë e as për naftë, po për minierë. Nuk është e udhës, kështu të thashë.

Ti nuk shërben atje tek mëson djali, se, ndryshe, do ta njihje. (Atë vit unë bëja stazhin e Partisë në minierë të Mëzezit). Por me mësuesit e tij ke ngrënë një thes me kripë. I ke shokë të zanatit. Pyeti dhe, po s'qe e vërtetë që dal garant për një djalë që i hahet haka, eja më pështy në surrat. Ti merre me këto punë e mund ta shpiesh të drejtën në vend. Se e drejta sot mund të zhytet, por s'mbytet. Venë e vijnë djemtë e cave dhe, kur kthehen nga Evropa, nuk e durojnë erën e naftës. Mbeten në Tiranë. Jo kështu, ca të mëmës e ca të njerks. Ky djalë i mikut tim nga Këlcyra, më i miri i djemve të vendit për matematikë, vajti për minierë dhe nuk u ankua kurrë. Dhe bëri mirë që s'u ankua, se më djer-sën e popullit shkollohet, paçka që Këlcyra e shkretë s'ka miniera fare. Po unë dhe ti, që tashiti e di, që ai duhet të jetë i pari për të ngritur naftën tonë, ç'të bëjmë, të rrimë mënjanë, të bëjmë sehir? Jo, the ti. Dhe nuk e di ç'përpjekje bëre në qeveri, ku e përplase kokën, që ia gjete fillin këtij lëmshi dhe djali i botës vate në të drejtën e tij. Dhe nuk na turpëroi as mua e as ty, që hyre dorëzënë për të. Kështu? Apo jo, — tha Boni dhe shtoi: — Atij mikut nga Këlcyra, se vërtet mik e kam, që nga lufta kur na dha jatak e bukë kur patëm nevojë, unë nuk i kam pasur dhe as më ka ndonjë borxh. Ky ish-lajmësi i qeverisë në botë, që thonë se flet gjuhë të huaja, i ka borxh jetën!

— Si jetën? — pyeta unë.

— Bash jetën! Gjënë më të çmuar që kemi të gjithë. Në Operacionin e Dimrit e patëm pisk. Batalioni ynë qe nga ata të paktët që u shpërnda

koqe-koqe. Gjermani qe i sertë e larot e Ballit të pabesë, por të pabesë dolën dhe ca nga komandantët tanë. Vonë u doli fare kallaji. U shpërndamë. Nja njëzet vetë qemë ne, që mbetëm në mal. Atë kohë u lavos në kofshë dhe lajmësi i botës, ish-ambasadori ynë. Humbi gjak shumë, tha. Dhe u harrua në një brinjë mali. Mbeti vetëm me shpirt e pa mendje. Dhe ashtu, as të vdekur as të gjallë, e gjeti ai fshatari nga Këlcyra, tata i atij djalit të matematikës. E mori në krahë si arusha këlyshin dhe e shpuri në shtëpi. E mbajti dy muaj sa e shëroi, derisa çeli lule rrushkuqja. Bujtësi kish humbur shumë gjak dhe i zoti i shtëpisë hoqi nga goja bukën e çilimjve, që të mëkëmbej i lavosuri. E ngjalli me qumështin e pakët të dhisë së vetme që kish. Me kokën në trastë e mbajti. Po ta gjenin gjermanët a larot e Ballit, e çonin në plumb mikpritësin me gjithë fëmijë. Kur e shëroi mirë e tumirë, e siguroi dhe e përcolli deri te ne në mal. Dhe lajmësi u bashkua me ne prapë. Burri i botës i bëri harram të gjitha për të, me kuç e me maç, kur ky s'i ka shkelur derën asnjëherë. Ka pasur probleme! Pthu! Të mirat e shumta të verbajnë. Kështu, të paça! Me shëndet e nder! Brom. Me mua lajmësi i mban relatat akoma, nevojën mbase nuk ma ka, por e njoh mirë dhe m'i njeh huqet ca më mirë. E di ky qerrata, ish-ambasadori, që në fshat tënd s'bëhesh profet kollai?! Me atë burrin e urtë të Këlcyrës i ka prerë lidhjet, që kur e hodhi atë dimër shëndoshë. E pësoi si puna e atij që tha: e kaptova lumin. të pierdhsha kalin. Por jeta është lumë pa fund. S'e hedh dot kollaj. Jeta është si karvanari

me hanxhinë, piqesh përherë. Kujton «miku» se është profet për botën, ndaj qenka dhe për Këlcyrën, dhe harron që në një copë vend jemi dhe shënohemi me gisht kudo. Mjerë ai që gënjen veten. Njerëzia sot s'ha bar. Ta var trastën shpejt. Ndaj them që ky njeri ka mbaruar. I është vënë vizë! E kisha mik e shok dikur, por sot... Eh... Gjynah! Një i njohur dhe aq. Është, ja, si ky det, që ka ujë shumë, por, për të pirë, s'pihet! Gëzuar!»

5

... Ish-ambasadori po u përgjerohej djemve të Bonit për babanë, që s'e kishin më dhe për mikun e vyer, që e humbi përjetë. Djemtë e mikut shëndoshë! Rrëfente për luftën dhe shoqërinë me të. Tregonte si e priti Boni pas shkëputjes së detyruar që pati nga batalioni gjatë Operacionit. Kur u plagos rëndë, shumë rëndë. Të gjithë e dëgjonin me vëmendje të madhe, gojëhapur. Po fole për të vdekurin, ose fol mirë ose mos fol fare. Këtë e dinte ish-ambasadori. Ish-prifti numëronte tespihet. Plaku i Goxhet, që kish ardhur një orë më parë me aq zhurmë, tashiti u ngrit fare, vetëm një tundje e lehtë koke, që u drejtohej të gjithëve dhe askujt drejt-përsëdrejti, ca më tepër nuk i drejtohej atij që tregonte, dhe iku.

Në dhomën përkarshi të grave u dëgjua një vaj. Dikush nga gratë matanë vajtonte Bon Dukën kështu:

*O derë e madhe e miqet,
hoteli në udhëkryqet!*

Për një çast m'u duk si zë i njohur. Më ngjau si zëri i motrës së madhe të Bonit. Unë e njihja mirë atë zë. Jo! Nuk ishte i saj. Dhe s'kishte si të ishte ai zë i saj! Motra e Bonit nuk vinte tellallin për vëllanë, qoftë ai dhe Bon Duka. Ishte zëri i gjitones së Bonit. I kishin shtëpitë pranë e pranë. E kujtova, prandaj ia dallova zërin. Gjitionia e dinte mirë ç'njerëz priste e përcillte Bon Duka. Dhe kishte të drejtë ta qante ashtu. Shtëpia e tij qe gjithnjë e hapur për miqtë. Hotel vërtet, dhe pa pará. Kurse motra e Bonit (më në fund, nga dera matanë, e çelur në të dy kanatet, e shqova dhe atë, motrën e tij, midis manastirit të grave, veshur me të zeza si kallogre), ndukte destemelin e zi të kokës. Ishte e qartë që nuk i duronte dot llafet e mëdha, qofshin edhe në vajin e vëllait.

E njihja vërtet mirë këtë grua, motrën e Bonit, megjithëse vetëm nja dy herë qemë takuar. Më kishin folur shumë për të, por Boni kurrë. Kishte qenë komandante kompanie në luftë. E vetmja grua partizane që ka qenë komandante, thonë. Thonë edhe se në librat e historisë për të nuk shkruhet! Shoqet e saj partizane kanë qenë komisarë e zëvendëskomandante. Ajo qe tamam komandante. Komisari i brigadës së saj, një sevdalli i trimave, më thoshte një ditë që ajo ka qenë kapedane grua, që për pushkë turpëronte edhe burrat më të zgjedhur të brigadës. Kurse një shoqe e saj më mbushte mendjen një ditë që grua si ajo nuk pjell më nëna! Kisha

pasur dëshirë prej kohësh të shkruaja për të. Por i vëllai, Boni, sado trime që kish qenë ajo në luftë, e mbulonte me hijen e tij, me bëmat e tij. Ajo më ngjante si një lastar i bukur pjer-gulle, që mbahet e rritet në lis. Lisi që Boni, ajo ishte kulpra e dhrisë. E kam pasur gabim. Atë ditë që më erdhi në fakultet, e kuptova.

Erdhi sapo ishin shpallur të drejtat e stu-dimeve të larta. Ishte koha e riprovimeve të vje-shtës, ishte dyndje e studentëve vjeshtukë. E prita i lodhur, por e prita mirë. E dija kë prisja. E njihja. Nuk kishte fëmijë të saj studentë në gjeologji. As nipër të Bonit nuk kishin. Po Shqi-përia është vend i vogël dhe, siç thotë një miku im, të gjithë dalin farefis. Më erdhi keq për të. Për kë vallë po ndërhynte dhe ajo, komandant-ja, që turpëronte burrat! Por kishte ardhur vo-në, tepër vonë. Riprovimet sapo i pata mbaruar. Kush kaloi, kaloi dhe kush mbeti, mbeti e hum-bi atë vit shkollor.

Më pyeti si i kisha nga shtëpia. Nënë, gru-an, fëmijët. Më uroi gjithë të mirat për vete dhe gjindjen time dhe më në fund doli te shtegu i hallit të saj.

— E udhës do të ishte të të kisha ardhur në shtëpi më parë e pastaj në punë. Kështu do të qe për mbarë. Po nevoja që kam, zgjidhet këtu dhe jo në shtëpi. Kështu më tha mendja!

— Njësoj është. — i thashë unë. — si në shtëpi dhe në punë, po qe se zgjidhet. Dhe pra-pë ke kohë të na urdhërosh dhe nga shtëpia. Më-ma do të gëzohet shumë.

— Jo! — kundërshtoi ajo. — Jo. Nevoja që kam më shtyn që ta shkoqit këtu hallin, në shtë-

pi të shtetit, dhe jo në të familjes. E di pse erdha? S'ke si ta dish, jeto, e as ta shkosh nëpër mënde. (E folura e saj ishte e induktuar nga e folura e Bonit). Ti e di, patjetër e di, që kam njëmbëdhjetë fëmijë dhe bonjaken dymbëdhjetë. Një duzhinë si filxhanët e kafesë «Musa Jonuz». Të mitë i nxora të gjithë në jetë, në punë e të ndershëm. Shtatë i kam martuar dhe tashti jam gjyshe nga pesë barqe, pres dhe dy të tjerët. Një vargan me nipër e mbesa. Më gëzon xhani, kopsht kalamajsh. Dhe katër të tjerët në udhën e martesës i kam. Se ndaj është jaradisur njeriu, që të martohet e të shumohet. Vetë me pension të luftës e të punës. Të rrojë Enveri, se na siguroi. Burri, po ashtu, në pension. Shofer ka qenë, por i drejtë dhe i besës. Jo si ca, që kullojnë ku mundin. Të gjithë nur. Prokopia vetë! Pse kam ardhur aherë e të shkëpus nga puna e të mbaj me llafe, o djalë? Thashë që kam dhe bonjaken. Me veten time e thërras bonjake, por ajo orëzeza kujton se mua më ka mëmë e tim shoq e ka tatë. E mora një moti nga befotrofi, yll i këputur. E mora atë vit kur fëmijët të gjithë i kisha rresht, njëri pas tjetrit, në shkollë. Nga klasa e katërt filllore deri në Institut të Fizkulturës. Se diemtë e parë për sport e mbaruan shkollën. Mundës të fortë si ai... qvsh ia thonë emrin atij amerikanit, që u bë mysliman (Muhamed Aliu!). Ngjajnë nga babai. Muskujt celik e fibër i kanë.

Kisha, o jetë, njëmbëdhjetë diem, kombëtarin e Vlorës për sporte. Njëri më i bukur se tjetri. Levendër! Po ç'e do, vajzë s'pata! S'ce e thënë për mua të kisha vajzë. Mund të bëja prapë

fëmijë atë mot, se beronjë nuk isha, po sikur s'kishte lezet. I pata kaluar të dyzetat. Por kisha merak për një vajzë dhe mall për bilbilosjen e foshnjeve, për gugunë e bebeve. Kisha dhjetë vjet pa pjellë. Dhe e vendosa, e bitisa me mendjen top që të merrja një vajzë nga befotrofi. Ti bëja fëmijët dymbëdhjetë, duzhinë tamam, dhe taborin e vëllezërve me një motër. Im shoq më tha se, si dukej, desha të bëhesha nënë heroinë. Tuhaf i shkreti, i leshtë, po burrë i besës. Nuk e kuptonte që unë heroinë isha që kur kisha lerrë. Harronte që isha mbesa e Bonit të parë. Le pastaj që, të jetosh jetën si e rivoi jetën brezi ynë, është trimëri e madhe, se unë doja një vajzë që të më bëhej si motër dhe kisha mall për bebe. Por kisha turp që këtë bebe ta zija në pleqëri. Le që kush më siguronte që do bëja vajzë! Budallaqe kam qenë dhe unë. Gruaja, sa të jetë grua, duhet të pjellë. Gruaja është si arë, o bir, në e teprova, por ty të kam si djemtë e mi. Gruaja është si arë, thashë. por po s'dha grurë a misër, nuk vlen. Po s'dha bukë, ktheje e bëje zallishte pastaj! Ah, u korba, se c'e kam këtë të shkretë huq, e tjerr, e tjerr muhabetin si plaka leshin. Huq i fisit, zakon i Duket.

Ta kisha llafin te bonjakja. E mora, e rrita, e mbajta si ujët e pakët, si sytë e ballit. Nure e bukur u rrit, me vëllezër astritë, që lënë shpirtin për të, me mëmë e babë. Tashti do të vejë në shkollë të lartë. I ka dalë bursa për ekonomi. Nur fare! Ashtu them dhe unë. S'ka më mirë. Më mirë priset! Vendi, më shumë se për çdo gjë, ka nevojë për veqilë e nikoqirë të zot. Kështu, tamam. Por ja që ajo do për mësuese. Nuk

e di nga e ka këtë sevda. Mbase e ka në gjak. Mbase mëma e saj që e lindi, — se për të rritur e rrita unë, — ka qenë mësuese, korbëzeza! Ata të befotrofit mbase e dinë se ç'ka qenë mëma e saj që e pruri në këtë jetë, por dhe një herë që pyeta, ma mbajtën të fshehtë. Sekret profesional. Kot e kanë, se, kur ta shohë dot e ëma fatzezë si e rrita unë fatmadhja, do gëzohej bashkë me ne. Nuk e rregullon dot ti këtë, o zemër? Për mësuese bonjakja është e prerë tamam. Është e dhembshur shumë. Si gjithë bonjaket, do të thuash ti? Po ja që ajo nuk e di fare që është bonjake. Dhe as e di ç'do të thotë bonjake. Dhe s'ka përse, kur të njëmbëdhjetë djemtë janë për të vëllezër si ata divat e përrallës e ajo si ajo e bukura e dheut me babanë mbret e mëmën mbretëreshë mbi mbretër.

Ndaj them që ka në gjak mësuesinë. Këtë hall kam! A bën ta kërkoj që vajza ta këmbejë degën nga ekonomia te mësuesia? Në më ndihmon dot edhe ti, faleminderit. Në bëhet, më thuaj që bëhet! Në s'bëhet, më thuaj që s'bëhet! Vetën mos e vur në vështirësi. Vërtet vajzës i është puqur ylli për mësuese, por edhe në ekonomi e kandis unë të vejë. Ma dëgjon llafin. I kemi borxhe të gjithë Shqipërisë, duhen larë, dhe ajo e para nga shodet. Kaq kisha, o jetë, ika!

— Bëhet. — i thashë unë me sigurinë e njeriut që merr krah nga e vërteta e madhe e jetës së ndritur të tietrit. — Do ta ndreqim me shokët që ajo të dalë mësuese.

— Faleminderit! — tha motra e Bonit. — Ka fat ime bijë!

— Me siguri tashti, në ditët e zisë së Bonit, edhe mbesa mësuese është atje në dhomën e grave, me nënën e saj. Dhe dëgjon nga goja e grave vajet dhe bëmat e dajës së vet. Ish-ambasadorin, që flet e flet përkëtej në odanë e madhe të burrave, nuk kishte si e dëgjonte dot.

Varur në mur, fotografia e Bonit na shihte e na ndiqte disi e menduar të gjithë. Unë e vështroja i malluar e gati sa nuk fola me zë të lartë, gati sa nuk brita: «Bon, ç'hall të ka mbetur pa kryer? Ç'merak ke akoma?» Po Boni nuk kishte më as halle as meraqe. Fëmijët nuk i kish lënë pas të kamur e të marrë, por i kish lënë të drejtë e të ndershëm. Patjetër do të dinin ta ndanin shapin nga sheqeri, sic dinte ai. U kish lënë në dorë kandin e fisnikërisë së Duket. Ç'u duhej më tepër! Lum si ata dhe lum si ti, Bon Duka!

*Burrat si Boni vdesin, të tjerët mbarojnë...
E sosa dhe unë punën time.
Shëndet e nder të gjithëve!*

Gabelja e skavicës

Kam mall për këtë lumë, kam mall për këta gurë. Shumë vite të shkuara, gati që kur s'mbahet mend, kam filluar punën si gjeolog në këto vise të largëta veriore. Isha thjeshtë teknik, po thirresha inxhinier. Ishte koha kur inxhinierët qenë të rrallë, sa ç'janë akademikët sot, ndaj rritej shumë pjaca e teknikut. Dhe merreni me mend, ishim vetëm djem tetëmbëdhjetëvjeçarë, që sapo kishim mbaruar degën gjeologjike të Politeknikut, dhe ishim caktuar të gjithë shefa ekspeditash dhe ekipesh. Nuk ishim kot «bij të Politeknikut, që e ardhmja e lumtur na priste», siç thoshte kënga-marsh, që këndonim çdo mëngjes kur bëhej apeli i shkollës.

Punonim, pra, këtu në theqafjen e Drinit, në këtë grykë të keqe, ku kishte rrezik të thyenim qafën ne e jo Drini. Ishim një ekip i vogël

gjeologjik, një grusht çuna të pavënë brisk në faqe, që kërkonim metalin më të lashtë e më të vyer të kësaj bote, floririn. Kishim ditë që mundoheshim e rraskapiteshim me govatat e drunjtë, duke larë rërën pa fund të lumit, në zbulim të kokrrizave të imëta të djallit të verdhë. Lodheshim më keq se gratë e lavanterive të spitaleve, por ata të plotfuqishmit kristale floriri i hasnim aq rrallë, gati si bukën e grurit në ato mote misri, sa që kishim filluar të nevikoseshim e të grindeshim me shkak e pa shkak me shoku-shokun.

Dështimi ynë po shihej qartë dhe na kishin hipur kacabunjtë. Na kishin kapur ethet e tmerreshme të floririt, sëmundje e vjetër profesionale, që më saktë e më mirë nga të gjithë e ka përshkruar Xhek Londoni.

Dhe ja në një ditë e orë të tillë, kur dhe «shëndet!» të të thonë, të duket «plaç!», erdhi ai, malësori, që s'e kam harruar dhe sot e kësaj dite dhe s'do ta harroj kurrë edhe sikur të jetoj aq sa të bëhem abanoz e të kaloj shekullin.

Ishte pikërisht pisku i vapës dhe kulmi i humbjes së durimit. Ishim gati të gërnjarseshim për pesë para spec, kur befas na u shfaq ai, i papritur dhe i paftuar, si «fandi spathi», do thoshim më vonë.

Polici që na shoqëronte, hoqi pushkën nga krahu. Ishin ende vitet e para pesëdhjetë, koha kur në male haseshin diversantë. Xhabiri vuri dorën në kobure. Xhabiri qe punëtor i ekipit, në të vërtetë shoku im i fëmijënisë, «Xhabiri, nga vlonjatët më i miri», që sapo kish mbaruar gjimnazin, po kish hyrë në punë te ne, se i kish dalë

bursa për Institutin Bujqësor, të cilin nuk e pëlqente. Ai donte Fakultetin Juridik. Dhe kështu, këtë vit po e shtynte me ne si punëtor gjeologjie, që të mos i bëhej barrë familjes dhe ushqej me shpresën që mot do të vazhdonte drejtësinë. Ishte mbase kjo prirje e tij për drejtësinë dhe ligjin, që e bënte atë të kish armë. Revolverin, kënaqësinë e tij të vetme në këtë vit fatkeq për të, e kish marrë në degën e brendshme, kur filluam punën në këto male. Atje na thanë ç'rrezik kishim përpara, bandat vazhdonin, ndaj mund të mbanim armë me leje. U gëzuam shumë. Ishim çuna, dhe cili i ri nuk ka qejf të kapardiset me armë. Por dardha e kishte bishtin prapa, shokët e degës na paralajmëruan që, po të humbisnim revolverin (ndaj «ta ruanim si sytë e ballit»), dënoheshim me dhjetë vjet burg! Vetëm Xhabiri nuk pati frikë se e humbiste. Ne të tjerët nuk morëm. Nuk kishim asnjë mall për burg, por mbi të gjitha na mjaftonte polici dhe Xhabiri i armatosur.

Njeriu që na u shfaq pa prituri e papandehur, ishte trupimët, gërthje, i parruar, me sy të vegjël, të qeshur, pak dinakë, dhe tepër të gjallë, të shkathët si elektron i lirë. Ishte zbatthur, si fusharak e jo si malësor. Si ecte ai këtyre arcave thepa-thepa si biçaqe ashtu i zbatthur? Punë për të! Për ne, si tiranas, kishte tek ai dikë prej diversanti, por dhe më shumë prej tuahfi. Ishte pa armë. Diversantë pa armë s'ka.

Petkat e trupit i kish të stërvjetra, rrecka fare. Këmisha, dikur e bardhë, kish marrë ngjyrën kafe. Malësori, — vetëm ato që ndodhën më vonë e treguan për të tillë, — ndryshe nga ç'pa-

më atë çast, ishte i këputur e i pikur, sa s'të besohej kurrsesi që ishte vendas, burrë malësie. Të paktën, siç e përfytyronim dhe e njihnim në malësorin, nuk ishte!

Ai na ngjatjetoj me dinjitet, sipas zakonit. Na sqaroi kush që dhe si na kishte vënë re tek punonim. Nuk pyeti fare se ç'ishim dhe as u interesua të merrte vesh ç'bënim e nga vinim. Nuk i hynte gjë në xhep nga kjo anë. Thua se kish parë gjeologë tërë jetën, si çobani dhentë. Në vend të kureshtjes së natyrshme, ai na shfaqti pezmatim të jashtëzakonshëm. Atë pezmatim që na hutoi dhe na gjeti krejt bosh.

— Më keni koritë, burra! — Kaq tha ai me bindje burrërore.

Ne vështruam njeri-tjetrin në sy, gati të shastisur. Si, ku e kishim turpëruar këtë njeri? Ç'të keqe i kishim bërë? Ktheva kokën nga polici. Ai që më i gjezdisuri e më i regjuri nga ne. Por polici kish hapur sytë sa një filxhan, i hutuar. Ishte e qartë që as ai nuk kuptonte dot se si e kishim koritur këtë dyzet-kile-burrë. Kur dhe qysh e kishim prekur atë në sedër? Ç'kishim bërë?

— Shih udhën tënde, se s'të ka ngarë njeri! — tha me inat Xhabiri. Kish të drejtë. Ne kërkonim kaq kohë floririn dhe gjenim vetëm kristale piriti! Na kish ngordhur gomari dhe tanu s'na linin rehat as mizat.

Malësori bëri sikur nuk dëgjoi; ishte tepër krenar që ta shiste lëkurën lirë me inatet tona. Nuk u fye, ishte mjaft i rrahur nga jeta që të matej me rininë tonë. Ai nuk ia vërshëllez fare

Xhabirit, paqka që tjetri vazhdonte të mbante dorën në kobure.

— Më keni koritë, burra, — përsëriti ai refrenin e vet. — Qe, aty nalt (dhe tregoi me dorë, diku larg në majë të malit, të paktën një dy orë larg) asht kulla ime!

Kulla, atje ku tregoj ai, nuk dukej. Me vështirësi atje lart dallova një si vathë a nome bagëtish.

— Atje asht kulla e këtu ku jeni ju janë trojet e mia!

S'ma merрте mendja kurrë të ish kaq i pasur ky njeri i rreckosur, sa të kish trojet e domenet e veta kaq gjerë të shtrira.

— Ka ik koha e trojeve të tua, kapedan! — tha polici, — Ka ik koha e bajraktarëve!

Xhabiri miratoi me kokë. Unë u habita si e njohu polici kulakun, kur ishte kaq i handakosur.

— Mos, bre, burrë i dheut! Mos e qit atë fjalë, — tha malësori, i prekur. — Se as kapedan e as bajraktar nuk jam e as për fis e kam. Veç, sa për Drinin e bjeshkët përreth, e di mirëfilli që janë të Shqipnisë, e unë jam shqiptar e këto troje, pra, janë të miat.

— Hadje, mendje, hajde! Na zbulove Amerikën! Aherë janë dhe tonat, pra! — tha Xhabiri, «nga vlonjatët më i miri». — Se dhe në shqiptarë jemi e s'kemi zbritur nga Azia.

— Tamam, ashtu besa! — e mbështeti malësori. — Por sot jeni ju që më keni ra mik në trojet e mia, te kulla ime (kulla që s'dukej gjëkund), e mik që s'të shkel kullën, s'ka si bahet. Urdhëroni t'ju pjek një kafe, burra!

— Po kështu thua, a derëbardhë, që na fton të bujmë në shtëpinë tënde, se na plase me trojet e me kullat! — tha Xhabiri, dhe u bë gati për udhë.

Mirë Xhabiri që u bë gati të nisej, po polici nuk lëvizi. Ai qëndroi i mbërthyer atje ku na kish gjetur malësori. Shikimi i tij fliste shumë. Ai më dha të kuptoj se s'kishim ku venim. Se nuk i dihej ç'njeri ishte ky dhe ku do të na çonte. Polici nuk foli, foli heshtja e tij. Më binte mua, shefit të ekipit, të merrja vendimin. Dhe unë vendosa:

— Faleminderit, — i thashë. — Të paçim! Herë tjetër, po të punojmë lart në bjeshkë, pa tjetër do të ta shkelim kullën. Na prit në daç për kafe e në daç për raki! — Tingëllonte disi ironike kjo që thashë, ndaj shtova: — Por sot nuk na premtan koha dhe punën s'e lëmë dot në mes.

— Puna këtu asht, — ma ktheu malësori. — Puna pret dhe s'asht arë që të ikë.

Shfrytëzova metaforën e tij dhe vazhdova:

— Edhe kulla jote aty është, nuk ka këmbë që të ikë.

Ai heshti. Nuk ngulmoi më. Vetëm na pa me keqardhje dhe trishtim, thua se ishim gjynahdarë! Sot jam i bindur se atë ditë atij nuk i shkoi mendja hiç që ne nuk ia pranuan ftesën për kafe vetëm se nuk e njihnim ç'njeri ishte. Si e thashë, kishte akoma diversantë në male dhe ne kishim të drejtë të dyshonim. Ai vetë s'qe i tillë dhe s'kish si të na kuptonte. Me siguri na mori atë çast për diem qyteti, cuna mamakash, që përtonim e s'kishim këllaç të ngjiteshim maleve, paçka se qemë gjeologë.

Malësori, i vrarë në krenarinë e vet, priti dhe pak se mos ndoshta ndryshonim mendim. Dhe si e pa që ne filluam prapë punën, na përshëndeti dhe iku. Nuk na dha as dorën. Ishte prekur dhe inatosur shumë. Mua më erdhi keq që ndodhi ashtu, po rrugë tjetër s'kishte. Nuk e njihnim kush që dhe ç'na duhej dasma në Karbunarë!

Do ta kishim harruar përgjithmonë atë malësor të varfër, që kish trojë sa një pashallëk. S'ishte as i pari e as i fundit malësor që takonim. Vazhduam punën, por tani, përveç lodhjes dhe vapës, kishim dhe mëdyshjen se mos bëmë gabim që s'pranuam ftesën. Na brente ndër-gjegjja e na hante dyshimi, që s'mund të qe jaktak për diversantë dera e një të këputuri si ai! Po ku i dihej? «Kur s'ke pula, pse të bësh ysh!»! tha polici, dhe kjo na ngushëloi disi.

... Dielli po perëndonte dhe dukej sikur na përqeshte, aq i gëzuar ishte syri i tij i zjarrtë. U bëmë gati të linim punën. Vumë govatat e drunjtat në sqetull, si djepe çilimijshe, kur gati hajdutce (kur vajti dhe kur erdhi kaq shpejt!) ia behu prapë malësori. Ishte tepër i lumtur që na gjeti rishtas. Ç'fshihej pas kësaj lumturie? Ç'kërkonte nga ne?

— Shyqyr që ju kapa, burra! Kafën nuk ma sajdisët te kulla. Por pa gjë s'mund t'ju lë të ikni nga trojet e mia, — tha malësori i imët sa një harabel.

C'na polli belaja me këtë tuhaf, — mendo-va. Na u bë rrodhe.

Malësori nxori nga gjiri një shishe raki, një bukë misri dhe pesë kokrra qepë, të bardha borë

si plisi i tij. Aq qepë sa ç'ishim dhe ne, pjesëtarët e ekipit.

— Bujrum, burra! Pini për qejfin tuaj dhe gazin e kullës! — na grishi ai.

I pari e vuri grykën e shishes në buzë Xhabiri, pastaj unë dhe dy shokët e tjerë. I fundit polici.

— Pak e butë, — e vlerësoi polici rakinë, — por e dashur.

I uruam shëndet malësorit dhe fëmijëve të tij. Ngritëm doli për kullën, që s'ia shkelëm. Hëngrëm misërniken e verdhë me qepët e bardha, që na shijoi shumë, se kish kaluar vakti i drekës dhe na kish marrë uria. Falënderuam siç e do zakoni: Paç e dhënç!

Rakia që prej kumbulle, fare e zakonshme, me siguri e zier vetëm një herë. I zati i saj s'ishte i kamur që ta ziente dy herë. Por përveç asaj dite as kisha provuar dhe as kar pirë më kurrë raki në theqafje të Drinit, në kanionet e Skavicës.

— Ma keni ba qejfin fort bukur, burra! Me tamam! — tha malësori. — Ju falem nderit!

— Nderja jote dhe gëzimi ynë, — ia ktheva unë me një fjalë të urtë, të marrë borxh nga lalëzoti im, vite më parë.

Malësori qeshte i tëri. Ishte i lumtur si fëmijë.

U ndamë të kënaqur të dy palët. Ai, që nuk u korit me ne, jabanxhinjtë e maleve, dhe ne, që hasëm e njohëm një njeri të çuditshëm, të rrallë si ai, që ç'i hante syri, mal më mal, ishin trojet e tij dhe ç'kalonte andej udhëtar, duhej të ish mik i tij dhe në besën e tij.

Të tillë njerëz nuk harrohen, por as takohen kollaj. Më s'jam takuar me të, por, kur kaloj më të rrallë kësaj rruge të rrezikshme, një herë në katër pesë vjet, sytë më venë përherë atje lart në bjeshkë (ku tregonte ai për kullën e tij, që s'ish kullë, po nomë barinjsh) dhe shoh që përherë e më shumë shtohen atje shtëpitë. Fisi i tij bujar, siç duket, rritet e rritet përvit. Kam dashur e kam thënë shpesh, të vete e të ngjitem njëherë në atë fshat, që po buit pak e nga pak, po rruga është e gjatë dhe Drini në mes më tremb, se tani vërtet s'kam këllqe për ato maja.



... Dhe ja tek kam ndalur e qëndruar përsëri më këtë anë të Drinit plak dhe kundroj bjeshkët matanë, ku ka shtëpinë malësori që kam njohur tridhjetë e ca mote të shkuara. Atje janë bërë tashmë mbi dhjetë shtëpi, fshat tamam, dhe cila nga ato është e tij? Kushedi! Dhe a rron më, vallë, ai dhe sot e kësaj dite?!

Rri, shoh dhe mendohem. Më ngjan vetja si Çezari kur kaloi Rubikonin dhe tha: Erdha, pashë, fitova! Shoferi nuk mërzhitet dhe pret sa të ngopem me malet. «Kështu e kanë këta shkrihtarët!», — duket se më thotë heshtja e tij olimpike. Nuk i them se ç'mall e hall kam. Zor se do të më kuptojë. Është djalë i ri fare, gati aq sa unë atë vit kur nuk merrja vesh pse e kishim turpëruar malësorin e varfër.

Dëgjoj hapa, dëgjoj tingëllima, që më vijnë nga pas. Kthej kokën i çuditur. Nuk janë hapat e shoferit dhe as çelësat anglezë të tij që trokasin në diskun e hekurt të rrotave të makinës. Jo! Janë zilet e mushkave dhe hapat e një tabori të vogël ciganësh.

Kjo më huton fare. Ciganët në Grykë të Skavicës! Ç'duan këtu? Nga vijnë? Ç'kismet kurbet i ka sjellë në këto vise të thella?

Dy mushka të ngarkuara. Gruaja me vestë të gjatë, deri në fund të këmbëve dhe me një foshnjë në sisë. Burri, me mustaqe të gjata, vesh më vesh, si të Salvador Dalisë, me dy fëmijë për dore. Dhe pesë fëmijë të tjerë, që ecin të lirë si mëza, të shkujdesur si konviktorët në liralalje. Ky është gjithë gjithë tabori.

Përhëndetemi me gabelin e pashëm, ashik, që ia di vlerën vetes. Më flet dhe i flas. Këtu ku kam ndaluar e kam rënë në kujtime, është shullë i mirë, me diell shumë e erë pak dhe pranë rrjedh e murmurit dhe derdhet në Drin një vijë uji e vjetër e ndonjë mulliri të harruar në shekuj. Vend i mirë për pushim. Mrekullia vetë!

E shoh që gabeli ka synuar të ngrejë çadrën këtu. E njihka mirë këtë vend. Por, meqë unë kam ardhur para tij dhe tashmë e kam zënë, largohet më tutje, pranë një ftohtësire.

I bëj zë të kthehet. I them se jam për udhë dhe se kam qëndruar sa të cmallem me këto male të dashurisë së parë me gjeologjinë. Tund kokën i habitur. Nuk e kupton ç'grua ka qenë kjo gjeologjia ime, që paskam bërë dashurinë e parë me të në këto male. Por ftesën për vendin me diell e pranon dhe falënderon me mirënjohje.

Gabeli thërret të vetët të shkarkohen këtu. Zgjidh barrën e mushkave. I mbulon vithet e tyre me thasë, që të mos ftohen nga djersa dhe merr një shkorse dhe e shtron përdhe, që të rri rehat unë, miku i tij.

Dhe aherë unë kujtohem t'i ofroj cigaren. E merr dhe e ndez me uror. Vjen era e këndshme e eshkës së djegur. Kundërmon erë e mirë.

Fëmijët dhe gruaja rregullojnë plaçkat. Pastaj mbledhin shkarpa të thata. Duan të ndezin zjarrin. Cigani baba pi cigaren me mua, kurse eshka erëmirë, që digjet si thëngjill i fshehur, merr rrugën për te zjarri i ardhshëm i shkarpace. Ky zjarr është kulti më i shenjtë i ciganëve. Shpesh ata nuk pranojnë të jetojnë në apartamente, se nuk bëjnë dot pa këtë perëndinë e vjetër të njeriut, flakën e zjarrit që të verbon sytë. Zjarr në kuti e gabel me varr nuk ka.

Fëmijët kënaqen me gjuhët e flakës, si ata të moçmit njerëz që zbuluan zjarrin.

— Të tutë? — e pyes kot fare ciganin për fëmijët.

— Të gruas dhe të mitë, — më përgjigjet ai.

— Mashallah! I paske, të tetë, njerin më të bukur se tjetrin, — i them unë.

— Të bukur, hak! Si zogj gabeli, — thotë ciganin. — Por kam edhe dy të tjerë edhe më të bukur. Artistë kinemaje. Janë më të mëdhenj, por, ç'e do, më kanë dalë dore! Kanë hyrë në punë në metalurgjik.

— Ku? — hutohem unë, duke kujtuar se s'kam dëgjuar mirë.

— Në Elbasan, — më sqaron e më shton dyshimin ai.

— Po si në Elbasan? A nuk jeton në Dibër?
— e pyes unë, duke menduar që në lindje të Skavicës, nga kjo anë e rrugës që erdhi tabori i kurbatëve, është vetëm Peshkopia.

— Jo, çne me lazëm nga Peshkopia. Jo! Jemi nisë nga Peqini. Dimrin e shtyjme në Peqin gjithnji.

Dhe kurbati, fodull për Peqinin, më nxori papritur nga kuleta e xhepit të thellë të shallvareve (aq, sa i zhytej krahu deri te brryli) pasaportën. Thua se i kërkova të më vërtetonte identitetin. Vërtet, ai ishte Abdyrrahman Peqini.

— Raxh. Hape radion të ndigjojmë aheng!
— urdhëron cigani baba, Abdyrrahmani, njërin nga çunat e vet. Ai që quhet Raxh, ndoshta për respekt ndaj yllit të filmit indian Raxh Kapurit, gjen valën dhe stacionin e dëshiruar në radion me bateri «Iliria». Dëgjohet «Allah, shofer, Allah»! Me siguri Radio Prishtina.

— Është dora jonë, — thotë i gëzuar cigani baba për këngëtarin e Prishtinës. — Hak, harapçi!

Gruaja e gabelit ka ndezur zjarrin. Ka vënë pirustinë e zezë dhe në një ibrik bakri të verdhë, nga ato që sot i sheh vetëm në ekspozitat etnografike, po zien ujë. Nuk qenka ujë, qenka çaj, se pas pak në një gotë alumini vezulluese gruaja më servir çajin aromatik.

— Ilaç çaj! — ma reklamon nikoqirja. — Çaj Martaneshi. Çaji më i mirë i tanë botës.

Gjerb, si kafe, çajin e nxehtë, më të mirin e botës dhe vërtet më shijon pa masë.

— Të lumshin duart! — uroj nikoqiren.

— Për çaj dhe kalamaj kjo është e vetmja!

— thotë me krenari cigani baba, Abdyrrahman Peqini.

Nikoqirja buzëqesh hijshëm, sa për vete.

— Po pse çaj Martaneshi? — kujtohem të pyes unë për origjinën e çajit të shijshëm.

— Se është më i miri i botës, pra! — përsërit nikoqirja dhe vazhdon: — Gjithmonë ne andej kalojmë për të ardhë nga Elbasani në Dibër. Çajmë nga Peqini në Elbasan xhades së madhe, prej këndeje në Çermenikë, xhades së vogël. Pastaj, rrugë e pa rrugë në Martanesh, Krastë, Bulqizë, Peshkopi. Vrapin e mbajmë nëpër grykën e Drinit, deri këtu ku po llafosemi sot, në Skavicë. Ngjitemi Qafës së Kolosjanit dhe zbresim nga Bicajt në Kukës të ri.

Ky qenka itinerari i kohëve moderne të taborit cigan. Më habit saktësia me të cilën ajo i përshkruan vendet. Dhe më shkon mendja që këta duhet ta bëjnë behar për behar këtë rrugë të vështirë, këtë shtegtim kurbatësh.

— Bëkeni kurbet të gjatë, — i them ciganit.

— Jo dhe aq, — ma kthen nikoqirja. — Dhjetë-pesëmbëdhjetë ditë rrugë.

— Si të jetë pazari, — shton cigani baba.

— Po çfarë shet këtyre anëve? — interesohehem unë.

— Nuk shes. Vetëm blej! — përgjigjet ciganit.

— Si vetëm blen? Po xhingla-mingla nuk shet?

— Jo, — ndërhyt gruaja. — Me to merreshin cunat. Ata të Metalurgjikut bënin byzylykë e vathë për merak e për sevda.

— Lënë kokën gaxhijet pas byzylykëve ta-

në, — thotë i përgjëruar cigani baba. — Fare
tamañ!

— Tashti çunat e lanë zanatin e babës e
merren me nikelin, — sqaron disi me keqardhje
gruaja.

— Një gjë që blihet dhe shitet, — i kthe-
hem përsëri unë fillimit të bisedës. — Apo me-
rreni me kontrabandë floriri? — pyes unë pa-
pritmas, kot fare, duke u kujtuar që dikur, kë-
tyrë brigjeve të thepisura të Drinit kërkoja kris-
talet e këtij metali.

— Çfarë floriri, mor shok? Për ç'kontra-
bandë flet ti? Gabel që shkel ligjet e qeverisë
nuk ka! S'është puna jonë ajo! Unë blej llastik-
pplastika dhe ia dorëzoj shtetit në Elbasan! Punë
e pastër, pa hile.

— Ç'llastik-pplastik? — habitem unë, që
nuk kuptoj dot për çfarë bëhet fjalë.

— Gomë llastiku, — sqaron gruaja.

— Po gomë-plastika është në Durrës, —
them unë, — ç'do Elbasani?

— Është dhe në Lushnje, — shton Abdyrrah-
mani. — Por sandalet prej llastik-plastiku mba-
then nga njerëzit këtej në këto male. Unë i
mbledh këto dhe i dorëzoj në Elbasan.

Më në fund e mora vesh që ai grumbu-
llonte sandalet plastike. Dhe m'u kujtua fëmij-
nia, kur dilte në mëhallën tonë jevgu ynë dhe
thërriste: «Kundra të vjetra kush ka me shit,
kush ka me shit!» Zanat i vjetër shumë ky i ga-
belit të Peqinit, por tashmë i harruar.

— Ka një dy muaj që shteti merr llastik-
plastikat e vjetra, të përdorme. I blen me kile.
Me pare në dorë. Por ata të tregtisë janë tuhafë

të mëdhenj. Kujtojnë se me një shpallje të Bashkia e merr vesh gjithë Shqipëria! Kështu që, sa të vijë lajmi këtyre anëve, unë po i blej xhaba. Sa t'i hudhin mileti llastik-plastikat në lumë, m'i falin mua. Kam fitim e qar të madh. S'bëhet tregti me llafe, bëhet me këmbë! Por vetëm këmbë ata të tregtisë nuk kanë. Mëndje, kushedi, kanë, por këmbë hiç! Dhe shyqyr që s'kanë ata dhe kam unë! Risku i kalamajve të mi. Shife, një mal me llastik-plastika kam mbledhur, — përfundoi cigani monologun e vet të gjatë dhe më tregon dy dengjet e mëdha të mbushura plot, që janë shkarkuar nga mushkat. Dhe sikur të isha punonjës i tregtisë, më dha një leksion tërheqës për shitblerjen e mallrave.

— Po pse i dorëzon në Elbasan dhe nuk i çon drejt e në Lushnjë? — pyes unë i çuditur ekspertin dhe komivuajazhërin e vetëm të Alpeve. Dhe për një çast vë në dyshim, me këtë pyetjen time, aftësinë dhe shkathtësinë komerciale të tij. Harrova që fisi i tij është fis xhambazësh.

— Ah, ç'na thënke? — ma kthen ai gati me përçmim. — Ama, pyetje? Po Lushnja është matanë Shkumbinit dhe ne, gabelët e Pëqinit, nahijen e pazarit e kemi Shkumbin e lart, Shkumbin e përpjetë! Ç'kap Shkumbini e poshtë, i kanë gabelët e Toskënisë. Secili fatin e vet. Mos hyr në hise të tjetrit, se të del harram!

Kisha kohë pa dëgjuar ndarjen Gegëri e Toskëri. Jemi mësuar tashmë me rrethe e zona dhe s'më shkante mendja që për kurbatët vazhdon të kalojë kufiri në Shkumbin. Dhe me këtë kufi ndakan dhe zonat e influencës.

— Hajde, Bardhoshe! Tregoji këtë mikut llastik-plastikat tona! — urdhëroi cigani, duke m'i prerë në mes persiatjet e mia.

Kujtova se i bëri zë mushkës ashtu, por mushkë të bardhë s'ka. Kujtova se mos i thirri ndonjëres prej bijave, por as një nga vajzat nuk lëvizi. Jo! Bardhoshe qenka e shoqja. Ajo u ngrit e erdhi me një krahë sandale të vjetra plastike, që i merrka Grumbullimi me para në dorë.

Gruaja u afrua fare pranë. I lëshoi pa qejf sandalet gjithfarëllojesh para këmbëve të mia dhe, për çudinë time të madhe, vetëm tani vura re që ajo ishte ashtu siç e kish emrin, Bardhoshe! I shqova flokët, që i dilnin cullufe mbi ballë nën shaminë tërë ojna. I kish të verdha dhe sytë të kaltër. Det dhe qiell bashkë. Cigane bjonde s'kisha parë ndonjëherë dhe habinë nuk e fsheha dot.

— Mos u huto! — më tha gabeli. — Të gjithë çuditën me të, ja, kështu si ti. Është nëna e mirë e kalamajve, ime shoqë, por nuk është nga dora jonë. Është e dorës suaj, gaxheshë! Por unë nuk fshihem pas gaxhoit, fshihet ajo pas meje. Apo jo, Yll i Elbasanit?

Tjetra qeshi. I erdhi mirë që burri e vlerësonte edhe para mikut kaq lart.

— Ndoshta kam qenë dikur yll i Alpeve, Abdyrrahman, — tha gaxhesha.

U befasova. Nga e dinte ajo këtë fjalë! Alpe! Nuk duhej të ishte analfabete, kur njihnte gjeografinë kështu.

— Tashti kam dhjetë fëmijë dhe kam ata yje, njërin më të bukur se tjetrin. T'u marrësh

kokën e të ikësh, — tha gaxhesha dhe pastaj m'u drejtua mua.

— Shok i mirë, mos i dëgjo të gjitha ç'thotë im zot. Këtë rrugë në këto vise ne e kemi bërë gati vit për vit në behar, edhe pa dalë pazari i llastik-plastikut. Sa herë më merr malli për robt e mi, i them Abdyrrahmanit: hajde të shkojmë përpjetë Drinit. A i shef ato shtëpitë atje, në krye të malit? Ato që janë të shpërndame si dele pa çoban? I shef? Atje, bash, aty kam lindur unë!

E pabesueshme! Ajo tregonte atë fshat ku dikur ishte nomeja a vatha e malësorit bujar, që e patëm koritur dikur, kur s'i shkelëm në kullë! Mos ishte kjo vallë e bija?

— Si paske lindur atje? Si qenke ti, kështu, malësore? Po aherë ç'kërkon me... — Unë nuk e çoj dot fjalën më tej. Por më ndihmon pa asnjë kompleks i shoqi, cigan baba.

— Gabelët. Është histori e bukur ciganësh. Për libra, por jo përrallë. Rrëfeja, Bardhoshe! — urdhëron kurbati.

— Besa, është histori e gjatë boll, — thotë ajo, — e shoku është për udhë.

— Kam kohë, — them unë, i ngacmuar nga e papritura që sapo kisha dëgjuar. Nuk të qëllojnë shpesh të papritura të tilla. Dhe unë s'jam aq i pasur sa ta lë të më humbasë ky rast i rrallë i historisë së malësores Bardhoshe, që shton fisin e gabelëve.

— A po hani një copë bukë me ne? — më ftoi gabeli në sofrën e tij. — Duke hangër e duke folë. Një rrugë e dy punë, gabelce!

Dy të ngrëna s'bëjnë keq. Edhe sikur të më

qëllojë të ha drekën në turizmin e Kukësit, ku zor se do te arrij...

Bardhoshja na pret fetat e bukës dhe të djathit dhe njëherësh pjek vezët në hirin e nxehtë të zjarrit. Me siguri, s'ka tëlyn a vaj për t'i fërguar. Dhe m'u kujtua fëmijëria, kur po këshitu, kur s'kishim gjalpë a vaj, gjyshja ime e rrallë, hallë Mara nga Himara, na piqte vezët. Sa të piqen vezët në zjarrin cigan, unë u tregoj miqve shtegtarë për malësin bujar të viteve të shkuara, historinë që sapo jua tregova dhe juve.

— Burrë i mirë! I varfër, po mikpritës, — thotë Bardhoshja.

— Tamam gabel! — përforcon cigani baba.

— Mos ka qenë babai yt? — pyes Bardhoshen.

— Nuk e di, unë e shkreta. Kushedi! S'e kam dëgjuar ndonjëherë. Veçse baba im di shkrim e këndim. E mësoi shkrimin kur që vullnetar në hekurdhë. Shkrimi u bë shkak që ika nga shtëpia.

— Si shkrimi?! Deshe të vazhdoje shkollën dhe s'të la babai? — pyeta unë.

— Jo, bre, shokë! Por njëherë tatës i falën një stilograf shokët e qeverisë, si i dalluar në punët e Frontit. Stilografi që i bukur fort, me një majë gjilpanë si prej sermi. Në të vërtetë, kish pasë qenë majë platini. E mora vesh më vonë që kish pasë qenë majë e vyer. Vazhdoja klasën e tretë fillore. Shkruaja me kalem. Si gjithë kalamajtë e tjerë. Stilograf s'kisha parë ndonjëherë. Më dukej si magji. As mësuesi ynë nuk kishte stilograf. Ai shkruante me penë druri.

Kallamar, i thoshte, që e ngjyente, si pulën kur pi ujë, në mellan. Kështu i thokan në Gjirokastër, nga ishte mësuesi, bojës së shkrimit. Kurse në kishim stilograf. Baba e ruante si sytë e ballit. Më shumë ruante stilografin sesa revolen. Armën, kur hante bukë, e hiqte nga brezi, stilografin kurrë! Gjithnjë e mbante në xhep të këmishës, tok me shenjzat e sulmuesit të hekurudhës. Ai punonte korjer i zonës, por ishte dhe si sekretar këshilli. Si për detyrën që paguhej, ashtu dhe për të dytën, që e bënte pa pare, i duhej stilografi. Mbase për këtë ia kishin falë. Por si do bëhej e keqja! Një mbasdite, kur po plotësonte shkresat e këshillit, e thirrën me ngut. Iku me vrap dhe e harroi stilografin. Unë u gëzova se me të mund të bëja detyrat e klasës xham, më mirë nga të gjitha shoqet. E para e klasës. Kisha gaz të madh, por gazi i tepërt të del prej hundësh. Mora stilografin dhe shkrova e shkrova të gjitha detyrat, jo vetëm për të nesërmen, por për gjithë javën. Ai s'të lodhte fare, rrëshqiste si mizë dheu mbi letër dhe s'kishte nevojë për shishe boje, mellan, të mësuesit. Stilografi e kishte depon e bojës me vete. Me i pa detyrat e mia atë ditë, të kënaqej shpirti. Më bukur se librat e Tiranës. Isha e hutuar, e shushatur fare nga gëzimi. Do çuditëshin shokët dhe mësuesi. Dhe vërtet u çuditën të gjithë. Madje gjithë katundi! Ishte gëzimi apo hutimi, nuk e di. Por asaj dite ce sahati i keq për mua. Për drej, si mbarova detyrat dhe desha t'i vija kapakun, stilografi më ra nga dora. Pingul e përtokë. U bë hataja. Stilografi u thye mes për mes. M'u bë se më ra bota përsipër kresë dhe jo stilografi

përtokë. Bota më ra vërtet përsipër kur erdhi tata dhe pa ç'kish ndodhur me penën e tij.

Qaja me ngashërim, e dija ç'faj kisha bërë, por baba është inatçi i fortë dhe lotët nuk i shef dot. Më rrahu shumë, që të qaja me hak. Atëherë mua më menë lotët dhe ai më rrahu më keq, sa i hante krahu. Nuk e kishte hallin se do mbetej pa shkruar, se katundi ynë është i vogël e këshilli s'ka shumë shkresa, por pati maraz të madh se stilografin ia kish falë qeveria dhe s'dinte ç't'u thoshte shokëve të pushtetit. Për të stilografi i çartur ishte më turp se me humbë revolen. Për revole do të dënohej si burrat, për stilograf as si gratë s'dënohesh dot. Marre e madhe!

— Rob i trashë fort, — ndërhyu gabeli. — Nuk rrihet ihsani si hajvan. Ca më shumë mbi evlatin nuk vihet dorë kështu.

— Jo! Nuk është i trashë baba, por ka sedër të madhe, sedër burri! — e merr në mbrojtje e bija të atin.

— E, burrë i zoti shumë! Ha inat me kalamajtë! — thotë me përçmim gabeli.

— Po pastaj, ç'ndodhi? — pyes unë me nxitim, hem për të marrë vesh fundin e historisë e hem të mënjanoj sherrin midis gabelit e gaxheshës.

— Pastaj e mora unë nuse! — ia pret shkurt Abdÿrrahmani.

— Prit, ta them kaun e pastaj t'ia shesim lëkurën, — i thotë Bardhoshja urtë të shoqit dhe vazhdon duke m'u drejtuar mua.

— Pastaj ç'ndodhi?! Baba është inatçi i madh, por inatçorët janë njerëz të mirë. Ta dish prej meje këtë! Ata janë si det me tallaz, gjithë

kripë e lezet, e jo si ujët e ndenjgur, që qelbet. Inatçorët janë si ne gabelët! — thotë Bardhosha.

— Çfarë gabelësh?! Çfarë deti me tallaz, kur ai e qelbi fare me ty! Ufull që të shkul zorrët, ja ç'janë inatçorët, — thotë Abdyrrahmani. — Por thuaj që ishte kismetimi im i mirë me të pasë nuse me kimet përjetë, ty, o yll i Elbasanit!

— Inatin e pati të madh tata. Më përzuni nga shtëpia. Aq i tha mendja atë çast, po unë, qyqja, si e besova? Dhjetë vjeç isha, kërthi e jetime. Nëna më kish vdekë. Kalamajtë e tjerë qenë më të vegjël se unë. S'më doli njeri në krah. Kam qenë budallaqë e madhe atë ditë, e vogël më fare. Nuk e dija që inati i babës nuk mban gjatë. Ika, mora vrapin e dola në xhade të madhe. Nji këtu! Siç e shef dy orë larg katundit. M'u mor fryma. Bante ftohtë i madh. Akull. Ishte dimër. Ngriva. Me iu dhimb dhe gurit dhe drurit. Kështu isha bërë.

Në xhade të madhe më gjeti, as të gjallë e as të vdekur, një shofer tiranas. Shpirt njeriu. Më mori në makinë. Në Dibër më erdhi fryma në vend dhe goja m'u hap. I thashë ç'më kish gjetë. I erdhi keq e më çoi në Tiranë te njerëzit e vet. Më tha: «Motër s'kam. Do jesh motra ime!» Më mbajti vërtet si motër edhe nana e tij si bijë. Një vit të tanë. Isha e lumtur, aq sa s'po më merrte malli për babën. Mbas një viti shoferi u martua. Pata gëzim të madh në dasmën e tij. Atë ditë u kam nda karamete e llokume krushqve sa për gjithë jetën. Por ç'e do, nusja qëlloi terse e madhe! Nuk më deshi hic. Mbas një jave filloi sherrin. Nisi me thanë: Ç'e keni

këtë kopile?! Më vrau më keq se baba. Por bonjakja bonjake mbetet. Pa ç'pa nana e mirë e shoferit të urtë dhe, që të mos i prishej djali me nusen, më mori e më çoi në Shtëpinë e Fëmijës. Atje nuk më pranuan. Kishin të drejtë. I thanë shoferit dhe plakës se, meqë më kishin bërë vajzë për shpirt, «mbajeni dhe rriteni ju. Kjo s'qenka gocë pa njeri», thanë ata të Shtëpisë së Fëmijëve. U ktheva prapë në shtëpinë e plakës. Mbarova shkollën fillore. Sherri vazhdonte edhe më i madh. Nuses së shoferit i lindi fëmija e parë. Vajzë dhe ajo. U bëmë si dy kunata në një derë. Nusja e kishte inatin më të gjatë se baba im. Asaj inati nuk i ikte kurrë. Ia nxiu jetën shoferit. Plaka vdiq nga merak. Puna arriti deri aty: ose unë në shtëpi të shoferit, ose nusja inatçore. Po prishej familja. Atëherë iu luta shoferit të më çonte te baba se nuk jetoja dot ma atje. «I ka dalë inati», i thashë. Kishin kaluar dy vjet që atëherë. Shoferi pati frikë të më kthente prapë në katund. «Janë malësorë e të vrasin. Do kujtojnë se të kam rrëmbyer! — më tha ai. Dhe në vend që të më çonte në katund, më hipi përsëri në makinë dhe më dorëzoi në Peqin te gabelët.

— Te baba im, — sqaron Abdyrrahmani. — Ishin miq me shoferin. I pëlqente ahengu jonë e linte kokën mbas së folmes sonë. Njeri i mirë, i shkreti shofer, por pa fat. I ra nusja xheloze! Gaxheshë e prapë!

— Ja, kështu përfundova në taborin cigan. Mbas një viti më martuan me Abdyrrahmanin. Ky qe shorti im. Kështu e kisha të shkruar, — thotë Bardhoshja.

— Short i mbarë! — thotë gabeli për vete.

— Po s'të vajti ndonjëherë mendja më për babanë? — pyes unë, i gjetur ngushtë nga gjithë kjo histori.

— Më vajti. Si nuk më vajti? Dhe se më shkoi mendja për të atë vit që polla fëmijën e tretë, i thashë tim zoti, e luta të shkonim një herë në malet tona. Bash rruga s'më kujtohej, por, po të dilnim, një këtu në Skavicë, e mbaja mend. Le që prej këndeje edhe katundi ynë duket.

— Me tamam kështu, kështu ka qenë. Kjo u bë sebeb që unë qëllova i pari i gabelëve, që bëra kurbet në këto anë. Ec e ec atë behar Drinit. Kishim hudhë pas krahëve Dibrën dhe morëm malet. Më në fund mbërritëm këtu, ku jemi bashkë tani, or dashamir, dhe ajo briti dhe më tregoi katundin e vet. Shtanga si gurr vorri. Nji bythë katund! E mbante mend e shkreta! Si puna e zogut, që s'e harron folenë e vet. I dhashë leje me zemër të ngrirë të shkonte e të takonte të vetët, fisin e gaxhojve. Më la këtu dhe iku si era. Pata frikë se po më ikte përgjithmonë! Por, kur pashë tre gabelët e vegjël që kishin ngelur me mua, niani ma i bukur se tjetri, u qetësova. M'u ngroh gjaku në deje. As bushtra nuk i len këlyshët rrugëve. Jo ma gaxhesha kalamajtë e vet! Apo e kam gabim? — më pyeti gabeli Abdyrrahman.

— Ika. Kaptova Drinin. Mbërrita në katund. Mbas tetë vjetësh. Nuk më njofti njeri. Isha bërë tjetër. Kisha pas ikë cucë e kthehesha nanë me tre fëmijë. Tek shtëpia e babës, motrat dhe vëllezërit e mi të vegjël u hutuan.

Ç'donte gabelja në kullë të tyre? Tata nuk ishte. Shpërndante postën në lokalitet. Pata frikë se do më gjuanin me gurë, duke më marrë për hajdute. Më ka ndodhur dhe kësisoj në këtë jetën time prej gabeleje. Gjetkë. S'më qëlloi njeri. S'më gjëmoi njeri mbrapa. Askush s'më ngau dhe askush s'më shau. Askush nuk më njohu. Përkëdhela kryet e vëllait të vogël. Ishte rritë e ba sa unë kur u arratisa prej katundi. Desha ta puth. Ai u tut e iku me vrap. Ku shkon, mor teveqel! e shau vëllai i madh. Pse trembesh? Merri e jepi një copë bukë e hajt udha mbarë! Më dhanë bukë. Dhe buka vinte erë babë e nanë! M'u ngjall nana, që kish vite që na kish lanë. Qava. Vetëm aherë qava. Me ngashërim qava me lot sa rruazat e shegës. Dhe ika pastaj duke qarë. Mjerë unë e mjera, nuk më njoftën fatzezën për motër! Nuk u thashë cila isha. Nuk tregova që na kishte ba një nanë e një babë. Nuk u thashë që isha motra! Gabova randë! Ku ta dinin ata të shkretët cila isha. Asnjë nuk e ka të shkruar në ballë kush është.

Vetëm kur po dilja prej katundi, një plakë, komshije me ne, më njofti. E kish marrë vesh që kish ardhë një gabele në katund. Zhurmë të madhe kishin ba kalamajtë me mua. Gallatë. Më njofti plaka dhe më tha: «A, ti qenke, moj bijë!» Nuk fola, veç mbështeta kryet në krye të plakës dhe qava prapë. Sa lot kam derdhë atë ditë!

— Herën e dytë, mbas tre vjetësh të tjera, vajtën dhe kalamajtë me Bardhoshen në katund të saj. Unë nuk vajta. — vazhdon gabeli të tregojë, — kisha droje mos më merrnin për lypës.

Namin e kemi, po burrat gabelë nuk lypin kurrrë. Turpi më i madh për gabelin ky është. Kështu e ka dora jonë. Gratë lypin, burrat jo. E kishin pasë pritë mirë të vetët Bardhoshen. E njoftën për motër dhe për bijë. I thanë të rrinte me ta përherë. Por më qëlloi grua e fortë, besa-besë, e nuk më la. U kthye prapë dhe, siç e shef, jemi gjithnji bashkë e nesër do të shkojë përsëri në katund te tata.

— Më piku malli për tatën. Është plak tashiti dhe s'dihet a shifemi ma gjallë. Dhe për të ngelë atje, s'ngalem. Jam mësuar tani me zjarrin nën qiell e jo me zjarr në vatër, që të mbytytymi sytë!

Ajo grua s'ishte më gaxheshë. Ajo ishte tamam gabele. Përpiqem ta kuptoj këtë grua me fat të çuditshëm. Nuk e kuptoj dot deri në fund. Dhe e vras mendjen shumë: a është vallë babai i saj ai malësori i imët krenar, që e ndiente veten pasha atë ditë të largët të gjeologjisë? Dhe po qe se ai është i ati, dhe po qe se ai është, vërtetë, që e zboi të bijën nga shtëpia për një stilograf qeverie, qysh duron e u pajtua ai burrë malësie, me këtë grua, bijën dhe gjakun e tij, që tashmë ka lidhur jetën me një fis tjetër, me zakone krejt të tjera! Me një fis që është si era e nuk zë vend kund. Me këta ciganë endacakë të përjetshëm, që vetëm ecin, ecin dhe gjithnjë ecin nga një shekull në tjetrin. Si duron ai shkëmb i rëndë, që s'e tund as lumi e as lërmeti, të thërrmohet e të shkulet nga mali në rrokullimë?!

Kjo është histori e vërtetë. E vërtetë si çdo gjë që ka jeta. Sado e çuditshme qoftë. Po vijnë kohë të reja, po fillon mijëvjeçari i ri!

25. korrik 1989

TREGIME

Pushkatimi

Dhe thoni po deshët që s'ka telepati!

Deti ishte vaj, dielli përvëlonte. Vapë e tmer-rshme, çahëj guri, aq sa dhe cinxri nuk dë-gjohej.

Të gjithë pushuesit kishin dalë në breg. As-një s'kish mbetur në dhomat dhe mjediset e shtëpisë së pushimit. Madje as edhe në bilar-don e lakmueshme, për të cilën, zakonisht, pritej radha me orë, s'kishte tifozë. Shumëkush gjen-dej i kredhur në ujët valë, të tjerë, shtrirë në rë-rë, nën hijen e çadrave si sardelet në kuti kon-serve. Të gjithë ankoheshin për vapën. Vapë si kjo, thoshin meteorologët, bënte vetëm një herë në shekull. Këtë «vetëm një herë në shekull» na qëlloi fati neve ta provonim atë gusht. Deti avullonte i tëri dhe toka dukej se kish marrë fla-kë. Të ngjante vetja si në furnaltat e Metalur-gjikut e jo në buzë të detit Jon. Kush qe i sëmurë

nga zemra dhe do të shpëtonte gjallë nga këto ditë, s'kishte për të pasur vdekje kurrë!

Fëmijët hidheshin në ujë zhyt, kolloumba, dhe merrnin pato te «Koka e Devesë». E kam fjalën për atë shkëmbin e madh gëlqeror e të bardhë, që në siluetë ngjan aq shumë me një deve të lodhur nga rruga, që është përgjunjur e duket sikur matet e po bëhet gati të lahet në ujin si lot i pastër të detit, në Megalihorën e Dhërmiut. Deveja e gurtë matet e matet, një jetë të tërë, e s'hidhet kurrë në det. Në vend të saj, nga kurrizi i saj si trampolinë e lëmuar nga deti, hidhen fëmijët orë e çast.

Meqenëse diellin nuk e duroja dot, isha ulur e luaja shah në tryezën e gurtë nën kurorën tendë të valanidhit, monument kulture. Nuk e di pse është monument kulture, ndoshta ngaqë është i madh shumë, apo ngaqë ka pasur guximin e ka lëshuar rrënjë këtu poshtë, buzë detit, kur shokët e tij veshin e mbathin faqen e malit të Palikonjës, atje lart në Kurorën e Vetëtimave. Apo, kushedi, mbase me të lidhet ndonjë ngjarje historike e këtyre anëve, që unë nuk e kam dëgjuar. Kushedi! Por që ky valanidh-tendë, ky lis i Valonës, siç e quajnë librat latine, e meriton këtë vlerësim të lartë, monument natyre, mjafton vetëm fakti që në ditët e serës së këtij gushti na shpëtoi nga vapa e madhe. Dhe sos vetëm mua! Me siguri, për këtë shpëtim nga vapa e kanë shpallur monument kulture! Valanidhi është në simbiozë me ullirin plak. Them *ulliri plak* se trangu i tij, tërë zgavra e shpella, është dy herë më i trashë nga ai i Valanidhit-monument. Hijet e kurorave të tyre përzihen

ashtu si dhe degët e tyre, si ato gërshetat e panumërta të atij futbollistit harap të Holandës, Rud Gulit. Këto degë që pliksen e ngatërrohen keqazi me njëra-tjetrën, ashtu si dhe leshrat gërsheta të Gulit, të kujtojnë kokën e Gorgonës. Po kjo kokë këtu është e dashur dhe jo e urryer si ajo e Gorgonës mitologjike.

Nën valanidh e nën ulli bën një fresk i pabesueshëm. Kjo hije me ajrin e saj të ftohtë ia kalon dhe ajrit të kondicionuar.

... Pra, po luaja shah dhe nuk e kisha mendjen te deti. Le që detit i kisha kthyer shpinën, kur partneri i im, një gazetar i ri, thirri:

— Shih, pa shih, një motovarkë po vjen në plazh!

— Gjë e madhe, — thashë unë. — Vazhdo lojën, shah! Atë punë kanë motobarkat, të venë e të vijnë, ndaj është deti këtu!

— Është e huaj, — sqaroi partneri.

Ktheva kokën. Vërtet një varkë me motor po afrohej në plazhin tonë.

— Pse është e huaj? — pyeta. — Mund të jetë jona.

— Jo, — kundërshtoi partneri. — Është e huaj. Në qiç të saj shoh një burrë me mjekër si të Haxhi Qamilit.

— Do të jenë të Kinostudios, — ngulmova unë. — Xhirojnë ndonjë film te Shpella e Piratëve.

— Jo, jo! — ndërhyri Katina, kamerjerja veterane e shtëpisë së pushimit. tek na solli kafet e porositura. — Jo. Nuk janë «piratë» të Kinostudios. janë të huaj. se ia tek po dalin t'i presin vsharët e postës së kufirit.

E lamë lojën. Partneri shpëtoi nga një kurth mati i sigurt. Burrin me mjekër dhe një femër të re, bjonde, me brerore avulli mbi krye, po i prisnin plazhistët e nxirë dhe të zhveshur si ganezët dhe ushtarët me lëkurën e bardhë dhe të veshur si nordikët. Çifti u tremb kur pa ushtarët. Por u iku frika, kur panë fëmijët, si ciganë të vegjël, që po u vinin rrotull të habitur.

Burri i huaj, në zall, mbathi lepitkat me xhixha, siç do thoshte më vonë një nuse nga Korça, kurse gruaja zbriti me rroba banje. Lepitkat ajo i kishte të mbathura që në varkë, por pa xhixha. Kam frikë se i kishin ngatërruar me njëri-tjetrin. Tek kaluan pranë tryezës sonë të gurtë të shahut, vepër e drejtor Teodorit, në ajrin e kondicionuar të Valanidhit, ata të dy ndaluan. Pas tyre dhe patrulla e kufirit dhe taborri i kalamajve po ashtu ndaluan.

Një mendim i parë, naiv fare, më tha se burri me mjekër duhej të ishte shahist dhe, me sa dukej, po pëlqente kurthin e matit që i kisha përgatitur partnerit tim. Sytë e mjekroshit vërtet ishin drejtuar nga tryeza e gurtë e shahut. E vetmja që e kuptoi e para hallin e të huajit, ishte kamerjerja, Katina. Ai s'kishte mall për shahun. Në tryezë, pranë ushtarëve, oficerëve, torreve dhe mbretëreshës së dorëzuar ishin gotat boshe të ujit, që s'ishte kishim pirë para kafes. Ata të dy donin ujë. Katina, rrët e fët, iku dhe erdhi si hardhucë e shpejtë me tabakanë me gota plot ujë të ftohtë frigoriferi dhe kanën deri në grykë. Uji i ftohtë akull vesonte në faqet e qelqta të enëve. Ata, mjekroshi i zyrtë dhe gruaja bjonde e qeshur, pinin dhe s'ngopeshin dot. E

boshatisën tërë kanën, si kuajt që pinë me kova.
«Pinë një kabash me ujë dhe s'ngopeshin. Donin një kazan, të shkretët!» — do thoshte më vonë Katina.

Lëkura e hollë, delikate si prej vajze, anës syve të burrit që plasur dhe ishte mbushur me kripë të bardhë. I kish rrahur dallga gjatë, përderisa kripa u pat ngrirë në çip të syve si çimento e bardhë. Gruaja i kishte buzët të çara si çepele e pjekur shumë. Falënderuan për ujin akull dhe ikën me gjak të ngrirë.

Ushtarët, fëmijët dhe çifti i huaj i papritur i detit vajtën te zyra e drejtorit të shtëpisë së pushimit. Duhej sqaruar ç'qenë e nga vinin këta udhëtarë, ç'hall kishin e ç'ndihmë kërkonin në plazhin tonë. Mbas pak u hap lajmi që ata të dy qenë austriakë. Vinin nga Bari dhe Dhërmiun e kishin kujtuar për Korfuzin. Një vajzë plazhiste, tamam çifute, që gjermanishten e kish mësuar për të marrë emërimin në Tiranë dhe që përktheu, tha se nuk ishin vjenezë, por tirolezë, se flisnin gjermanishte të rëndë!

— S'kishin pará me vete as të paguanin bezzinën për motorin e varkës, — na tha më vonë drejtori i shtëpisë së pushimit, — dhe dalin për turizëm! Dëngla! Kështu si këta, turizëm pa brekë në bythë, unë bëj deri në Honolulu.

— Orëzestë! — tha atëherë Katina, — u dhamë drekë, nga ajo ç'na kish mbetur. E pëlqyen shumë. Ke parë ti, s'kanë qibër fare!

— Ç'qibër të kenë? — kundërshtoi drejtori.
— Hëngrën e pinë xhaba! Pale mbeta dhe pa benzinën e muajit. Ua mbusha serbatorin, që të venë shëndoshë e mirë në Korfuz.

... Austriakët pushonin në zyrën e drejtorit. Prisin sa të vinin shokët që merreshin me doganën. Duhej parë mos ishin kontrabandistë droge. Në varkë s'kishin as heroinë e as hashash. Bile, as cigare. Varka ishte drangull fare! Thyente kokën miu!

Ndërsa çifti i huaj shijonte drekën e shtëpisë së pushimit, unë me partnerin tim vazhduam shahun. Duhej të bënim dhjetë lojë! Kishin mbetur edhe katër. Plazhi ziente nga bisedat për Austrinë asnjë dhe çiftin qejfli, paçka që ishin trokë nga paratë, kur erdhi prapë Katina dhe më tha se më kërkonte Vjena në telefon! Partneri im shastisi.

— Mos u tall, — i thashë Katinës. — Apo dhe ti po sëmuresh nga epidemia austriake e plazhit.

— Për kokën e motrës! — zuri be Katina. — Nuk tallem, ju kërkon Vjena.

— Hajde shtet, hajde! — tha partneri im. — Kur e morën vesh, xhanëm, kaq shpejt, që u kemi kapur dy turistë pa vizë?

U ngrita. E lashë partnerin me admirimin për Austrinë dhe ankthin e matit. Vajta te telefoni. E pabesueshme! Ishte vërtet Vjena! Më kërkonte mjeku i ambasadës sonë, një bashkëfshatar yni. Më tha se profesor Buriani, otorinologu i shquar, ishte kthyer në Vjenë nga pushimet në Spanjë dhe më priste për operacionin e veshit. «A më dëgjon mirë?» pyeti mjeku ynë. «Po», i thashë unë. «Me cilin vesh më dëgjon?» «Me të mirin, me të majtin», thashë unë. «Mirëardhsh në Vjenë, më uroi doktori nga ana tjetër e botës. Po në Jal ke qenë? Si e kam mëmën?»

— pyeti doktori. «Nesër do të vete», — u përgjigja unë. «Bëju të fala shumë!» — porositi ai nga Vjena.

U ktheva te tryeza e shahut.

— Protestë qeveritare? — pyeti partneri im.

— Jo, ftesë mjekësore. Është kthyer në Vjenë profesori që ka marrë përsipër të më operojë tumorin.

— A? Shif ti, shif! Paska qenë tamam Vjena?!

— Pse, ç'kujtove ti? — pyeta unë, tashmë kaluar.

— Mendova se bënte shaka Katina, ose, me siguri, të kërkonte vjehrra dhe Katinës i dëgjohej Vjena.

— Ku të shkon mendja! — thashë unë.

— Po pse, a të shkon dot mendja që këtu të vijin dy vjenezë hallexhinj, që kanë humbur rrugën në det, kurse tjetri prej këtej, këtë çast, nisat për Vjenë?! Tamam gjë e gjëzë.

I dhashë të drejtë.

Ciftin austriak mbasdite i lanë të iknin. Morën dhe një herë frymë te Valanidhi ynë. Nga gëzimi i lajmit që mora për operacionin, i thashë Katinës t'u bënte nga një kafe nga unë. Mbas buke kafeja vete mirë. «E shoh që dashke t'i zëç miq». — më tha Katina. Ata ndezën motorin e varkës me benzinën e drejtorit dhe të shoqëruar nga motoskafi i kufirit, kanë detin drejt Korfuzit, që shtrihej para nesh si krokodil i madh.

Kur migtë dhe shokët e mi të plazhit morën vesh bisedën time me doktorin tonë në Vjenë, bënë shaka për veshët e mi qibarë dhe çif-

tin e trembur austriak, që ikën aq të mallëngjyer nga pritja jonë. Si hëngrën e pinë mirë austriakët, si rrufitën dhe kafën time dhe benzinën e drejtorit, falënderuan dhe uruan «Mirupafshim në Austri!» Dhe vërtet, paçka se i vërtëm, unë do të kisha mundësinë të shihesha me ta atje.

Dhe thoni pastaj që nuk paska telepati. Has austriakët në Dhërmi dhe përfundon vetë në Vjenë. Në atë Austrinë që ia kisha dëgjuar zërin qysh fëmijë, në luftë!

*

* * *

Ishte vjeshta e fundit e luftës. Nëntori i vitit 1944. Qenë ditët kur nisi beteja për çlirimin e Tiranës. Vjeshta bënte e ngrohtë nga moti i butë dhe e nxehtë nga gjëmimet dhe shpërthimet e luftës.

U ngrita herët, që menatë, dhe dola te pragu i derës. Nëna flinte, motra po ashtu. Dola përjashta të takoja shokët e rrugës, çunat e mëhallës sonë të re. Vërtet ishte mëhallë e re: gjithë shtëpitë qenë ndërtuar vitet e fundit. Isha i bindur që çunat do ishin ngritur herët si unë, sepse Augustit, djalit të doktorit armen, i kishin blerë biçikletë të re dhe ai tregohej bujar duke na i dhënë ndonjë xhiro edhe neve.

Shtëpia jonë i kish hedhur themelet para luftës. Kur plasi lufta, i patëm hedhur çatinë, por mbeti pa tavan. Pra, ne gdhijeshim e ngryeshim duke parë në hatlla. Kuptohet që avlli

s'kishim dhe, kur them që dola te pragu i derës, në fakt ishte shtegu i gardhit me ferra që rrethonte oborrin në vend të murit.

Babai që shofer dhe, kur mblodhëm qerestënë, atë vit, pa krisur lufta e madhe, ne e patëm më lehtë se gjitonët, madje ndihmuam edhe gjitonin kosovar. Babai, me kamionçinën e postës, ku punonte, solli tullat dhe gëlqeren, siguroi materët dhe dërrasat e dyshemesë. Sa për rërën, atë e kishim nën këmbë; ngjitur me ne ishte përroi i Selitës së Vogël. Si mblodhi qerestënë, babai thirri ustallarët dibranë me nam dhe hodhi themelet. Atë ditë kur u hodhën themelet, e mbaj mend mirë. Babai bëri kurban dashin që, nuk e di, e blemë a na e falën kosovarët, gjitonët tanë të ardhshëm. Dashi ishte i madh e i fuqishëm sa një dem, aq sa ustait dibran që e theri, i iku e i ra thika nga dora. Babait nuk i bënte zemra ta therte. Mua më erdhi keq e më pikoi shpirti për dashin që tre burra nuk e mbanin dot. Për të mos parë mynxyrën, ktheva kokën në anë tjetër. Dashi blegëriu sa mundi dhe pastaj heshti. Gjithë bota heshti. Më në fund dibrani e ndau veç kokën me sy të gjelbër, që vajtonin akoma, me brirët si kokorrethë të pashkëve nga trupi pa jetë i dashit.

Gjaku spërkati themelet e porsahanura. Gurët e themelit kullonin gjak. Me këtë gjak të zi kurban u mbrujt llaçi me rërë të bardhë përroi Selite, dhe karabinaja për një vit rriti shtatin. Beharin tjetër do të hynim në shtëpi të re, po plasi lufta dhe shtëpia mbeti pa tavan. Në maj u vra dhe babai. U nis për punë të Partisë në

Vlorë dhe atje e vranë. Ai nuk e gëzoi dot shtëpinë e re. «Kështu qe e thënë!» — tha nëna.

Ne pritëm ngushëllimet te shtëpia e vjetër me qira, së cilës i bënte hije kumbulla e egër, që babai nuk arriti ta shartonte. Them *pritëm ngushëllimet*, sepse ishte nëna dhe unë që pritëm e përcollëm njerëzit. Isha vetëm dhjetë vjeç. Burrat më jepnin dorën si një të madhi dhe hidhnin cigaret si fishekë të bardhë mbi qilimin e zi. Pleqtë më jepnin kurajë dhe besim bashkë: «Vetë shëndoshë dhe t'ju ketë lënë ura-tën!». Ndërsa gratë dhe nusët e reja, tek më puthnin në faqe, thoshin gjithnjë, të tëra, një fjalë: «I ziu bonjak ç'të gjeti!». Ato qanin, kurse unë heshtja, thua se s'kisha gojë fare. Isha i bindur që ato gabonin dhe qanin kot. Babai ishte nisur në mal partizan me shokët dhe do të kthehej prapë. S'ishte nga ata burra që mbetej rrugeve... Por ai nuk u kthye kurrë dhe unë shpejt e kuptova se kisha mbetur burri i vetëm i shtëpisë. Pritëm sa pritëm e përcollëm dyzet ditë rresht njerëzit që na ngushëllonin e na jepnin kurajë, pastaj ikëm në shtëpinë e re. Ajo vërtet s'kishte as tavan e as avlli, por qe e madhe dhe e tëra jona dhe jo bimcë, si ajo dhoma me qira ku na la babai. S'kishim plaçka shumë. «Vetëm një kokosh plaçka», — tha ime mëmë. Aq sa të gjitha, kur u shpërngulëm, i mori vetëm me një rrugë karroca e Cen doracit, mikut tiranas të babait.

Shtëpia e re qe në mëhallën e re të Tiranës, ku banonin muhaxhirët nga Kosova, doktorin dhe deputeti. Doktorin e njoha shpejt jo vetëm nga djali, Augusti me biçikletë,

por se atë vit u sëmura nga veshi, më shpër-
theu mallafraqi dhe qysh aherë kam mbetur me
dëgjimin qibar. Kurse deputetin nuk e njoha
kurrë, po shtëpia më e mirë në mëhallën e re,
me derë të hekurt dhe avlli të lartë me copa
gastarësh, që të gjakosnin duart, që ajo e depu-
tetit. Shtëpia e tij me pjergullën tendë të rru-
shit ishte më e para dhe më e vjetra e mëha-
llës së re.

... Dhe ja, qeshë ngritur herët dhe prisja
çunat kosovarë dhe Augustin e biçikletës, kur
ia mbërriti Demi nga Gjakova. Ai më tha se te
dera e hekurt e shtëpisë së deputetit ishte vra-
rë një gjerman. Kot e prisnim çunin e doktorit
me biçikletë! Sot as shqiptarët s'kanë për të
dalë në rrugë me luejt, jo më armenët!

Ushtarë të vrarë s'kisha parë, të gjallë sa
të doje.

— Shkojmë ta shohim, — thashë unë për
ushtarin e vrarë.

— Ç'na duhet! Mos na kapin kot! — tha
Demi.

U nisa. Erdhi dhe ai me mua. S'më linte dot
vetëm. Ishim apo s'ishim shokë.

Mbërritëm. I vrari ishte ushtar i ri, pa ar-
më. Ai që mbërthyer pas avllisë me gastarë të
shtëpisë së deputetit dhe sytë i kish hapur, të
mëdhënj sa sytë e dashit. Ai, siç dukej, çuditej
me ne. Pranë tij qante një grua.

— Zonja e deputetit, — më sqaroi Demi.

Edhe sot e kësaj dite nuk di ç'ishte ai de-
putet: i Zogut apo i gjermanit.

— Ia paskan marrë armët! — thashë unë
me keqardhje.

Unë për armët nxitova ta shihja të vrrarin. Kërkoja pushkë për të marrë hakun e babait.

— Prandaj e kanë vrrarë, — tha Demi i sigurt. — Për patllaken.

Ndërsa ne përpiqeshim ta merrnim me mend se kur dhe kush e kish vrrarë, erdhi një motoçikletë ushtarake. Një oficer dhe motoçiklisti.

— Do t'i ketë lajmëruar kjo kurva, — më tha Demi te veshi, për zonjën e deputetit, që qante pa pushim.

Oficeri mori ushtarin e vrrarë dhe e vuri në kosh të motoçikletës dhe hipi në të bashkë me të vdekurin. Një i gjallë që ndizte motorin me këmbë dhe një i vdekur, që as fliste dhe as luante, as këmbën e as dorën, por që mbante sytë hapur e çuditej me të gjithë. I gjalli tjetër, oficeri, filloi të bërtiste fort në gjuhën e vet, aq fort sa dhe zhurma e motorit nuk ndihej, aq sa dhe zonja e deputetit e la të qarët, kurse unë me Demin ia mbathëm në shtëpitë tona. Oficeri që bërtiste, nuk ndilte për të mirë.

Kur u ktheva në shtëpi, tek më merrej fryma nga nxitimi, i tregova nënës ç'kisha parë.

— Mirë ia bënë, qenit, — tha nëna. — U lumtë dora!

Nëna s'ngopej me nazistë të vrrarë. Ata na kishin vrrarë babanë.

Nuk kaloi as gjysëm ore, kur befas erdhën ushtarët gjermanë edhe në shtëpinë tonë. «Mallkuar qofshi, o lukuni e ujçërvë», tha nëna. Por ata s'kuptuan gjë. Nuk dinin shqip si ballistët. Ata kontrolluan kollaj, se ne katër muret kishim dhe pallton e dimrit të babait varur në gozhdë

pas derës. Nëna më tha: «kërkojnë armë». Nuk gjetën ç'kërkonin, por na morën me vete, nënën, mua dhe motrën e vocërr në gji të nënës. Na çuan te sheshi i kishës në Shën-Prokop. Atje gjetëm dhe gjitonët, muhaxhirët kosovarë. Burra të lartë, kavakë me plisa të bardhë. Mbas pak aty u mblodhëm të gjithë ç'ishim banorë të mëhallës së re. Vetëm deputeti dhe zonja e tij nuk qenë me ne. Doktor armeni qante. Ishte i vetmi burrë që dinte të qante.

Oficeri, ai që kisha parë në mëngjes herët me motoçikletë, filloi të flasë me zë të lartë. Sa shumë thërriste! Një civil, jo i mëhallës sonë, përkthente. Unë prisja të përkthente doktori armen, por ai qante më fort dhe nuk pushoi si zonja e deputetit kur thirri gjermani. Doktorit i dridhej buza dhe nofulla bashkë e mjekrës i kullonte loti. Ai s'fliste. Fliste gjermani.

— Në qoftë se për një orë nuk tregoni se kush e vrau ushtarin, të gjithë do pushkatoheni. Fershtejn!

Ishte vërtet ferr.

— E kuptoni? Për çdo ushtar gjerman të vrarë ne pushkatojmë njëqind burra, — përkthente civili. — Por me që kjo lagje nuk ka kaq burra, ne do t'ju pushkatojmë ju të gjithë, të nëntëdhjetegjashtë banorët, pa dallim, me gra e fëmijë bashkë!

— Ashtë marre me u marrë me gra! — tha njëri nga kosovarët pleq, por që civili nuk e përktheu.

Demi, çudi ku e gjente kohën për shaka, më tha:

— Sikur të ishte dhe deputeti me zonjën

dhe dy këlyshët e tij, do të bëheshim tamam njëqind.

— Hajde, mendje! — i thashë. — Deputetët nuk pushkatohen, ata vetëm votojnë.

Këtë që deputetët votojnë e dija nga Augusti, i biri i doktorit armen, që ma kishte shpjeguar një ditë, kur e pata pyetur se ç'punë bën deputeti. Fjalën votim nuk e mora vesh, po bëra sikur e kuptova, se s'doja të isha më poshtë se armeni.

Ne që do të pushkatoheshim, qëndronim më këmbë, ata që do të na pushkatonin rrinin ulur. Oficeri priste, i qetë dhe i zyrtë në stol, të mësonte kush e vrau ushtarin. Burrat kosovarë nxorën kutitë e duhanit dhe filluan të këmbenin cigare. Doktorin armen shihte çdo minutë sahatin me qostek. Ai e nxirrte dhe e fuste në xhep të jelekut shpejt e shpejt, hajdutçe, dhe unë hutohesha: kur arrinte ai, takfak, ta hapte e ta mbyllte kapakun e florinjte?! Unë me Demin s'kishim ç'të këmbenim dhe as sahat të shikonim nuk kishim. *Ne ganim hallet tona. Nëna mbante motrën në krahë, dukaj e lodhur. dhe unë i thashë të ma jepte ta mbaja kalapic.* Motra ishte vetëm dy vjeçe. Kishte fustan të zi dhe fjongo të zezë. Koka e vogël e saj me flokët e verdha flakë dhe fjongon e zezë, mua më ngjante me një llambë vajguri me fitil të zi, që mbante nëna në gj. Nëna mbante zi për babanë dhe, kuptohet që s'mund të ndodhte ndryshe. ajo me e veshur e tëra me të zeza. Pollka e zezë sterë. fustani deri në fund të këmbëve i zi dhe destemeli i kokës i zi. Ajo të kuitonte kallogretë. Nëna filloi të dëneste, fshiu lotët me sha-

minë borë të bardhë të hundëve dhe bashkë me të po bëhesha gati të qaja dhe unë.

Bija, e ëma e Demit, shokut tim të mirë gjakovar, nuk gjeti fjalë tjetër ta ngushëllonin nënën dhe tha vetëm:

— Mjerë na të mjerat!

— S'më vjen keq për vete, — tha nëna, duke fshirë mjekrën nga rrëkeja e lotit, — se kështu shkoi jeta ime. Marrë lumi e vatur! Më vjen keq për bonjakët. Fat i zi yni. S'na u ndanë kusuret. Sos burri që më iku, po na dhe fëmijët!

— Qaj, motër, qaj, — tha nëna e Demit. — Lotët të heqin dhimbjet.

Aherë qava dhe unë, për çudi qau dhe motra, dhe aherë pashë që edhe Demi i kishte sytë me lot.

Burrat kosovarë pinin duhan dhe, kur ndonjëri hidhte vështrimin nga ne, shpejt kthente kokën më anë tjetër. Nuk e di ç'kishin: nuk duronin lotët apo mos kishin frikë se u mbushehin dhe atyre sytë me lot. Po burrat nuk qajnë, sa më pak ata, kosovarët.

... **Partaj, papirur, Demi më rrasë në dorë** një gjë të vogël, të ftohtë dhe të fortë. Kujtova një çast se mos ishte çelësi i shtëpisë. Kur luanim, ai gjithmonë ma jepte mua. Unë di t'i ruaj gjërat mirë. Po jo, ajo gjë e vogël, e ftohtë dhe e fortë ishte petashuqe dhe e rrumbullakët. Me siguri ishte një kupac, nga ata të mëdhenjtë. Çudi me këtë njeri! Edhe para mitralozit gjerman i shkon mendja të luajë me komça! E pashë Demin i zemëruar. «Rrotë ngele gjithë jetën», thoshin sytë e mi. Ai më pa i habitur: ç'kisha që inatosesha? Dhe më tha me zë të ulët:

— Merre dhe jepja axhë Jasharit. Ma dha baca.

Dhe vetëm tani u kujtova ta shihja atë që mbaja në dorë. Ajo gjë e rrumbullakët e she-shtë dhe e fortë (tani s'qe më e ftohtë, se e kish ngrohur dora ime) shkëlqente sa gati të verbonte. Ishte një napolon flori. E njihja mirë. E kisha parë atë ditë kur më kuroi doktori armen nga mallafraqi i veshit dhe nëna nxori nga qesja me gjalmë e gjirit të vetmin flori që na kish lënë tata. Doktori armen nuk e mori dhe tha atë ditë: «Bëj sevap për bonjakun»! Floririn e vetëm të shtëpisë ia shkulën nënës nga gjiri dy muaj më vonë ballistët. Mirë që nëna s'kishte as vathë e as dhëmbë floriri, se dhe ato do t'ia kishin shkukur. Kështu vate dëm floriri ynë, për dhjamë qeni. Atë që na i la për sevap doktori armen, na e morën ballistët e Xhaferrit. Më mirë ta kish marrë armeni.

Unë pashë me pikëllim e mall floririn sa një kupac dhe ia ktheva Demit.

— Unë s'kam para, — i thashë. — As nëna s'ka! Merre!

— Çfarë paresh? — u çudit Demi.

— Ne dolëm nga shtëpia me ç'kemi veshur, — sqarova unë. — S'kemi parà me vete.

Kujtova se duhej të shtoja ndonjë lek te napoloni flori.

— Jo, bre! — tha Dem gjakovari. — S'ka nevojë për pare. Por pasoje më tutje, jepja axhës floririn.

Nuk kuptova pse ma dhanë aherë ta mbaja atë flori në dorë kur duhej ta pasoja prapë më tej, pa shtuar gjë lekë përsipër. Në fund të fun-

dit, ne ishim ngjitur me njëri-tjetrin, si bagë-
tia në shtrungë, dhe Demi mund ta përcillte vetë
tek axha i tij. Por s'kishte kohë të mendoje gjatë.
Bëra siç më porositi Demi dhe më lot në sy
ia dhëshë floririn axhë Jasharit. Ai e mori, më
pa një çast i vrenjtur dhe gati me përbuzje e
zemërim bashkë më tha:

— Mbahu, bre! A je burrë!

Unë s'isha burrë. Burrë kishte qenë babai.
Tashti do vritesha dhe unë dhe mbase pas vde-
kjes bëhesha burrë. Më vinte keq, që nga fisi
ynë s'do të mbetej më jo mashkull, por as fe-
mër. Do të na shuhej dera fare. Më vinte më
shumë keq për nënën dhe motrën, si do të bënin
ato pa mua? Harrova një çast që dhe ato do
pushkatoheshin.

Ndoqa me sy ç'do të bënte axha Jashar me
napolonin flori. Ai e përcolli më tej, te një ko-
sovar tjetër. Ai tjetri te një tjetër dhe napoloni
ngrohej në duart e rreshkura të burrave të Ko-
sovës. Unë prisja që ai të shumohej, të pille
monedha të tjera dhe të përfundonte udhën e
vet në xhepat e mëdhenj të oficerit gjerman.
A do të blihej vallë gjermani? Po napoloni ecte
i vetmuar nëpër duar e grushta burrash dhe
djemsh, nëpër gishta meshkujsh.

Vetëm meshkujt. As një dorë femre nuk u
afhua te flori. Ishte e qartë për mua që burrat
s'donin të ndynin duart e bekuara të grave me
atë flori të mallkuar, që do të blinte gjermanin
si Juda. Po flori ecte e yezullonte nga dora
në dorë, kaloi dhe para oficerit pa e parë dhe
nuk ndaloi tek ai. Bile edhe kur erdhi te doktori
armen, ku prisja që të paktën flori të bënej

vetë i dytë, ai nuk u shtua. Napoloni flori, si një yll i vogël, i verdhë, fekste nerë pas here në quart e atyre që do të pushkatohesnin. Dne më në fund atë diell të vocërr fare nuk e pashe më. Ai erdhi fare pranë meje dhe përfundoi në xhepin e xhamadanit të bacës së Demit e jo në të oficerit gjerman. Kisha gabuar! Gjermanin nuk e bëje dot ortak në pazarin e vdekjes.

Pra, jeta jonë nuk blihej dot me flori. Na priste vdekja e sigurt... (Shumë vite më vonë mora vesh që ajo copë floriri që qarkulloi atë ditë në duart tona, ishte shenjë pagane, që bente thirrje të vdisnim të fortë si metali dhe të pastër si floriri.)

... Papritmas nga Selita e Vogël filloi të qëllonte një mortajë.

— Partizanët! — thirri Demi.

Pastaj u dëgjuan ca gjëmime dhe shpërthime të llahtarshme. Këto nuk ishin mortaja! Poshtë kodrës së kishës, së shën Prokopit, ku do pushkatoheshim ne, po hidheshin në erë shtëpitë tona të mëhallës së re. «Ku-ku!», thërrisnin kosovarkat. Mëma ime briti: «Vú për na!» Kurse unë me Demin po kënaqeshim që gurët, pragjet dhe zhëmblat e shtëpive tona, që fluturonin si me hobe në erë, po thyenin tani xhamat dhe tjegullat e shtëpisë së madhe të deputetit. Dhe patjetër dhe gruaja e deputetit, ajo kurva atje, po thërriste: «ku, ku» si nënat tona. Tymi pas pak u shpërnda dhe atje ku deri pak minuta më parë qenë shtëpitë tona, kishte vetëm pirqje gurësh, si një varrezë e harruar. Fundi i botës! Ra qetësi e madhe. U shushatëm të gjithë dhe unë dëgjoja përsëri zemrën time si rrihte fort (ç'çe-

kan i fortë godiste në atë kudhër!); si atë ditë kur babai bëri kurban dashin. Po sot kurban bëheshim në Gjermani nuk njihte dashin për kurban. «Apokalipsis», thirri «Doktori armen. «Katakizmoi», briti nëna ime. «Harram dynja», tha nëna e Demit.

Botës i kishte ardhur fundi...

Por ja t'ek filloi të dëgjohej prapëmortaja partizane. Predhat kalonin mbi kokat tona:

— Shtrihuni, burra! — thirri bacat e Demit.

U shtrimë të gjithë, burra e gra dhe kalama, gjermanë e shqiptarë dhe doktori armen. Mortaja partizane qëllonte. Ajo ishte larg në Selitë të Vogël, por gjylet, që kalonin mbi kokat tona, po e ngushtonin rrezen e po afroheshin drejt nesh. Oficeri gjerman iku e u fut në kishë bashkë me ushtarët që do të na pushkatonin. Me ta iku e u fsheh dhe civili që përktente.

Më ne, shtrirë barkas ashtu si dhe ne, mbeti vetëm një rojë.

Rojën e shihja mirë. Ishim përballë njëri-tjetrit. Ishte i ri dhe sytë i kishte të bardhë, të kaltër, jo si të dashit që bëmë kurban për shtëpinë (që sapo u hodh në erë), por të hutuar si ata të shën Jan pagëzorit, korën e të cilit e ndriste llambadha me vaj të mirë në shtëpinë tonë, që tani s'ishte më. As shën Jani s'ishte më, por ishte ky rojë përballë.

Papritur ai diçka filloi të thoshte, diçka po tregonte, por asnjë nga ne nuk e kuptonte.

Ai pastaj tundi automatikun si patericë, thua se donte të mallëngjente dikë. Ç'kishte vallë ai ashtu? Ç'hall e brente? U'ngrit më këmbë i zemëruar, gërthiste dhe qëlloi në ajër me breshë-

ri. Kishte dalldisur. Aherë dëgjova një zë që
briti:

— Ikni, millet! Të shpëtojë kush të mundë!
Por asnjë nuk po ikte. Të gjithë ishim shtri-
rë më gjunjë, sikur po faleshim në xhami të
Sulejman Pashës. Roja thirri përsëri, fort e më
fort, në gjuhën e vet dhe midis lumit të fjalëve
të tjetrit doktori armen kapi më në fund atë
emrin e shënuar e shpëtimtar: Austriak.

— Ky qenka shpirt njeri, — tha doktori, —
austriak!

— Nemceli i mirë, — u kujtua baba i De-
mit.

Dhe vetëm aherë u ngritën burrat e Koso-
vës dhe ne të tjerët e u shpërndamë, vrik me
vrap. Mëma me të zeza, motra me fjongon e ze-
zë në krrahë të nënës dhe unë me Demin pas saj.

Mortaja partizane vazhdonte, të hapte gro-
pa, qëllonte pa pushim dhe gjylet e saj, me si-
guri, tashmë goditnin kishën ku qe fshehur ofi-
ceri nazist me trimat e tij dhe përkthyesin civil.
Por ne nuk pamë gjë hij, se, tek vraponim të
shpëtonim kokën, asnjëherë nuk vështruaam pas.
Mbërritëm te Perroi i Selitës dhe mbajtëm vra-
pin në rrjedhën e tij. Ujë kishte pak, por buzët
të thella, dhe tashmë as gjermanët nuk na shih-
nin e as gjylet na zinin. Kishim shpëtuar.

Me gjak të ngrirë nga ankthi dhe të ftohët
nga uji brisk i përroit, më në fund ndaluaam si
për të bindur njëri-tjetrin që rrezikun vërtet e
kaluaam.

— Kishte pasë qenë rob, zoti ai roja, —
tha Bija, nëna e Demit.

— Ushtar me zot, më, — tha Baca. — Ishte austriak.

— Hallall sisa! — tha nëna ime.

— Ishte austriak i shkretë! — tha përsëri Baca. — Nemceli i mirë!

— Unë nuk e kuptova pse ai përsëdyti «ishte austriak». Më vonë e kuptova që ai ishte, se pas atij çasti që na dliroi ne, s' duhej të ketë qenë më. Rojën e të dënuarëve me pushkatim, që nuk di të ruajë vdekëtarët, gjermanët do ta kenë dënuar patjetër me vdekje.

Kështu që shpesh, kur nëna ime kujton së atë ditë ne e patëm jetë të dytë nga partizanët, përgjërohet dhe për austriakun, që na ndihmoi të lindim përsëri.

— Shpirt njeriu që ai, i varfri austriak!

— Kjo, pra, ka qenë njohja ime e parë me Austrinë.

Dy javë më vonë nga dita e pushkatimit, si kishim gjetur përkohësisht strehë në miqtë e babait, Tirana u çlirua. Këshilli Nacional çlirimtar neve muhaxhirëve të luftës, që na i kishin hedhur shtëpitë në erë, na dha apartament me zjarr në kuti hekuri, tek ish-pallatet e oficerëve italianë të aviaçionit. U hapën shkollat dhe unë fillova mësimin te «Kristoforidhi». Shkolla ishte matanë Lanës dhe një ditë brigjeve të Lanës bashë ushtarët e huaj, rojër të luftës që punonin të

ndërronin drejtimin lumit të vocërr. Midis robërve gjermanë, që ruanin partizanët, më thanë se kishte dhe austriakë.

Fillova të vonohesha mëngjeseve në shkollë. Mësuesja më qortoi, kur unë mënova disa ditë radhazi. S'dija si të gënjeja dhe as doja të gënjeja, por nuk mund t'i thosha që çdo mëngjes kërkoja midis robërve atë austriakun që na kish shpëtuar jetën. Isha i bindur që këtë të vërtetë nuk do ta besonte. Në këto raste njerëzit më lehtë hanë gënjeshtren, sesa pranojnë të vërtetën.

U vonova përsëri dhe ditë të tjera vazhdoja të gaboja. Robërit e uritur shihnin me shpresë çantën time prej lecke, katrore-katrore si fushë shahu, dhe e ndieja që ata donin ndonjë copë bukë. Kohët kishin ndërruar, ata qenë sot përdërsit tanë. Por ne s'kishim bukë për vete e jo për botën. Mbanim radhën që menatë për dyqind gramë në ditë. Por, më besoni se, sikur të hasja sytë e mëdhenj si të korës së shën Jan pagëzorit, të austriakut, do të ruaja bukën e gjithë javës për t'ia falur atij!

Ata sy nuk i hasa kurrë më. Por unë shpresoja, gjithnjë shpresoja, paçka se më kot. Ashtu siç shpresoja thellë në shpirt që dhe babai do të kthehej një ditë shëndoshë e mirë nga lufta. Shpresa e bën njeriun njeri. Thoshin që partizanët tanë luftonin tani në Jugosllavi, në ca vise me emra të fortë, që, kur i shqiptoje, të thyeshin dhëmbët: Sanxhak e Vishegrad. Mbase atje ishte dhe babai! Kurse këtu buzë Lanës ndoshta ishte dhe austriaku im. E mbaja mend mirë. I vogli e mban mend më mirë të madhin.

Kurse ai duhej të më kish harruar fare, se, ndryshe, kaq ditë që e kërkoja, do të më kishte folur.

Dhe prapë shpresoja! Dhe përsëri vazhdoja të vonohesha në mësim, aq sa mësuesja më shau keqas dhe më kallëzoi te nëna. Desha s'desha, i tregova nënës të vërtetën, se pse mënoja në shkollë çdo ditë: Te Lana punonin robërit e luftës dhe atje duhet të jetë dhe austriaku që na shpëtoi jetën.

— Do ta kenë vrrarë gjermanët, ashtu si tatën, — tha nëna. — Kot lodhesh.

Edhe nëna, si gjithë të rriturit, s'e kuptonte hallin tim. Nuk fola, por e ndieja që nuk lodheshja kot. Kot e kishte nëna ime, që besonte se edhe babai ishte vrrarë, pale më austriaku i varfër.

Dhe prapë e prapë vazhdoja të vonohesha në mësim. Dhe aherë mësuesja, që e dinte tashmë nga nëna pse vonohesha, u tha shokëve të mi të klasës:

— Ka luajtur mendsh pas një austriaku!

Shokët e klasës nuk e dinin ç'ishte austriaku. Ku ta dinin ata, nuk u kish qëlluar t'i shpëtonte njeri nga pushkatimi. E kuitonin ndonjë zanatçi, si ata që kishte në Pazar të Vjetër, ku herë pas here, mbas mësimit, humbisnim e kalonim kohën duke i parë: xhokaxhi, kundraxhi, samarxhi, kadaifxhi, austriakxhi!

Dhe në pushimin e madh çunat e klasës më pyetën:

— Kush qenka ai austriakxhiu yt? Si nuk e njifkemi! Ku e ka dyqanin, te Tabakët?

— Jo, — u thashë, — te Bregu i Lanës.

— Aha! (Ra pazari fare) — Qeka arixhi! —
thanë ata të sigurt.

— Jo, — është rob i mirë, rob zoti!

— Ç'na çudite! — tha njëri nga çunat. —
Gjithë zanatçinjtë janë rob të mirë.

Më vonë dhe ata e morën vesh tamam historinë time me robin e Austrisë. Kërkuam së toku, po kurrë nuk e gjetëm. Mbase robi im austriak u bë shkas që pullave të postës me emrin Austri, iu rrit vlera shumë në bursën tonë të kalamajve të këmbimit të pullave dhe arriti puna deri aty, sa për një «Austri» me një portret të Karl Gegës (duhej të ishte shqiptar përderisa që gegë) të fitoje pesë «Amerika» me Ruzveltin.

Kjo ishte njohja e dytë me Austrinë.

Thonë gjithnjë: E treta e vërteta! Por s'është kurdoherë kështu. Austriaku i tretë që njoha, ishte plaku Hans Shtile, gjeolog i madh alpin, që të kurdoherë kështu. Austriaku i tretë që njoha, sova, qysh nxënës në teknikum, që tektonika trashëgon dy terma të mëdha të saj: Grabenin dhe Horstin. Nuk dua t'ju tremb me ta, por sa për ta ditur po ju them që nuni Shtile me emrin e parë pagëzonte një gropë të madhe tektonike, e të ne e tillë, klasike për gjithë botën është Liceni i Ohrit. Kurse me të dytin, përfytyroni një, cast një mal, që del mbi shokët dhe ky është Tomorri, dhe ia tek e kenë Horstin!

Grabeni në gjermanisht qenka *varr*! Dhe kë-

të do ta kujtoj më vonë, kur shoh mirë e dëgjoj keq, në Shën Stefanin gotik të mrekullueshëm të Vjenës. Atje ka varre brenda katedrales, që është zemra e lashtë e Vjenës. Këtej, me siguri, vjen dhe «Grabeni» i gjeologjisë alpine të Shtiles.

Pra, i treti, — që duhej të qe i vërteti, — austriak që kam njohur, ishte gjeologu i shekullit të kaluar Hans Shtile. Më vonë, si të gjithë, njoha Moxartin, Shtrausin (babanë me të birin) dhe Shubertin. Njoha çifutin e ndritur të Vjenës, Stefan Cvajgun, tregimtarin e mrekullueshëm, që më 1942 vrau veten, se nuk duroi dot, atje në Brazil, (ku u arratis nga nazizmi), të dëgjonte se ç'po bënte Hitleri me të mjerën Evropë.

Njoha dhe dy shqiptarët që i bënë nder të madh vendit që i ngriti lart, Austris: Karl Gëgen e dramës së jetës dhe Alëksandër Moisiun e tragjikes së skenës.

Dhe vonë, shumë vonë, kur jam gjysh, që shoh mirë e dëgjoj keq, njoha vërtet edhe vetë Austrinë. Por për të do t'ju flis mbase herë tjetër. Bëni durim!

Qershor 1989

Bora e parë

Valbona në mëngjes na priti me diell, por në drekë na përcolli me borë. Më një nëntor ra bora e parë në Tropojë. Nuk pritej fare dhe si çdo gjë e papritur ngjalli mjaft shqetësime. Dikush tha me hidhërim se kjo borë kaq e hershme do të sjellë dimër të madh sivjet, të tjerë thanë, si për ngushëllim, që kjo borë e nxituar do sjellë dimër dështak.

Nuk jam tropojas dhe huqet e malit këtu nuk i njoh. Por sidoqoftë dimri filloi, dhe mua që në ditën e parë të tij më hapi punë.

Duhej të isha nisur për Tiranë herët, më shpejt, që të arrija të kaloja Qafën e Malit me ditë. U nisa vonë nga «Bajram Curri», më të errur. Më vonuan piktorët tropojanë në studiot e tyre. Piktorë të rinj me punime premtuese, por të pakta, veçse me dëshira e diskutime të shumta. U nisa në mug, kur tashmë duheshin

ndezur fenerët e makinës për të shquar mirë rrugën. Herë pas here parakalonin makinat e ngarkuara me krom. Në Fierzë na përshëndeti polici i urës, por s'na tha gjë për borën që po zinte rrugën para nesh. Me siguri, që nuk kish marrë vesh se ç'po ndodhte në Qafë-Mal.

Rruga ishte e shkretë. Borë që binte qetë-qetë me flokë të mëdhenj e të rëndë si 50-qindarkshe të reja. Fshirësja e xhamave të veturës me vështirësi bënte punën e vet. Lamë pas Fierzën dhe në këtë qetësi e vetmi të trishtuar bore, midis maleve, m'u kujtuan (kushedi për të satën herë) ato vajzat, mësuese të Fierzës, që i kisha takuar njëzet vjet më parë në ish-qelën e priftit të katundit.

Prifti plak kish vdekur. Prift të ri s'kish dërguar e as kish kërkuar njeri në Fierzë, dhe këshilli popullor i fshatit u kish dhënë jatak mësueseve korçare, në vend të priftit, që s'u erdhi më kurrë.

Kambanorja e kishës në mbremje dukej si e vdekur. Por mëngjeseve mësueset i binin kambanës së saj, në vend të ziles së shkollës. dhe i grishnin fëmijët për mësim. Meqë çdo ditë ka shenjtorin e vet, askush në fshat nuk e merrte për sakrilegj a mëkat të madh këtë. Madje. shumë nga malësorët u ishin mirënjohës cucave arsimtare për këtë këmbanë, që dëgjohej në vend të ziles çdo ditë në orën e caktuar kur niste mësimi, sepse u shërbente si sahat i madh i fshatit.

Nuk e di sa vjet të tjerë punuan ato korçarkat atje. Nuk e di as ku janë sot. A janë martuar? Ç'fëmijë kanë? Të vetmin merak që kishin

ato, atë mot, qe ndjenja që këtu në qelën e priftit do të mbeteshin pa martuar, ashtu si dhe prifti plak, që vdiq beqar, se ashtu ia donte petku. . . Mos pagim fatin e tij, lutnin ato! . . .

. . . Shoferi herë pas here fik e ndez rishtazi dritat e makinës, jo se këmbehet me ndonjë makinë tjetër përballë, por ngaqë trembet, mos i shuhen e si ndizen më. Dhe po t'u shuan dritat në një mot të tillë e në këtë lloj rruge malore, puthu me Milon! Fike më mirë makinën dhe rri e prit po bëri sevap ndonjë kamion.

Shoferi është i ri dhe e bën këtë rrugë vetëm për herë të dytë, një javë më parë kur erdhëm në Tropojë dhe tani që po kthehemi në Tiranë.

— Shfrytëzo karaxhatën! — e këshilloj unë.
— Mba tragën e hapur nga të tjerët!

— Atë po përpiqem të bëj, — thotë shoferi.
— Por kam frikë se mos ka ngrirë bora, dhe karaxhata e akullt më çan serbatorin apo më për dreq akoma, më thyen diferencialin.

— Ktheje pak timonin nga faqja e malit, që, dhe po rrëshqitem, të përplasemi pas shkëmbit, më mirë, sesa të gremisemi honeve.

— Jo, ishallah, s'kemi atë fat! — më kthen ai si mysliman i mirë.

— Vdekje s'ka, — përpiqem ta qetësoj, — por mundime ka!

— Si s'ka vdekje! — habitet shoferi. — Po ramë humnerës në këto gryka të poshtra, në këtë borë s'na gjen dot njeri kurrë! Ose do të na hanë bishat, ose do balsamosemi të ngrirë deri sa të vijë behari!

— Jo! — e ndërpres i sigurt unë. — Jo! Gjyl-

ja nuk bie dy herë në një gropë. Ta kam treguar, më duket, një herë! Im atë është vranë në makinë, s'ka si të vritet dhe i biri kështu. Ka vdekte të tjera.

— Ou! — kundërshton shoferi. — Si qenka kështu kjo punë? Mirë jū, po unë që e kam babanë gjallë dhe s'kam asnjë gropë gjyleje?

— Ja, kështu! — ngul këmbë unë në timen. — Tim atë e vranë në timon dhe kushdo që udhëton me mua është imunizuar nga vdekja në makinë!

Shoferi hesht. E ndiej që në kabinë vërtitet mendimi i pashprehur i tij: «ama, muhabet!» Duket qartë që s'flet se nuk do të ma prishë qejfin.

Bora bie dhe nuk është behar që të shpresosh se ajo do mbarojë shpejt. Shtresa e borës po rritet dhe nuk është më toka e mbuluar me një cipë a carçaf, por me një dyshek akulli. Bredhat anës rrugës janë veshur në argjend, tunden e shkunden nga era dhe të duket vetja si në përrallë. Shoferi as flet, as e ndien peizazhin magjik përreth. Ai ka vetëm një hall, atë të rrugës, që sa vjen e bëhet më e rrezikshme.

— Vure Glicerinë! — i them shoferit.

Dhe nga kasetofoni dëgjohen këngët greke, herë të gezuara, ja si këta bredha tufafë që tunden e shkunden si nuset e reja, pas natës së parë të martesës dhe herë të përmallshme e të trishtuara si ky udhëtimi ynë në mes të borës dhe akullit, si ato vajzat korçare, që flinin beqare në qelën e priftit.

Rruga është gati e vdekur. Besoj se në një natë si kjo u ngrit Kostandini nga varri bër të marrë Doruntinën. Nën këte rrugë, si sonte, do

ta ketë sjellë ai motrën nga viset e Veriut.

... Më në fund në pasqyrën e ftohtë të makinës reflektohet një dritë.

— Do të jetë ndonjë kullë e vetmuar, — thotë shoferi.

— Jo! — them unë, pa asnjë mëdyshje, — Është një makinë që e kemi përpara.

— Si përpara, kur drita vjen nga pas! — habitet shoferi.

Nuk ka faj. Është i ri në timon dhe këtë rrugë s'e njeh. Harron që kjo ka leqe shumë dhe në kthesat e thella malore, në errësirën e natës së dimrit çdo dritë që ke përpara (nga larg) duket sikur të ndjek pas.

— Ke për ta parë vetë: Mos nxitò! — i them shoferit, i qetë dhe i sigurt si instruktor shoferash.

Mbas pak vërtet këmbehemi ballazi me dritën që shoferit i dukej sikur vinte nga pas. Është një «Zuk» që zbret nga Qafa e Malit për në Tropojë.

— Çudi! — bindet më në fund shoferi.

— Pyete kolegun tënd si është rruga matanë, — i them shoferit.

Ai zbret, takon shoferin tjetër. Pastaj nxiton të kthehet shpejt dhe hipën me kërcim në makinë. Ka ftohtë dhe më sqaron:

— Rruga përpara ende s'është zënë. Por paska rrezik të na i bllokojnë kamionët e kromit.

Ecim dhe gjithnjë ngjitemi. Makinës i kemi vënë ridoton. Përparojmë me shpejtësinë e breshkës. Deri në Qafë të Malit kështu do vazhdojmë, se është e përpjeta, pas Qafës fillon ta

tëpjeta dhe zbritja. Por deri atje kemi akoma shumë rrugë.

— U pagëzove mirë sot, — i them për këtë udhëtim në borë.

— Po kalitemi, — përgjigjet ai i gëzuar. Është mbarsur mirë me shpresën, që i dha koleguri «Zukut», se rruga do të jetë e hapur.

Kalojmë edhe sondat e vogla, krelieuse, të gjeologjisë dhe arkat me kampione mineralesh anës rrugës. Arkat janë mbështjellë me akull dhe ngjajnë si frigoriferë të vegjël shtëpie.

Më tej lëmë pas tre burra me çadrat të hapura mbi krye, të mbuluara me borë, dhe fenerë vajguri në dorë. Ka diçka groteske në siluetat e tyre; paçka se halli që i ka shtyrë të dalin në këtë natë s'duhet të jetë aspak i tillë.

— Duhet të jenë punëtorë të gjeologjisë, — thotë shoferi, që po fillon të mësohet me rrugën.

— Ndoshta. Por mund të jenë dhe barinj malësorë që shkojnë të kujdesen për bagëtinë në ndonjë vathë këtu rrotull. Bora është e pabesë për gjënë e gjallë.

— Po qeni? — thotë shoferi. — Qeni ku është?

Qeni s'kishte. Pra, sipas shoferit, barinj s'mund të ishin!

Çadrat e mbuluara me borë të tre burrave, ndriçimi i dritavë të makinës i bënte të dukeshin si kupola kishash ruse.

— Rrugë e gjatë, — thotë shoferi. — Tmërrësisht e gjatë!

— Kështu duket gjithnjë rruga natën me dëborë, — përgjigjem unë. — E gjatë si natë dimri.

... Më në fund, pas Lajthizës, duket që s'kemi ku ecim më. Kemi kaluar hotelin rrugor, që çuditërisht punon në verë, kur s'ka nevojë njeri për të dhe mbyllet në dimër, kur ka shumë nevojë, që të strehojë udhëtarët fatkeqë në një natë si kjo. Si puna jonë.

S'kemi ku shkojmë më tej. Para nesh një «Skodë» shytë me targën e Shkodrës ka zënë rrugën.

Shpresat për të mbërritur në Fushë-Arrëz veniten dhe parandiej se do presim gozhdë këtu ku jemi.

— Po, dalitë shoh ç'bëhet, — thotë shoferi. Ai ka lakoma shpresë. Është i ri dhe të riun shpresa e rrit. Hapet dera, shoferi del përjashta dhe kabinën e ingrohtë e pret si me brisk një vrushkullor rrëmbyerë me borë.

Shoh shoferin tek recën, që e merr ana herë majtas e herë djathtas; duket si i dehur. Bora ka ngrirë kallkan dhe ai rrëshqet sa herë shkel mbi të. Do t'i këtë këpucët me gomë, mendoj unë. Në akull goma rrëshqet shumë, si thika në gjalpë.

Gliqeria ka mbaruar, s'këndon më. Qetësi në kabinë, por jashtë të shkullera. E ndiej erën që fryn e fortë përjashta, jo se e dëgjoj, por shoh targën e llamarintë të Shkodrës, që ngrihet e ulet herë pas here duke u përplasur në barkun e karrocërisë së «Skodës» si një bisht kali që vret miza me inat të madh. Miza nuk ka. Ka erë dhe kristale akulli si kokrriza rëre, që të therin më keq se mizat.

Shoferi kthehet. Zë vendin e vet-te timoni. Fut duart në mes të shalëve si gratë në hall të

madh. Qetëson frymëmarrjen dhe më në fund jep lajmin e keq:

— Rruga është e zënë! S'kemi më shpresë. Janë tridhjetë kamionë me krom para nesh, që i kanë bllokuar dy makina të parkut të Tropojës. Duhet të çajne tropojasit njëherë, pastaj këta shoferët me krom mund të na i hapin rrugën neve. Ç'e do! S'kanë zinxhirë, kodoshët!

— As ti nuk ke zinxhirë, — i them unë, si për të marrë në mbrojtje kolegët e tij.

— Ç'i duam ne zinxhirët! Ne kalojmë kollaj, se jemi lehtëshëm. «Skodave» me krom po, u duhen zinxhirë, se janë të rënda si tanke.

— Po rregullorja? — e ngacmoj unë.

— Lëre rregulloren me gjithë zinxhirët! — nevrikoset shoferi. — Por nuk kanë as lopata, që t'i hedhin akullit skorje kromi! Sikur shkojnë në dasmë.

Zbres dhe unë si krushk nga makina dhe pas bërrylit të rrugës që e ka zënë «Skoda» e Shkodrës shoh vargun e gjatë të dritave të makinave. Dritat duken si një fshat i madh, i shpejndarë shumë. Natën, natyrisht!

Kot dola. Bën ftohtë thëllim. Isha mirë brenda në kabinë. Më ngrijnë majat e gishtave dhe të veshëve. Kokën e kam zbuluar dhe këmbët me çorape nejloni. As njëra dhe as tjetra për dimër nuk bëjnë. Duart i siguroj në xhepat e pantallonave dhe më ngjan vetja si Sharloti.

Dikur, kur kam qenë student, kam pasur një shok kursi, polak, që i kishte majat e veshëve të prerë si me vizore. Ngurroja ta pyesja pse i kishte ashtu curr. Kujtoja se kish bërë ndonjë turp të madh me gratë dhe veshët do t'ia ki-

shin prerë burrat xhelozë të tyre. Siç kemi në në fshatin tonë Colen, që ia preu veshët vëllai i madh i vajzës, me të cilën deshi të gudulisej e të bënte qejf. I varfri Cole. Qejfi kudo paguhet. Dhe Colja e pagoi me veshët.

Por polaku nuk i kishte veshët curr për punë grash, por për hall dimri. Një natë akull të janarit të Gdanskut u gjet përjashta. I kishin ngrirë majat e veshëve dhe i kishin rënë si vathë përtokë. Po të mos e kisha provuar se ka të ftohtë të tillë në botë, as unë nuk do ta besoja.

S'e duroj dot të ftohtët dhe s'kam mall të mbetem curr. Dua të bisedoj e të këmbëj dy fjalë, të sqaroj situatën me shkodranin, shoferin e «Skodës» dhe i bëj me shenja të hipim, se s'llafosemi dot në këtë furtunë. Ai e thith shpejt mendimin tim. Hap derën e kabinës. Futëmi brenda. Ngrohtë. Shpëtova! Prokopia vetë!

— Mirë ne, — thotë shkodrani, — se këtë punë kemi. Ky qe shorti ynë. Me kromin mbajmë kalamajtë. Po ju ç'dreqin kërkoni? Ç'keni që haheni me motin e keq në një natë të mbrapshtë si kjo?

I shpjegoj se nxitoj të çoj shkrimin në gazetë. Kam gjetur një material interesant në Lekbibaj.

— Shkrimin e çon dhe nesër. Gazeta del edhe pa shkrimin tënd interesant, — kundërshton ai. — Natën nuk këni pse të udhëtoni. Nata gjithnjë ka një sahat të keq.

— Po ju? — çuditëm unë. Ai u jepte këshilla të vyera të tjerëve, por vetë vepronte ndryshe.

— Na? Mirë të na bahet! Harruam që mbas verës gjithnjë vjen dimri. Zinxhira rro! Lopata jo! Por akulli s'të fal. Nuk e ban dot kurrë shok. Duarthatëve si na sonte le t'u paguajë shpirti vuajtjet! E kemi hak!

— Nash taksirat! i them unë papritur. Dhe u hutova dhe vetë si m'u kujtua kjo fjalë tani.

— Çfarë? — pyeti shkodrani, që s'kuptoi ç'i thashë.

— Taksirati ynë, — përkthej unë.

— Ah, po! Por, veç, për mendtë tonaze kemi të zezën sonte.

— Njëherë, kur kam mbetur në Qafë të Bualit në Bulqizë.

— Qenke i gjezdisur zotnia jote! — më ndërpret shkodrani.

— Jam ca! — tia kthej unë me të njëjtën monedhë.

— Po, — thotë shkodrani. — Jepi më tutje!

— Në një natë si kjo dhe me një të ftohtë si ky një plakë, tek merrnim e jepnim të ndiznim zjarrin dhe s'e ndiznim dot, ma mësoi këtë shprehje: «Nash taksirat». *Taksiratin* e tha turçe, *nash* e tha sllavçe, kurse vetë që shqiptare.

— Ballkan hesapi, — tha shkodrani. — Përzihen gjuhët si lesh harapi.

— A do çajmë dot sonte Qafën e Malit? — pyeta unë, duke iu kthyer merakut kryesor që kishim.

— Mos ki dert! — më përgjigjet shkodrani. — Sa të pushojë murlani, do ta bëjmë zift të zi rrugën me krom dhe për dekikë do të çajmë përpara. S'jena kot arusha mali!

Po kur pushon murlani? Këtë as ai, arusha e malit, nuk e dinte.

Shkodrani është i imët, i vogël si çiklist dhe nuk ngjan fare me arusha mali. Po fjalët që thotë, më ngrohin, paçka se nuk i besoj.

— Domethanë, punon në gazetë? — pyet shkodrani. — Domethanë je gazetar! — shton ai i sigurt: — Zanat i mirë, që s'të len pa bukë sot.

— Shkrimtar, — sqaroj unë.

— Unë jam Çuni, — prezantohet ai. — Po ju kush jeni?

— Unë jam burri! — ia kthej si ai me humor. — Që je çun, e shoh. Po emrin si e ke?

— Çun, pra, më quajnë! — revoltohet ai. — Nuk tallem. Çun Kraja më thonë.

— Qenke fis me Fadilin, — nxitoj e them unë, si për të dalë i njohur dhe për të kapërcyer keqkuptimin.

— Po, — thotë ai. — Fis jena. Por jo me Fadilin e teatrit, por me atë të shkollave.

— Fadilin e teatrit e njoh, këtë të shkollave jo! — shfajësohem unë, gati sikur kërkoj të falur.

— Ani, s'prish punë. Në Shkodër ka nja pesë krajanë me një emër, aq sa s'njohin as njani-tjetrin, — më ngushëllon shoferi. — Po ti kush je? Apo je anonim? Inkognito!

E them emrin.

— Gëzohem, — thotë shoferi.

— Më vjen mirë që u njohëm, — them unë.

— A me të vërtetë e kanë sakatue me thikë atë Rembrandtin tonë në Tiranë? Më tha një ditë një student tiranas, pasagjer imi, por nuk e

besova. Marrina! — tha paprtitur Cùn shkodrani.

— Vërtet! — i them me keqardhje. — Dhe jo me brisk, se do ishte gjysmë e së keqes, por me shufër hekuri. Ia kanë prishur tmerrësisht ballin dhe syrin, sa do shumë punë të restau-rohet.

— Maskarenjtë! Horrat! Janë ziliqarë, që ne kemi Rembrandit. Kam dëgjuar se luhet parë e madhe për të. Kështu më ka thanë një piktor në Shkodër, kur lexova librin për hollandezin e madh.

— Besoj se duhet të vlejë disa milionë dollarë. Këtë vit në ankandin e Londrës «Zambakët» e Van Gogut u shitën për pesëdhjetë milionë dollarë.

— Mos, bre! A-pa-pa! Nji fjalë goje. E pra, na kemi Rembrandtin tonë, minierë floriri. Por nuk dimë t'i ruajmë thesaret.

— Të ligj e të cmendur ka pasur e do të ketë gjithmonë. — i them unë, si për ta ngushëlluar shpirtin artist të shkodranit për Rembrandtin e dëmtuar në Tiranë.

— Të ligj ka pasur dhe nuk them që s'ka e s'do të ketë. — ma kthen Cùn shkodrani me trishtim. — Por si ia thotë një fjalë labi, për horrin ka Çecuà bicak! Besa, llafe bajmë shumë, por s'duhet harruar bicaku!

Unë hesht. Dëgjoj dhe me heshtie i iaj të drejtë. Por Cuni heshtjen time e merr për mëdyshje dhe do të sigurohet.

— Apo e kam gabim?

— Jo! Ke hak. Tamarë është. — them unë me gojën plot, që të mos dýshojë më në të drejtën e tij.

— Ndize një timen, — thotë ai, i kënaqur me atë ç'dëgjoj dhe më ofron cigare «Tarabosh», të cilat kam kohë që s'i kam provuar.

— Kaluan dy orë që presim, — them unë, sipër të vazhduar bisedën e lënë në mes.

— Që presim gozhdë, — plotëson ai mendimin tim. — Baj durim. Bora po rrallohet, murlani do prajë. Po deshe, fli. Baj një sy gjumë. Ja ku e ke kariollin.

Krevati portativ, kariolli, është mbi kokat tona i varur.

Te dera e «Skodës» shfaqet Iliri. Ka merakun tim. Ku humba kështu?!

— Unë po zbres, — thotë Çun shkodrani, duke ia lënë stafetën e përkujdesjes për mua shofer Ilirit. — Murlani po bjen e mund të shtrojmë skorjet rrugës.

Nga turpi zbres dhe unë me të.

— Me kujdes, — porosit shkodrani. — Kapu në krahun tim se mos rrëshqet.

Bëj si më urdhërojnë dhe ecim.

Tashmë te dy kamionët, që kanë bllokuar rrugën, shoferët po punojnë. Mbajnë skorje kromi me qese celofani dhe copa mushamash. Dimri ka ardhur papritur, mik i paftuar e i pabesë. Të gjithë i ka gietur zbuluar, pa zinxhirë e pa lopata. Kur do të iemi të aftë të fitojmë edukatën e dimrit?! Edukatën e punës?!

Përbidam dhe unë të ndih në këtë mundim të skorieve. Duart më bëhen mavi dhe nën dritën e «projektorëve» të makinave shoh kaltërsinë e damarëve të gjakut në të.

— Ik, or xhafë! Ik, se na jena burra të mësuar me borën! — dëgjoj një zë nga prapa që

më thotë kështu. Patjetër do të ketë parë duart e mia të shkreta.

— Ik, xhajë, se nuk kemi nevojë për viktima! — më bën thirrje një tjetër zë.

Mirë që nuk thonë: «Ik, or gjysh!» Kurse Çun shkodranit i vjen keq që më përzënë kështu.

— Mos u mërzit. Nji tash do ta hapim rru-
gën e po të lejmë të kalosh i pari.

I bindem përsëri urdhrit si ushtar i mirë Shvejk. Është dita e bindjes sime të plotë.

Futem në kabinën e veturës. Fërkoj duart fort me njëra-tjetrën, që të ngrohem disi. Dhe pres me ankth, a do të hapet rruga sonte. Hapet dera. Nuk është Iliri, ai po mundohet me skor-
jet, bashkë me kolegët, por një burrë i mocëm me plis të bardhë në krye.

— A do miq, o i zoti i shtëpisë? — thotë ai në vend të përshëndetjes.

— Bujrum! — ia kthej i gëzuar, që s'mbëta pa shok dhe që s'qenkam i vetmi sehirxhi sonte.

Burri i mocëm me plis është një nga udhë-
tarët tropojanë të makinave që kanë ndaluar pas nesh. Tashmë është krijuar autokolona e gjatë e makinave që presin të çelet rruga. Mikut i vjen era raki e fortë.

— Ky i ftohtë vetëm me zjarrmin e rakisë luftohet, — thotë malësori. Duket qartë që e thi-
thi shpejt, me magnet mendimin tim.

Ai nxjerr nga xhepi i brendshëm i xhunit të madh prej meshini një faqore të sheshtë raki si portofol i madh.

— Ktheje një herë. Ngrofe gurmazin. Mos ki merak hiç, së asht raki për qejf. Raki dasme.

Kumbull e zime dy herë! — më ofron dhe më reklamon ai rakinë.

Nuk ia prish malësorit plak. S'ka pse të lodhet të më lutet dy herë. E kthej faqoren dhe dicka ndryshe e ndiej dhe unë veten. Rakia, si çaj i nxehtë, më përcëllon grykën. Harroj dhe diabetin, harroj dhe këshillën e mjekut, që njëqind gramë raki ka shtatëqind kalori dhe e kthej prapë. Raki e dashur.

— Kemi pasë sebeb mbramë. Martonte një nipi im djalin dhe jena kënaq. Në televizor pamë edhe Rexhep Qosjen. Ka folë bukur fort për gjuhën tonë. Tamam si me qenë Naim Begu i Toskënisë. A e ndigjove? — më sqaron e më pyeti tropojasi plak.

— Jo, — i them unë. — Kam fjetur në Lekbibaj mbrëmë dhe shtëpia ku fjeta s'kishte televizor.

— Televizori asht shpikje e madhe. Ta jep na, në pëllambë të dorës gjithë botën.

— Rexhepi është shkrimtar i zoti, — them unë, — kritik i shquar.

— Asht tamam burrë malësie, — ma kthen plaku. — Atje, në Vuthaj, i kam do miq e shokë të vjetër e i njoft mirë. Të tanë të zotë për kuvend e gisht. Por nii ky trimi i Qosjet, beşa, po ua rruan mjekrën të gjithëve!

Vjen shoferi shkodran dhe më jep lajmin e shumëpritur.

— Rruga u hap. Të priftë e mbara!

Falënderoj Çunin e ftoj plakun të udhëtojë me veturën tonë. Plaku më përgjërohet për nderin e më shfajësohet, se nuk i len dot gratë vetëm. Me të qenkan edhe pesë gra e çika kru-

shka. Ndahemi e urojmë të takohemi përsëri, por jo si sonte në akull e acar.

Më detyron ta kthej edhe një herë grykën e faqores së rakisë, se «kjo e bekueme për kësi rastesh qeka ilaç i parë!»

Shoferi ndez motorin. Rrotat vërtiten në akull, po makina s'ecën. Disa minuta mundahe- mi kështu kot. Rrotat xhirojnë bosh.

— Mos u mërzitni, burra! — dëgjojmë di- sa zëra. Janë shoferët e kamionëve të Shkodrës e të Tropojës, që i vënë duart dhe shpatullat makinës dhe ajo shkëputet e çan përpara.

Shoferi i bie borisë me avazin e «Lakuku- raçies» si shenjë mirënjohjeje. Pas nesh tunden duart gjak nga të ftohtët të burrave shkodranë e tropojanë. Dhe ato ngjajnë, nën dritën e gë- zuar të makinave dhe në bardhësinë verbuese të borës, si shami e shalle të kuqapionierësh. Fa- leminderit!

Maj 1989

Portokalli i alpeve

Ishte një dëborë e çuditshme, ishte një dëborë e pabesueshme! Binte në maj!

Ishim nisur për udhë të gjatë, midis maleve që ndajnë Kukësin nga Dibra, buzë Drinit. Peshkopinë e kishim lënë pas me diell. Drini plak po na priste me topa bore. Rrugës së rinisë, por tashmë të moshuar, bora vazhdonte të binte shtruar si për Vit të Ri. Çarçafi i bardhë i saj kish mbuluar gjithçka dhe rruga nuk shquhej më. Nga xhami i prapmë i makinës dallohej traga e thellë që linin rrotat në borë. Ishte e qartë që udhëtimi po dështonte.

Në fshatin Z.D. ndaluan me shpresë që më tej moti do ndryshonte e do hapte koha. Pra, frenuan të pyesnim ç'bëhej tutje Grykës së Skavicës. Naiviteti i madh. Më thellë e më të ruda. Bora sa vinte e shtonte trashësinë e jorganit të saj. Tamam si për dimër.

Makina jonë, natyrisht pa zinxhirë (kujt i shkonte mendja në maj për ta!) tani s'bënte dot as përpara, as pas. Duhej pritur ose të zbutej moti Grykës së Drinit, ose të ngjishej a të shkrinte Fushës së Çidhnës. Shkurt historia, u ngjuam në Z.D. dhe si në përrallën e moçme: rrezikzi përpara e rrezikzi përmbropa.

Qemë nisur pa ngrënë sillën, jo aq për të fituar kohë sesa me bindje që do gjenim një gotë qumësht të paskremuar në lokalet e fshatrave blëgtorale të kësaj ane. Ishte maj, muaji i bulmetit, kur dhe deti bëhet kos.

Na kish marrë uria dhe të ftohtët po na hynte në palcë. Pashë sahatin. Të dy akrepat qenë puthitur me njëri-tjetrin sikur bënë dashuri. Tregonin orën dymbëdhjetë. Po afronte dreka. Në klubin e Z.D. kishte makaronat e ftohta akull, stalagmite. Më shiuuan si pastaço. Kërkova verë dhe më dhanë raki. Në trvezë me ne, me mua dhe shoferin, kërkoi leje dhe u ul dhe një dialë i ri. Kuptohej lehtë që nuk ishte nga ky fshat, përderisa pranoi na naze për gjellë më të mirë atë që i ofroi kamerieria. Makaronat e ftohta. Çudi pse të ishin aq të ftohta, si të nxierra nga frigoriferi e jo nga soba kur ne qemë klientët e parë fare e me sa dukej, të vetëm? Me siguri i kishin batur qysh në mëngjes dhe i servirnin për drekë.

Vërtet, ai tietri ishte jabanxhi, mësues nga Korca, që jepte biologjinë në shkollën e mesme të këtushme. Porositëm një gotë raki dhe për të. Ai ma ktheu me kafën pas buke.

— Ke vite që punon këtu? — pyeta unë sa për nxemje.

— Nuku, çne! Vetëm viti i dytë, — tha ai disi i hutuar.

— Për të ngrënë hake këtu, për të fjetur si ia bën? — pyeta prapë unë.

— Jemi rregulluar mirë, — tha ai. — Vjet është ndërtuar shkolla e re, e mesme. kurse në të vjetrën, në tetëvjeçaren, na kanë dhënë një klasë. S'jemi keq. Vetëm ujë nuk ka.

— Pse thua «jemi rregulluar»? Pse nuk flet si për vete, por si për botën? Apo je «kuadro» në shkollë? — pyeta prapë unë, me një farë shpotie të lehtë, sa për të krijuar disi intimitet.

— Nuk ju kuptoj! — tha ai tjetri, që hante makaronat e ftohta.

— Mos je drejtor, pra?

— Nuku, bre, çne. Çfarë drejtori! Unë jap vetëm biologji dhe higjje më tepër. Bile, as klasë kujdestarie nuk kam.

— Po ti fole në shumës. Sa veta jeni që flini në shkollën e vjetër?

— A, tashti ju mora vesh. Ja ku fshihet lepuri! Ju, demek, dyshokeni mos flas në shumës se më pëlqen të bëj si ca inspektorë arsimit që, kur vijne për kontroll, thonë përherë: «ne seksioni»! Ju kuptova! Nuku, s'është ashtu! Por vërtet jemi rregulluar mirë, se ne jemi dy mësuës të ardhur. Shoku tjetër është nga Tirana, në fakt, tamam-tamam, është lab. por banon në Tiranë. Për «nesë Majin» e lanë të shkonte në familje, se pret njerëz për ditën e dëshmorëve. I është vrarë gjithë me Brigadën e Pestë në Jugosllavi. Përndryshe, tashti do ishim bashkë, duke shijuar makaronat e Rivës.

— Riva! Kështu quajnë kuzhinieren? —

pyeta unë, disi i habitur me këtë lloj emri të rrallë, që e kam hasur vetëm një herë në Lekbibaj.

— Jo! Këtu kuzhinieri është çun i ri, nga ata të shkollës së Tiranës. Nuk ia ka marrë dorën akoma makaronave, po groshët i qan. Ç'e do, ka mbaruar sezoni i groshëve, që ta provonit. Riva është kamerierja.

— Si duket, është specializuar vetëm për groshë, — thashë unë për kuzhinierin.

Tjetri heshti, pa më përgjërëm nga kameriere Riva, që mbante shami të bardhë me ojna në krye dhe pastaj shtoi me mëdyshje:

— Ndoshta në ushtri do të mësojë si gatohen makaronat.

— Ishallah! — Ky që foli ishte i treti i tryezës sonë, shoferi, që s'kish folur fare gjatë gjithë kësaj kohe. Dhe na jepte mësim mua dhe korçarit që, kur hahet, nuk flitet. Shoferi hante i qetë makaronat e ftohta dhe ngrohej duke dëgjuar. Si pa dhe një herë përjashta borën që vazhdonte, pyeti:

— A mban gjatë bora e beharit këtu? Apo është si shiu i beharit, vrap i gomarit?

— Nuk di ç'të them, — ia ktheu mendueshëm mësuesi nga Korça. — Di vetëm që këtu s'është e para herë që bie borë në maj. Unë e kam për seftë në behar, por shokët vendalinj më kanë rrëfyer që dhe para disa vjetësh ka rënë. Siç tregojnë, ishte moti i portokallit të Sulltan Muratit.

Mësuesi i biologjisë, siç dukej, po na kthen-te reston e shakave tona.

— Çfarë? Si the? Portokalli i Sulltan Mu-

ratit? Ohua, qysh në kohë të Skënderbeut! Pse s'thuhet para disa shekujve! Ç'na ngatërron me disa shekuj? — tha i habitur shoferi.

— Jo, bre, jo, — sqaroi mësuesi shpejt e shpejt.

— Jo para disa shekujve, por vetëm para disa vjetëve. Dhe jo portokalli i Sulltanit që plasi nga marazi i Skënderbeut, por Sulltanit të këtushëm, që gëzon shëndet të plotë.

Unë hapa sytë. E kish me gjithë mend apo vazhdonte të tallej me ne!

— Kështu e quakan katundarin, Sulltan Murat?! Le që nuk ka ndonjë gjë për t'u habitur, — qetësoi veten shoferi, — kur dhe kamerieri quhet Riva, si me qenë e motra e Xhixhi Rivës, golashënuesit më të madh të Italisë. Emra allosoj paska mileti këtu, bash si kjo bora e majit, me të cilën humbet mendjen dhe shkenca!

— Nuk është se e ka bash emrin Sulltan Murat. Nuku. I ka mbetur kështu, se është njeri i rëndë. kurrë...

— Ç'e tjerr më gjatë, s'ka nevojë për komente, — e ndërpret me guxim shoferi, — Sulltan Murat ma! Kaq mjafton! I ke thanë të tanat!

— Jo të gjitha, — sqaron mësuesi. — Njeriu është do të thosha, vetë misteri. Dhe s'ka asnjë kod gjenetik që do ta zbërthejë. Çudi është njeriu. Ja dhe Sulltani ynë, inatçor që shok ka veten, i rëndon dhe këmisha që mban veshur, po zemrën e ka të bardhë borë e të brishtë qelq. Tamam fëmijë. Dhe është qen i punës. Artist!

Vërtet, ky njeri me emër të tmerrshëm, me karakter të turbullt e të mpleksur ligsht po na përzihej në bisedë si ato konet e vogla, që të

ngatërrohen nëpër këmbë, megjithëse nuk e njihnim hiç.

— Ti kujtove atë vitin e portokollave të Sulltan Muratit, — vazhdova bisedën me tej. — Mos punonte gjë në Lukovë asokohe ai? Së njëherë atje, në Lukovë, kam takuar një malësor të këtyre viseve (më duket bari nga Kälaja e Dodës) që ashtu si ne sot priste të mbaronte shiu në klubin e fshatit. Malësori dallohej lehtë nga bujtësit e tjerë, se midis kasketave e «republikave» vendase, zbardhonte qeleshja e prerë e tij. E pyeta ç'hall e kish sjellë në Lukovë. Më tha se nuk e kish prurë as halli, as malli. Punonte në ullishta e jetonte këtu me gjithë robt e vet. Ishte shpërngulur përgjithmonë. Dhe këtë të mirë, për të jetur në breg të detit, ia kish për nder babës! Babai paskësh qenë një nga drejtuesit kryesorë të rrethit, që e kish ndihmuar të gjente punë dhe shtëpi, sidomos shtëpinë, se për punë atë mot në Lukovë kishin nevojë shumë dhe s'u mjaftonin forcat.

— Paska qenë pragshkulur, — tha mësuesi. — Sulltani ynë s'është i tillë. Ai është pragngulur dhe i ngulur fort këtu, buzë Drinit.

— Po portokalli, atëherë? — pyeta unë. — Ku ishte?

— Edhe portokalli këtu ka qenë! — më ktheu mësuesi.

— Si këtu? — u shushat shoferi. — Ç'do të thotë këtu?! Portokall në një mijë e ca metra lartësi dhe në kërthizë të Alpeve s'mund të ketë!

— Ashtu mendoja dhe unë, kur e dëgjova së pari. Dhe mos harro që jam specialist i biologjisë, — tha tjetri qetë. — Po ti vetë the që

këtu humbet mendjen dhe shkenca. Dhe me historinë e portokallit të Sulltan Muratit tamam e humbet!

— Na e trego! — bëri thirrje e lutje bashkë shoferi.

— Është histori më veje dhe tepër e gjatë, — tha mësuesi.

— Eh! Si po shkon moti sot, ne mund të degjojmë dhe «Një mijë e një netët», — thashë unë.

Dhe mësuesi filloi të rrëfejë këtë histori që, në të vërtetë, është dhe tregimi që doja të kallzoja sot.

Atë vit, një ditë prej ditësh, Sulltan Murati zbriti prej malit e ra në Peshkopi. Miku që e priti, e sajdisi mirë. Në pazar të Shupenzës bleu mëshqerën e racës, për të cilën kish marrë udhën. Ishte dimër dhe në dyqanet e Peshkopisë shiteshin portokalle mjaltë të Himarës. Mbase malli për Himarën (kish bërë dikur ushtrinë në atë vend të bekuar të Shqipërisë) a ndoshta më tepër dëshira për të kënaqur fëmijët, më siguri të dyja tok, e shtynë të blinte dy kile portokalle. Portokallet për fshatin e tij, atje në mal, në prehër të Alpeve, ishin një gjë e rrallë fort. Megjithëse, po të jetë për kalamajtë, ata do t'i gëzoheshin patjetër më shumë mëshqerrës larëmane sesa portokalleve dyll të verdhë, se mot do të burbuletin me qumështin e ëmbël sheqer të saj. Kështu mendonte vetullrënë Sulltan Murati,

tek përcillej e ndahej nga miku i tij i gjendur i Peshkopisë.

Ec e ec mëshqerra e hutuar për rrugën e gjatë dhe të papritur që kish marrë në vise ku binte borë e madhe dhe Sulltan Murati, i kënaqur me pazarin e mbarë, por gjithnjë hijerëndë, si e kish nur vetëm ai për shtat.

Rrugës djersiti, e mori etja, po nuk i shkoj kurrsesi mendja të haptë grykën e torbës e të ëmbëlsonte gojën me një kokërr portokalli. 'Jol Piu, ashtu si dhe mëshqerrë, ujë brisk të ftohtë të Drinit, në zallin e vaut dhe shoi etjen. Portokallet s'ishin për burra, ato bëjnë sall për kalamaj.

Trasta me portokalle, si me zogj të kllockës, nuk e lodhte. Më shumë e mundonte mendimi se mos i vriteshin ato, tek i peshonin krahun, dhe pastaj i hidhëroheshin. Lezetin, si çdo frut i zotit, edhe portokallet e kanë kur s'janë të vërra a të shembura, qoftë dhe me njëra-tjetrën. Këtë gjë e dinte bukur mirë, e kish parë dhe atje në Himarë, kur kish pasë qenë ushtar. Herë-herë i bëhej se në trastë kishte fshehur gjithë diejt e botës. Çdo kokërr portokalli që si një diell i vogël për të.

Rruga filloi të lakohej përpjetë malit dhe ja, më në fund, sosi në fshat, ku fëmijët prisnin mëshqerën laramane. Dhe kështu, i zyrtë si gjithnjë, tani edhe nga lodhja, u dorëzoi mëshqerrën fëmijëve. Le të luanin me të e t'i gjenin të varfrës një krah bar.

Në darkë hapi trastën, nxori diejt e vegjël, të verdhë sa të verbonin sytë. Hutoi me këto fruta robt e shtëpisë, dhe të nëntë çiliminyje, nga

i madhi tek e vogla, u dha nga një kokërr. «Qerasu dhe ti me një portokall», i tha së shoqes. E zonja e shtëpisë dhe nëna e kalamajve e vuri portokallin e falur, siç bënte me kokrrën e parë të ftoit, mbi buhari. Dhe atje kokrra e artë e portokallit i bënte karshillëk poçit të llampës.

Sulltan Murati vetë u tregoi si qëroheshin. Hoqi biçakun nga brezi, futi vetëm paksa majën e tij në lëkurën tul të butë (si mish qingji i zier) të portokallit. Kujdes mos e therni! Dhe filloi të gërvishte e të vizatonte në lëkurë të portokallit me majën e biçakut, si «në globin e shkollës disa meridianë», tha më vonë çuni i madh i Sulltanit, i cili mësonte gjeografinë në klasën e shtatë.

Shtatë fëmijët më të rritur, nga i treti, që ishte gjashtë vjeç, deri tek i madhi fare, ai i klasës së shtatë, që qe katërmbëdhjetë vjeç, nuk patën nevojë për ndihmë e mësim tjetër, i qëruan fët e fët vetë portokallet dhe filluan t'i hanin feta-feta, si copëza bakllavaje, me shije të madhe. Për ta ato ishin një zbulim i ri në jetë. Dy më të vegjëlve, që ishin goca, tre- dhe katërvjeçare, ua qëroi me dorën e vet vetë baba, Sulltan Murati. Tek mbushnin gojën plot me lëngun e çuditshëm të frutave, Sulltani u tha fëmijëve: «Ato bërthamat, ato farërat që ka kokrra e portokallit në tul të vet, që të ngelen nëpër dhëmbë e nuk hahen se janë të idhta zeher, mos i bani dam e mos i pështyni përtokë, por hidhni në këtë sininë, nji këtu!»

Dhe fëmijët bënë siç tha baba, as i hodhën e as i shpunë dëm, por i lanë mbi sininë e ba-

kërt, që nga të-larët me merak të zonjës së shtëpisë ngjante si hëna në mes të sofrës.

Dhe kjo që nata e parë e portokalleve...

Erdhi përsëri darka dhe baba, Sulltan Murati, u ndau prapë kokrrat e fundit të portokalleve. Atë mbrëmje detyroi dhe të shoqen të provonte një kokërr. Dhe ajo, me turp e mëdyshje zonjash fisnike, tha: «Ç'e deshe, imzot!», dhe, deshi s'deshi, e provoi si Eva e parë fikun e Adamit. Mendoi e dëshiroi t'i jepte edhe të zotit një fetë, të paktën një fetë ta provonte dhe ai, por ia njihte mirë kaptinën Sulltanit. Babai i fëmijëve porositi edhe një herë të mos i harxhonin kot bërthamëzat e idhfa dhe ata i lëshuan përsëri në sininë si hënë e plotë vjeshtë. Dhe farëzat e bardha të portokalleve ngjanin me kokrrat e orizit për dasmë të nuseve.

Përfundim frynte murlani dhe në ahur mëshqerra pëlliste nga frika.

Dhe kjo ishte nata e dytë e portokallit...

Të nesërmen Sulltan Murati i mori farëzat nga sinia dhe i futi një e nga një në sepet të zonjës së shtëpisë, duke i siguruar mirë si amerikanët e parë rërën e artë të Alaskës. Për të mos iu prishur e marrë erë, i pështolli me këmishën kambrik të bardhë xham të dhëndërisë.

Kjo ishte dita e tretë e portokalleve.

Mbas dyzet ditësh e dyzet netësh, kur bora shkriu në bjeshkë dhe erdhi koha të mbillesh në ara misri, Sulltan Murati vendosi për gjënë më të rëndësishme në jetën dhe më të habitshmen në historinë e fshatit: të mbilte farëzat e portokallit!

Mori një vedër me dru lisi, nga ato të bul-

meçit, e mbushi deri në grykë me hi të pastër e pleh të paqme mëshqerre, rراسi me merak bërtamëzat në këtë brumë hiri e plehu dhe e vendosi vedrën, si një vazo të madhe me lule, në parvaz të dritares, tek oda e madhe e miqve.

Kjo ishte dita kur u mboll portokalli dhe kur fshati tha: luajti mendsh Sulltan Murati!

Fshati, i bindur në dyshimin e vet, dhe Sulltan Murati, i shqetësuar në besimin e vet, prisnin a do të lëshonin fidanë farëzat në vedrën e drunjte të lisit. Prit e prit fshati dështimin e turpin e Sulltanit, i dyti lindjen e filizit të përgjëruar, tashti edhe për inat të fshatit.

Ai vazhdonte përditë t'i hidhte, si mëngjesin e parë të mbjelljes, hirit të vatrës dhe plehut të mëshqerrës së vedrës ujin llagar e të vakët të finjës. «Me gjithë këtë ujë finje, që harxhoj për të ujitur portokallin, — tha njëherë e lodhur e zonja e shtëpisë, — do t'ua kisha larë lëvërçtanë fshatit!»

... Prit e prit dhe një ditë prej ditësh ndodhi çudia e botës: në odën e madhe të miqve të Sulltan Muratit, në kërtizë të Alpeve, mbia fidani i voçërr, si fidan groshe e sa një majë thëri. Në fakt, në vedër ishin dy fidanë vocrrakë binjakë, që ngritën krye përpjetë.

Fshati u lëkund në bindjen e vet dhe tani qenë të rrallë ata (por jo se nuk pati fare) që uronin të thaheshin një orë e më parë fidanët binjakë. Shumicës së njerëzve (se në botë më shumë janë të mirë se të ligj) u vinte keq për mundimet e Sulltan Muratit dhe disi turp për dëshirën e mbrapshtë që patën dje...

Kurse për Sulltanin tani nisi vërtet udha e

gjatë e mundimeve. Përditë jepte e mërrte me ujitjen me ujë të vakët finje. E kish parë atje, në Himarë, se sa shumë ujë duhej për të ujitur portokallin. Ndërronte plehun («shyqyr që mëshqerrën e kish më derë») dhe, sa herë kish ditë me diell, ai e nxirrte vedrën me fidanat e njomëz përjashta në çardak a në oborr, që të merrnin frymë e erë të gjallë dhe një sy diell të vërtetë. «Është bërë baba kujdestar kopshti kalamajsh, — thoshte djali i madh i tij. — Përditë i qit vocat me pa diellin.» Dhe nuk iu lodh goja Sulltanit duke porositur fëmijët përherë që të mos e linin mëshqerrën e hutuar t'i afrohej vedrës, se gjëja e gjallë është rob i trashë, që s'di ç'është bari e ç'është portokalli!

... Vazhdoi tre vjet kjo histori, gjithnjë e lodhshme, përherë me hi e pleh dhe ujë finje të vakët, herë në parvaz të penxherës e herë në çardak a oborr të shtëpisë, herë për diell e herë për erë, herë për dimër e herë për verë. Herë kur thoshin njerëzit «i qiti Sulltani lulet për t'i ngrohur në shullë» e herë kur e gërgisnin së «kësisoj, këtë dimër e siguroi sanën e mullarit të barit për lopën laramane Sulltani». Se tashmë dhe mëshqerra kish pjellë viç dhe s'thirrej më mëshqerrë, po lopa e Sulltanit.

Dhe mos kujtoni se Sulltani Murati harroi ta shartonte portokallin e mbjellë me farëza. Jo! Një ditë prej ditësh vajti të miku i tij në Himarë, i kallëzoi hallin, nuk dinte tamam me çfarë shartohej ky i bekuar portokall, paçka që gjithë jetën kish shartuar kumbulla e mollë, dardha e pjeshkë. Hamarioti i tha se mund të shartohej dhe me mënyra moderne, por më e sigurtë ishte

me rrëmb nerënxe. Mori rrëmbin e nerënxës dhe, si u çmall mirë e mirë me mikun e vet himariot, iku dhe e ftoi atë të vente të shijonte portokallet në Alpe. U kthye në fshat i lumtur, shartoi portokallin me nerënxë dhe priti të lidhte kokrra pema.

Kur iku prilli e hyri maji, diçka më vonë se në Himarën e bekuar, diku midis vitit të tretë dhe të katërt, fidani që kish hedhur shtat sa një murriz lëshoi lule dhe kundërmoi oda e miqve aromë portokalli. Në vedër, i bukur e i mbarë, rritej vetëm një fidan, se filizin binjak e kish shkukur një ditë Sulltani, që të mos i bënin hije njëri-tjetrit. Dy gjela në një kotec nuk mbahen.

Erdhën e bujtën pastaj atje në çardak të shtëpisë edhe mjaltëzat, bletët punëtore dhe u lidhën kështu kokrrat e para të portokallit, si gogla jeshile. Kjo ishte mrekullia që s'ish parë ndonjëherë në Alpe. Për Vit të Ri dymbëdhjetë kokrrat që mbetën në degë, dukeshin tamam poça llambe të ndezura. Dhe ajo që s'kish ndodhur ta bënin kurrë në fshat, u bë. Kjo qe pema e parë e Vitit të Ri në odën e miqve të Sulltan Muratit.

Kuptohet, besoj, që fëmijët i ruanin për merak kokrrat në degë. Dhe, natyrisht, prapë më vonë se në Himarë, aty nga fillimi i shkurtit, kur degët e brishta u rënduan tepër e kokrrat u poqën, fëmijët e Sulltanit shijuan portokallet e shtëpisë së vet në Alpe e jo ato të pazarit të Peshkopisë.

Ky ishte viti i katërt i portokalleve.

Motin tjetër u bënë dyzet kokrra e u gostitën dhe disa nga pleqtë e padhëmbë të fshatit.

Dhe dikush prej tyre thá atëherë: «Frut i bekuar. Nuk lodhka as plakun as çilimiun. S'paska nevojë fare për gurë blojë!» Vitin e shtatë Sulltan Murati mori pesëmbëdhjetë kile portokalle dhe s'mbeti katundar pa e provuar një fetë portokalli, tamâm bakllava bajrami. U ëmbëlsuan e u pajtuan kështu si ata që besonin dhe ata që nuk besonin.

... Po jeta nuk qenka vetëm tul portokalli e ëmbël, ka dhe farëzat zeher të saj.

Në vitin e tetë, kur kish marrë tri herë pro-dhimin e bëhej gati për të katërtin, një ditë me diell, si nxori, si gjithnjë, vedrën me pemën e begatë në çardak, Sulltan Muratin e çoi halli e mori rrugën prapë për në Peshkopi. Kishte një sebep të mirë miku i tij. U gëzua në dasmën e djalit të mikut. Hëngri e piu sa deshi, dha peshqeshin e u bë gati të kthehej në fshat, ku kish ndodhur hataja!

E varfra e zonja e shtëpisë, duke parë që dita kur zbriti Sulltani te miku i tij në qytet kish qenë me diell të fortë dhe e ngrohtë, sa i kullonte gjiri nga djersa, ishte muaji maj si tani, mendoi dhe besoi që dhe nata do të ishte e ngrohtë. Dhe e la të merrte frymë portokallin në çardak. Por s'thotë kot fjala: çfarë s'bie viti e bie dita dhe ç'nuk sjell sahati e sjell dekika. Atë natë ra dëborë budallaqe, ja, si sot, dhe, kur u ngritën robt e shtëpisë në mëngjes, fek u verbonte sytë borë e bardhë, u pikoi e u qëlloi në zemër portokalli i zhveshur lakuriq, pa një gjeth e pa një lulë!

Mjerë ata të mjerët ç'panë e si duruan! Ngrica kish tharë deri në rrënjë portokallin e

Sulltan Muratit. Mënxyra ndodhi kur s'duhej e kur asnjë ligj i natyrës nuk e jep të ndodhë, në muajin e luleve dhe kur i zoti i shtëpisë, Sulltan Murati, ish djegur nga gruaja dhe fëmijët e tij.

As gurit e as drunit mos i ngjaftë kjo gjamë, thanë fshatarët, kur e morën vesh mandatën. «Mjerë unë, e mjera, ç'i bana burrit!», thirri atë ditë maji me borë si sot e zonja e shtëpisë.

I zoti i shtëpisë, siç thamë, ishte me ngut pa mbaruar tamam dasma, qysh kur pa që dhe në Peshkopi filloi të ftohej si rrallëherë moti, më shumë se ç'e donte muaji. I kish kërkuar të falur mikut, duke i habitur të gjithë krushqit e dasmorët me atë ç'kish thënë: «Kam lënë portokallin vetëm, në mal, burra!»

... Sulltan Murati erdhi në fshat dhe e gjeti me borë të rarë dhe me portokall të vrarë. Ata që e panë, thanë: gati sa s'qau Sulltani, u murrëtye e u nxi si nata e dimrit, sa s'plasi nga marazi, po s'nxori asnjë ofshamë e asnjë llaf. Nuk shau e as mallkoi njeri. Heshti si gur varri. Nuk e cingrisi njeri në tragjedinë e tij. Gruaja ulte kokën e s'e shihte dot në sy dhe dyzet net nuk u fut në shtroje me të shoqin. Asaj i kish humbur lezeti i jetës, atij i humbi fjala fare. Vetëm fëmijët, bënë ç'bënë, dhe e harruan portokallin.

Po vinte dimri përsëri dhe, siç mbyll koha çdo plagë, fshati kujtoi se dhe Sulltan Murati e harroi hallin e vet. Por jo! Kur erdhën festat e nëntorit dhe piqen portokallet në Himarë, Sulltani filloi të dilte në xhaden e rinisë dhe të ndalte e të pyeste shoferët e makinave të rralla:

«A kishin dalë portokallet në pazar të Peshkopisë?»

Shumë thanë: mirë humbi gojën, por tani po humbiste dhe mendjen Sulltani.

Një shofer i ri i dha lajmin që më në fund kishin dalë portokalle. Dhe, duke kujtuar se Sulltani do të kishte gruan me barrë, që patjetër i kish vajtur mendja për to, se s'kish si të qe ndryshe, përderisa tjetri pyeste kaq me ngulm, hapi sediljen dhe i fali një kokërr të madhe portokalli. Sulltanit i erdhi turp ta merrte. Ai që deri dje falte, si mund të lypte sot! Dhe iu mbushën sytë me lot nga pikëllimi. Shoferi i ri, tepër i ndjeshëm, e luti ta merrte. Ku ta dinte shoferi i ri, që ky tjetri ishte Sulltan!

Fjala nxori fjalën dhe Sulltani i tregoi se ç'hall e kishte zënë dhe pse ishte bërë «polic trafikur», që ndalonte çdo makinë e pyeste për portokallet e pazarit të Peshkopisë.

I rrëfeu ç'hata i kish ndodhur në maj, si i ishte tharë e vdekur portokalli i tij dhe si donte ta provonte prapë e prapë të mbillte portokallet në vedrën e odës së madhe të miqve, në kërbizë të Alpeve. Atëherë shoferi i ri mësoi dhe atë urtësinë e vjetër për vedrën me dru lisi, që s'thokan kot: dru lisi e bijë fisi!

Ja, kështu! U shushat shoferi fare me këtë dëshirë të padëgjuar. Ishte i ri ende. Hapi përsëri ndenjësën dhe i dha të dhjetë kokrrat e portokallit, gjithë ç'kishte.

Sulltani nxori qesen me gjalmë nga gjiri t'i jepte paratë për nderin e madh që po i bënte miku, voc i panjohur. Tjetri s'pranoi të merrte lekët. Nuk koritet burri për një kile portokalle.

Dhe u pajtuan, më së fundi, që, kur të lëshonte fidan e të lidhte kokra pema e re, do t'ia lante borxhin Sulltani shoferit.

Ishte po ky voc, shoferi, që u kujtua të pyeste se si i kishte vajtur mendja Sulltanit të rriste portokalle në Alpe, kur as shtetit dhe as shkencës nuk u shkon mendja kurrë. Dhe mori këtë përgjigje: «Unë nuk jam shtet, unë jam vetëm njeri. Sa për shkencën, ajo ka punën e vet e unë timen!» Kam bërë ushtrinë në Himarë. Kam mall për të, ndaj dua të kem portokalle prapë. Qoftë për aromë, qoftë dhe sikur vetëm t'i marr erë e të kujtoj detin... Qe kështu, lum miku! Ti ke sevda për timonin, një tjetër ka për peshkun a derrin e vramë, unë kam për portokallin! Dhe që do të rritet përsëri, tash e besoj e shpresoj jo vetëm unë, por i tanë katundi, se i kan hangër kokrrat. Po që do të rritej, herën e parë e besova se ma bani peshqesh një mik, që më tha në Peshkopi se një miku i tij merakçi në Shehër, në Dibër të Madhe, kish pasë mbjellë në odën e miqve një dru kafeje të Arabisë e i kish lidhë kokrra, sa për vete. Përderisa në Dibër të Madhe lidhte kokrra kafe Moka, që ka ardhë nga Qabeja, në fund të dynjasë, pse të mos lidhte kokrra në katund tem portokalli, që ka ardhë nga Himara jonë, te dera e shtëpisë?! Ku Meka e Qabeja e harruar e ku Himara e bekuar! A po më kupton?»

Shoferi e besoi dhe e kuptoi Sulltan Muratin dhe iku i lumtur, duke i uruar: «Paç fat e të priftë e mbëra!»

— Kështu ka ndodhur, o dashamirë! — e përfundoi tregimin mësuesi i biologjisë. — Në

daçi besoni, në daç mos besoni, punë për ju, por,
 po të doni, qëndroni sot këtu, bora s'po pushon,
 dhe vemi sonte te Sulltan Murati, të shikoni si
 e mbron, si djalnin e vetëm, pemën e re të por-
 tokallit me lule plot në dhomën e madhe të miq-
 ve. Do ngopeni aromë, portokalli (si në Himarë,
 kur zien dhe buit bleta).

Ndërkohë erdhi një makinë nga Kukësi. Mo-
 rëm vesh që rruga që hapur dhe u ndamë me
 mësuesin jabanxhi të biologjisë, që kish mik
 Sulltan Muratin, të zotin e portokallit të vetëm
 të Alpeve, që nuk patëm fat as kohë ta njihnim.

Gusht 1989

Heshtja e gjatë sa një shekull

Kishim dhjetë vjet pa u parë. Vendi ynë është i vogël dhe duket ca e pabesueshme që dhjetë vjet të tërë të mos mundesh të takohesh me një mikun tënd. Kështu është vërtet, por dhe ajo që sapo thashë është po kaq e vërtetë. Dhjetë vjet. Me siguri një ndarje si kjo e stërgjatë mund të ndodhë shpesh me të tjerë, po mua më ka qëlluar rrallë.

Na kish marrë malli.

Ishim njohur me ustanë kur montonim kompresorët e hidrogjenizimit të naftës në B. Unë bëja punën prodhuese, kurse ai drejtonte montimin. Kur më paraqitën te brigadieri im i ardhshëm, u habita dhe disi u hutova. Prisja që ai të qe më i moçëm se unë. Zakonisht ata që më parë u dëgjojmë namin sesa fjalën e tyre, gjith-

një i përfytyrojmë më të mocëm se veten. Jo. Ai ishte i ri, më pak se tridhjetë vjeç. Por në jetë s'të bën të vlefshëm mosha, por mendja. Brigadieri, ustai për të cilin të gjithë përgjërroheshin, qeshi me hutimin, tim dhe tha një nga frazat më standarde në kësi rastesh: «Gëzohem që u njohëm».

Më vonë do gëzohesha unë më shumë për njohjen me të. Fjalët i tha me turp të madh, thua se ishte vajzë që e martonin me mblesëri. Për induksion dhe unë u skuqa disi dhe pësova një farë druajtjeje. Na nxori nga situata drejtori i kuadrit të uzinës, kur tha:

— Usta, më siguri ky është shkrimtari i parë punëtor i brigadës sate.

Tjetri heshti. M'u duk sikur kështu, me heshtjen e tij, donte të thoshte: «Shkrimtar mbase është! Kushedi! Por punëtor? Prit ta shohim njëherë!»

Drejtori i kuadrit iku, unë mbeta më ustanë në skelat metalike të sallës së kompresorëve. Poshhtë këmbëve tona, nën zgarën e hekurt, në shesh ku punonin njerëzit, drejtori i kuadrit më dikë po bisedonte, kurse lart, mbi kokat tona, tek hapet në pambërim qielli dhe të verbonte dielli, zogjtë uleshin mbi tymtarët e ardhshëm të uzinës të bënin foletë.

Shokët e brigadës e thërrisnin usta Toni. Mua herë më tingëllonte si «ustai tönë» e herë si «Tomi» dhe dikë mëndova se quhej Tomorr. Shkurt Tomi. Firmat e huaja ku kishim blerë makineritë, kishin dërguar specialistët e tyre. Inxhinierët e Lindjes e thërritnin «Shokuntun», perëndimorët «maestro». Ofiqin e të parëve nuk

e kuptoja, por ma donte mendja që, me siguri, duhej të ishte ndonjë titull a gradë profesionale. Por, meqë në gjuhën e tyre nuk dija asnjë fjalë nuk e vrava mendjen ta mësoja as këtë. Mund të pyesja përkthyesin, por ai ishte i zënë gjithnjë me punë me ta dhe as në fjetore dhe as në mensën tonë nuk vinte. Ai hante pilaf e pinte çaj tok me burrat e imët të Orientit, flokëzes si furçë këpuçësh e hundëvegjël si kalamajtë. Ankohej se që i zënë me punë shumë, së dhe në dreka e darka u duhej miqve për të përkthyer menynë e restorantit dhe për shërbimet e kamerierëve. Fitimi i vetëm që paskësh pasur ishte që po bëhej kampion i rrethit për pingpong. Se, sa për pingpong dhe çaj, lindorët ishin absolutë.

Ndërkaq paracuklin «maestro» s'kishte nevojë të na i përkthente njeri. Të gjithë e kuptonim. Me siguri e thërrisnin kështu ngaqë ustai im ishte artist në punën e vet. Nga Singapori e deri në Kanadë na dukej se s'mund të kishte një usta kaq të saktë dhe kaq të shkathët në vendosjen në aks të kompresorëve, sa brigadieri ynë. Këtë e thoshin të huajt, jo unë. Dhe, që ta dini ju, kompresorët tanë, kur montoheshin, një hile të vetme zanati kishin: të qenë në aks absolutisht. Veç kjo hile matej me saktësinë e mikronit. Brigadieri ynë i vendoste si fëmijët në djep, i siguronte mirë e bukur dhe i bënte gati për punë, ndërsa të huajt vinin e kontrollonin me teodolit. Lindorët në fillim përdornin dhe lehtë të cigareje për të provuar rrafshin e mbështetjes së kompresorit mbi trupin tjetër, por, meqë ajo s'kalonte kurrë nëpër të, vetëm i rrihnin shpatullat lehtë dhe, të përmbajtur, përsëritnin

gjithnjë: «Shukontun»! Perëndimorët në këtë rast hiqnin syrin nga teodoliti, ngrinin papritmas duart në qiell dhe thërrisnin fort: «O. Zot, e pabesueshme!» Dhe veç njëri nga perëndimorët briti njëherë: «Magjistar!» Dhe atëherë mua më shkoi mendja që lindorëve, si aziatikë që ishin, patjetër u kish vajtur mendja më shpejt që at ishte magjistar i montimeve. Ndaj «Shukontun» në gjuhën e tyre do të qe magjistar! Patjetër!

Dhe, ç'është e vërteta, dhe neve, brigadës sonë, na shkonte ndonjëherë mendja se ai kishte diçka prej magjistari. Sidomos kur hiqte «nivelën e ujit» dhe nxirrte nga profili një fije floku të verdhë që e provonte në rrafshin ku lindorët përpiqeshin të futnin kot së koti letrën e cigares.

Asnjë nuk e dinte nga ç'tufë flokësh ishte ajo «qime Pejgamberi», siç thoshin montatorët shkodranë, por, që mund të qe e Premtinës, shoqes sonë të vetme të brigadës, që ishte gjithnjë e dalldisur pas tij, kjo shihej lehtë. Ajo fije floku qe e verdhë si një fije mëndafshi, e drejtë si një rreze drite. Edhe Premtina flokët i kishte kështu, të verdhë, të verdhë këdaife!

Vonë e mora vesh që ishte fije nga tufa e flokëve të vajzës së vogël të ustait. Fëmijët i paskan flokët më të hollë se letra e cigares. Këtë sekret profesional e mësova vonë. Tepër vonë.

Ditët e para të njohjes me të ofiqi «maestro» të bënte të dyshoje se mos ustai ishte i zoti edhe në ndonjë instrument muzikor që unë nuk e dija. Ca më tepër ky dyshim m'u forcua kur mësova prej tij se qe bir nga Leskoviku. Të jesh leskoviçar dhe të mos u biesh sazeve është ca e vështirë, në mos e pamundur. Kam thënë dikur

..njëherë që Leskoviku është një nga kryeqytetet e këngës apo të sazeve, nuk më kujtohet. Por një lloj është. Po the Leskovik, ke thënë muzikë.

E pyeta një ditë se ç'instrumenti i binte tamburasë apo buzukut. Për violinë nuk më shkonte mendja, se ai i kishte gishtat si arra, gjithë gunga, aq sa gjithnjë lëmimin e metalëve e provonte me faqe e jo me shputën e dorës. Paçka se nën duart e tij këndonin të gjitha llojet e çeliqueve. Ai është nga ata njerëz që ç'u sheh syri, u bën dora dhe që duart gjithnjë u hanë për punë. Zakonisht këta lloj njerëzish janë ata që dinë të bëjnë vetëm një temena, atë të punës.

E pyeta, pra, për instrumentin muzikor, dhe ai qeshi sikur t'i vinte keq për mua që rrekeshja e mundohesha për kaq gjë.

— As tamburasë e as buzukut. Asnjë lloj. Unë jam nga Vercka, — m'u përgjigj si mëkatar i madh a fajtor, që nuk përlligjte dot dëshirën time.

— E çfarë se je nga Vercka! — u zemërova unë. — Prapë leskoviçar je!

— Ashtu është, po ne në Verckë merremi më shumë me tokën dhe drurët. Për pemë dhe rrush na vjen ndoresh. Për saze s'para na jepet.

Nuk thonë kot fshat e zanat. Ishte e qartë që perëndimorët e thërrisnin «maestro» për zotërinë e tij në montim. Kot e vrisja mendjen për të tjerat. Dhe, përsa i përket montimit, nuk ia hante qeni shkopin. Paçka se burrë i moçëm, unë fillova të mburresha me ustanë tim para shokëve të tjerë nëpunës që bënin punën prodhuese në uzinë. Gati si çunat e vegjël, që lëvdohen mbi të gjitha me «babi im». Kurse shokët e mi nuk

i hante merakun për brigadierët e tyre. Një muaj hesapi, sidoqoftë, do ta shtynin.

Gjatë dhjetë vjetëve që nuk u hasëm, më qëllloi të veja në vendlindjen e tij, në Verckë. Fshat i vogël, që s'kishte për ta njohur kush sikur të mos kishte dafinën e madhe si lis, të sjellë nga Kostandinopoja dhe rrushin e rralë. Vercka ka kopshtarë nga më të mirët e Ballkanit, që deri në Izmir u ka dalë nami. Kish të drejtë ustai im.

Pyeta më vonë disa herë për të, për ustanë tim; kuptohet, me rast. Prisja e përcillja herë pas here të falat për të. Diku më thoshin se është në Metalurgjik; e kërkoja atje, më thoshin në Azotik, pyesja aty, më dërgonin në TEC, e prisja në Fier, më dilte që ishte në Bushtricë; pyesja në hekurudhë, më thoshin se montonte turbinën në hidrocentral. Ustai im ishte bërë vërtetë magjistar: nuk kapej dot. Dhe themi pastaj që jemi vend i vogël!

Dhe ja, papritur, pas kaq vitesh, tashmë kur ai është thinjur e unë gjysh, takohemi përsëri në B. Tani monton uzinën e vajrave lubrikante. Nuk e thërret më njëri as «Shukontun» e as «maestro». Punëtorët e brigadës e thërresin: «ustai ynë», ndërsa përgjegjësit e sektorëve, shefat dhe drejtorët i drejtohen me «shoku Anton». Dhe tani besoj se dhe ju e morët vesh dhe e lidhni atë emrin e çuditshëm «Shukontun» të lindorëve me vetë këtë, të urtin shoku Anton. Nofka e mësipërme që një keqshqipëtim që i bënin emrit të tij lindorët.

Para dhjetë vjetësh, ato ditët e njohjes sime me të, unë mburresha para kolegëve punëpro-

dhuesbërës me ustanë tim. Ata mërzitëshin e nevrikoseshin me mua për këtë, aq sa, në inat e sipër, njëri prej tyre më tha: «A, ç'na çan këkën me të! Sikur e ke vëlla?! Po në e paç vëlla, dobiç do të jetë, se ka mbiemër tjetër!» Kolegu im ishte i shkathët nga goja. S'hahesha dot për llafë me të. Por s'thonë kot që llafet e shumta janë fukarallëk, se edhe atë llafet e tepërta e morën më qafë. Më vonë ai punoi punëtor tamam në brigadën e Antonit dhe, megjithëse përpiquej të ndërronte zakon, goja vazhdonte t'i punonte më shpejt se mendja. Një gjë e tha të saktë më vonë: «Antoni? Hak ustai!»

*
* *
*

Ato ditë që punonim në B., më të rëndat ishin ndërresat e natës. Unë s'kisha pse punoja natën, nuk më detyronte njeri, por, meqë s'jam tamam nga ata që e hanë turpin me bukë, më tepër nga halli se nga malli, dhe meqë brigada punonte me orar të zgjatur, bashkohesha dhe unë me shokët në ndërresat e natës. Por këtë e bëja më shumë për hir të Antonit.

Natën qyteza B. e montatorëve, gjithë drita projektorësh dhe fishekzjarre saldatrësh, dukej si panair i madh ndërkombëtar, por më saktë ngjante me atë që e përcaktoi drejt Ndoci i brigadës shkodrane të montimit: si një fshat olimpiq. Sapo ishin bërë lojërat olimpike të Monrealit dhe ky epitë zuri vend më shumë për B. Në këtë fshat olimpiq kryeplak qe ustai im Anton Kapetani.

Natën atje drita kishte shumë, por dhe të ftohtët që i madh. E kam provuar të ftohtët në shumë lloje e forma, por e ftohta e acartë e metalit shkon deri aty sa të djeg, të rrjep gishtërinjtë e të shkul thonjtë. Nuk isha përgatitur për një akullim të tillë dhe dorashka s'kisha. Natën e parë duart m'u bënë plägë. Të dytën, kur m'i pa Antoni, më shau rëndë. Ç'tuhaf isha që punoja pa doreza! Hoqi të tijat, m'i hodhi mbi cilindrin e kompresorit. «Merri!» më urdhëroi prerë. Unë i futa duart në xhepa, kurse dorezat prej lëkure të zezë dukeshin si duar negrish të prera, që përpiqeshin të kapeshin fort pas metalit të ndritshëm të kompresorit. U zemërua Antoni keq me mendjemadhësinë apo mëdyshjen time të dyshimit. Thirri fort: «Tjetër herë mos shit mendje! S'kemi nevojë për therore intelektualësh këtu!»

Unë nuk shitja ment, por më vinte rëndë që ai, zoti i punës, që nuk i pushonte dora kurrë, të mbetej pa doreza, kurse unë, vrima e fundit e kavallit të brigadës, të tundesha me to. Kjo që e gjitha dhe jo shpirti im i sakrificës. Budallallëqe! Doreza vërtet nuk kisha, por dija dhe unë se ç'është më mirë, me to apo pa to. Kisha dhe sedër më tepër se ç'kam sot, dhe as lypja dot te të tjerët dhe as lëmoshë nuk pranoja dot.

— Mendja e madhe, e zezë e të zot, — tha Ndoci i brigadës shkodrane, kur mori vesh pse ishte zemëruar ashtu brigadieri me mua.

Kur thërriste dhe kur qeshte fort, si çdonjeri në kësi rastesh Antonit, i dukej kurora e dhëmbëve. Në të vërtetë, duhej t'i dukej kurora e bardhë, por në vend të dhëmbëve, anash, the-

llë, i dilnin mishrat e zbrazët. I mungonin disa dhëmbë.

Brigada jonë kërkonte e ngulmonte, sa herë hanim drekën në mensë, që ai të shkonte te dentisti si gjithë bota. Ai vërtet ishte Anton Kapetani, por kapetan dhëmbërarë nuk hahej fare. S'ishte puna thjesht për shaka, që ustai, kapetani ynë, kritikohej përditë për këtë, por na vinte disi inat që më i miri i brigadierëve të montimit, që e kishin zili gjithë brigadat, për bukurinë e dhëmbëve ishte i fundit. Më shumë nga të gjithë ne, mua më dukej se vuante Premtina, shoqja jonë e vetme e brigadës. Antoni sikur na i bënte për inat, s'hante pykë fare. E kishte përgjigjen në majë të gjuhës: «Nuk çalon njeriu nga dhëmbët!» «Jo njeriu, por...» shtonim ne, por s'na linte të vazhdonim më tej dhe e mbyllte shpejt, me kapak të fortë bisedën: «Kush lakmon shumë, mbytet në lumë. Llafet e shumta janë fakarallëk!»

Asnjë nga ne nuk pajtohej me të në këto raste, por heshtnim, se për kursim fjalësh ai qe i paarritshëm. Sikur ta paguaje për sa fjalë fliste në ditë, ai do të qe më i varfri njeri i «fshatit olimpik».

Për t'i bërë qejfin ndonjërit prej nesh, sidomos Premtinës, në ditët kur puna na kish ecur sahat e nuk kishte si zemërohej dot me këmbënguljen tonë, ai na lëshonte si për zemërgjerësi kapetanësh: «Sa të mbarojmë montimin, pa do të vete, se s'bën, t'i ndreq dhëmbët!»

— Mirë që s'thua: do të vete të montoj dhëmbët, — qeshte Premtina në këto raste fort të rralla.

Kujtova dhëmbët e tij, së ja, dhe tani pas dhjetë vjetësh e shoh tek qesh i gëzuar që më në fund u takuam, e përsëri në kamaren e gojës, anash, i duken mishrat e fortë si eshkë e gurtë, pa dhëmbë. Gjerdani i zajeve, nën buzët e mbushura, vazhdon të jetë i këputur si dikur. Dhe më shkon mendja që përsëri s'paska pasur kohë për to. M'u kujtua përgjigjja e tij: «Ja, sa të mbarojmë montimin...» Por montimet pa të s'bëjnë dot. Ato s'mbarojnë kurrë dhe ai pa to s'jeton dot, kurse pa dhëmballët jetoka...

Kështu janë mbrujtur ca njerëz. Nuk sajoj e as zbukuroj gjë. Gjithnjë për vete s'kanë kohë asnjëherë, dhe kanë një jetë kohë për punën. Harrohen pas saj, aq sa dhe puna mësohet aq shumë me ta, sa, kur nuk i ka pranë, habitet, hutohet, çoroditet, çakordohet. Këta janë «qenët e punës», siç thoshte Ndoci prej Shkodre.

Aherë montonim kompresorët e mëdhenj gjermanë, tashti Antoni monton disa gjigantë të tjerë.

Kur unë pata filluar punën prodhuese në B., shokët e Antonit prisnin dekorimin e tij. E kishin propozuar për një urdhër të lartë dhe shkodranët e kishin zili brigadën tonë për ahengun që, me siguri, do të bënim me këtë rast.

Por aty nga mesi i javës së dytë të punës sime në ndërresat e natës, tek hanim bukë në mensë, nuk kujtohej më kurrkush për dhëmbët

e tij. As vetë Premtina. Mua më pëlqeu serioziteti i shokëve të mi të rinj dhe nuk e vrisja mendjen se nga erdhi papritur ky seriozitet e zymtësi.

Ndoci, që qe për të nxjerrë sytë, më tha tek pinim kafën e termosit të Premtinës:

— Ju ka ra zija! S'keni faj, ju ka plasë anonimati i madh!

— Ç'anonimat? — pyeta unë i habitur.

— Letrat anonime, pra!

— Ç'letra anonime? — u befasova unë.

— Au, ti qenke në fund të botës. Kur lind dashnia, eof lavdia, — tha ai, tundi dorën dhe s'ma vari trastën.

Hej, bela. U intrigova prej Ndocit dhe më hyri krimbi: «Ç'letra anonime kanë plasur te ne?»

Desha të pyesja shokët e brigadës, por më erdhi zor, nuk kisha ende aq intimitet sa të bisedoja me ta për gjëra delikate. Intuita e nëpunësit më thoshte që letrat anonime, për të cilat Ndoci më tha se kishin plasur sheshit, duhej të ishin për gjëra delikate, që kishin të bënin me brigadierin tonë. Ca më tepër, të zotën e punëve nuk e pyesja dot kurrë, se do të më dukej vetja si ajo kurva që krihej, kur fshati digjej.

Pyeta drejtorin e kuadrit, që më kish çuar te brigada e montimit. E kisha të njohur të vjetër, dikur kishim punuar në një dikaster. Më sqaroi që vërtet para disa muajsh ishte bërë propozimi për dekorimin e Antonit. Por propozimi nuk do të kalonte në Kuvend Popullor, pa u sqaruar marrëdhëniet e tij me atë vajzën, si e quajnë, të premtuarën e tij. «Premtina»,

thashë unë. «E, ajo premtion shumë, me sa duket!» «Shpifjel!» thira unë. «S'ka tym pa zjarr», tha ai. Kujdes!»

Megjithëse brigada jonë heshtte për letrat që gjendeshin në kuadër dhe megjithëse vetëm Antoni mbase nuk dinte gjë për to, se Premtina për çudi iku me leje (logjika elementare të thoshte që ajo largohej nga sherri), prapëseprapë të gjithë flasin për to dhe për origjinën e tyre.

Disa thoshin se letrat anonime i kishin ysh-tur specialistët perëndimorë, se Antoni paska vlerësuar më shumë punën e lindorëve. Specialistët lindorë, thoshin të tjerë, qenkan shkaktarët e letrave anonime, sepse Antoni paska çmuar më shumë makineritë e tyre sesa ato lindoret.

Llafe! Me siguri as lindorët as perëndimorët s'dinin gjë fare për letrat anonime. Ca thoshin se letrat i ka bërë Premtina vetë se ka kaq kohë që e dashuron Antonin, por ai e refuzon. Pra, ia ka bërë nga inati. Të tjerë thoshin se i ka bërë e shoqja nga xhelozia për Premtinën. Më të guximshmit thoshin se i paska bërë vetë drejtori i kuadrit, nga zilia që Antoni, një copë punëtor, dëgjohej më shumë se ai, goxha drejtor! Isha i sigurt që drejtori nuk i kish bërë letrat anonime, e njihja, thashë më parë, prej kohësh. Por e dija që nuk përbuzte gënjeshtarët dhe servilët. «Ruaju nga të paaftët, se për çështje anonime ata të bëjnë gjëmën!» — më tha një tjetër, jo Ndoci, se atij më shumë i qeshej sesa e merrte seriozisht këtë. «Janë ditët e shpifësve dhe jo të shpikësve», siç më sqaroi më vonë ai. Por kjo qe një fatkeqësi për Antonin. Për çudinë time, ai ose ishte tuhaf absolut, ose hiqej si anglez i

thekur. Nga brigada jonë vetëm ai nuk shqetësohej dhe vetëm atë nuk e shtypte dot akoma thashethemnaja...

— Çudi, vërtet! — thotë Antoni, si jemi rrahur krahësh e përçafuar fort. — Hajde, xhan i vëllait, gjeje po deshe në libra: dhjetë vjet pa parë si në luftërat botërore!

— Të kam kërkuar shpesh, — shfajësohem unë.

— E di, — përgjigjet ai. — Edhe ne të kemi kërkuar, edhe urimet për Vitin e Ri i kemi marrë. Po ti tonat a i ke marrë?

Ai shprehet «urimet tona», se gjithnjë më uron në emër të brigadës dhe në emër të familjes. Brigadat që ka ndërruar gjatë këtyre viteve, nuk ia njoh. Fëmijët nuk ia kam parë, kurse gruan e tij vetëm një herë, por nuk e harroj dot.

... Po kthehesha në Tiranë pas tri javësh të punës prodhuese. Ishte e shtunë pasdreke dhe e pata kollaj të gjeja makinë për në kryeqytet. Ekipet e të gjitha llojeve që shkojnë me shërbim në bazë, të shtunave, zakonisht, mbarojnë punë. Dhe ato ditë në B. ekiye kishte shumë, bile qenë shtuar mjaft. Ishte viti i mbarimit të veprës dhe kishte halle. I thashë Antonit që po ikja (më kish marrë malli për kalamajtë) dhe se të hënën do të vonohesha, por do të punoja në ndërresën e dytë.

Sytë e pikëlluar të ustait qeshën. M'u duk sikur me shikimin po më përgëzonte punëdashjen. Punëprodhuesbërës s'kishte pasur më korrekt se unë. Le të merrnin dhe të tjerë shembull. Por gjatë udhëtimit atë shkëndijën verbuese të syve të tij fillova ta trajtoja si një shikim ironik të tij. Domethënë: dhe ti po ikën si Premtina, me leje? Ke frikë se mos molepsesh nga unë? Jo! Ikni, zogj shtegtarë, se erdhi dimri!

— Udhë mbarë! Të fala! — më uroi Antoni. Dhe pas një mëdyshjeje të vocërr, që zgjati vetëm disa të dhjetat e sekondës, shtoi si me lutje: — Dëgjo, po ndaluar të pini kafën në «Turizëm», shkëputu një minutë nga shokët dhe shko e kërkko time shoqe në spital.

— Është e shtruar, e sëmure, — u shqetësua unë. Dhe këtë kishte mangët ustai im!

— Jo, — tha i qetë. — Është në maternitet.

— Punon atje infermiere? — pyeta i lehtësuar unë.

— Jo, — tha përsëri ai. — Më telefonuan sot gjitonët. E kanë çuar mbrëmë të lindë.

— Ou! — u hutova unë. — Po hajde dhe ti me ne. Ç'pret?

— Do të vete kur të lindë. S'është fëmija e parë, — tha ai. — E kam grua të fortë. Ma di dhe ma qan hallin. Të mbarojmë sot a nesër dhe sallën e kompresorëve dhe vajta!

— Nuk e ke mirë, — thashë unë i zemëruar. — puna-punë, por dhe familja-familje. Le që tani... — por nuk vazhdova. Kuptohet që për pak desh bëra proçkën në mes të sheshit dhe të njerëzve, duke i kujtuar letrat anonime. Domethënë diçka po filloja të kuptoja dhe të besoja.

— Çfarë tani? — pyeti Antoni. — Nuk është fëmija e parë, të thashë. Dhe herët e tjera gjitonët e kanë ndihmuar. Ata e futin në maternitet, unë e nxjerr. Vete e rënduar, del e çliruar dhe me foshnjë në gji. Gjitonët i kam të gjendur, vëllezër e shkUAR vëllezërve. Njerëz për së mbari.

— Ç'ka të bëjë kjo? — u nxeha unë. Nuk më pëlqeu ajo, që gjitonët i kishte për së mbari, kurse ne të tjerët qenkëshim për ters. — Qofshin fqinjët dhe vëllezërit më të mirë, edhe sikur fëmija i pestë të jetë, ti prapë duhet të jesh pranë saj. Atje është vendi yt sot.

— Fëmija është i shtati, — tha si i zënë në gabim Anton Kapetani, — kurse vendi im sot është këtu.

— Të të rrojë! — e urova unë, duke pasur frikë ta ngacmoja më tej.

— Bashkë me të tutë. Faleminderit! Pra, do të shkosh ta takosh? — pyeti rishtazi ai.

— Patjetër!

— Mirë, xhan i vëllait, të paça! Por po të bëj havale diçka... — Dhe futi dorën në xhep. Prisja të nxirrte ndonjë letër a pusullë urimi për gruan, kur ai nxori një shuk me të holla dhe m'i ngjeshi në dorë.

— Bliji ç'të mundësh, si për gruan tënde. Se njësoj janë të gjitha gratë. Veç mos harro mollët! I do shumë, shejtanka. E di mirë unë.

I shtyva dorën. S'pranova t'ia merrja paratë. Ai u skuq. Unë e sqarova:

— Do ta uroj në emër të brigadës. Na takon neve.

— Brigada-brigadë. Po gruaja është grua,

xhan i vëllait, — dhe u përpoq prapë të më linte paratë në dorë.

— Mos na turpëro, se ndryshe nuk shkoj fare, — thashë unë.

Me mundim e binda. Nuk kishte kohë të bënim pazar. Kishte mbërritur vetura e ekipit të dikasterit që do të më çonte në Tiranë. U ndamë.

— Shëndet e të fala! — uroi Antoni.

— Gjithë të mirat! — ia ktheva unë. — Dhe mos ki merak... (Dreqi e mori, m'u kujtuan letrat anonime përsëri).

— Ç'merak të kem, — tha ai, — këtij fëmijës që po vjen, i doli fati i mbarë. Do të ketë kumbar një shkrimtar. Gjeji ndonjë emër të bukur!

Çudi me të! A thua atij nuk i shkonte fare mendja për letrat anonime! Megjithëse sot nuk kishte pse t'i shkonte, priste fëmijën tjetër.

Udhëtonim. Vetura që e re dhe parakalonte njërën pas tjetrës makinat. Nxitonim për në Tiranë. Ishtë fund jave. Shoferi, si u prezantua e u njohëm me njëri-tjetrin, më pyeti për kumbarllëkun që më propozoi Antoni. Ia shpjegova dhe i tregova se atij ustait atje në B. pbi lindte gruaja fëmijën e shtatë dhe më dërgoi mua si ambasador të interesohem për fatin e lehonës.

— Mashallah! I lumtë! — tha shoferi, me sa duket, për kujdesin që tregonte brigadieri ynë për të shoqen, se nuk besoj që shoferi të habitej për numrin e fëmijëve. Megjithëse ku i dihej.

— Po! — tha përgjegjësi i ekipit me një «o» të zgjatur si bori makine. — Ka dhe të tillë. Hiqen si punëdashës të mëdhenj, sa gjoja harrojnë dhe gratë...

— Unë s'thashë se harroi gruan. Përkundrazi, — ndërhyra i nxituar unë.

— E di. E di mirë! — nguli këmbë mendueshëm përgjegjësi i ekipit në ndenjësën e parë.

— Ai s'harron dot detyrën, — tha shoferi. — Apo jo?

Nuk mori përgjigje. U bë një heshtje e gjatë dhe e bezdisshme, e gjatë sa një shekull. Përgjegjësi, që me siguri dinte mirë mbase gjithçka për letrat anonime, nuk foli më, kurse pasagjeri tjetër, në krahun tim, që s'kish thënë gjë deri atëherë, nuk foli kurrë. Shoferi mori inat me heshtjen tonë dhe filloi t'i merrte kthesat me rrembim, sa kishte rrezik të na zinte makina.

Por duhet thënë që përgjegjësi nuk harroi dhe nderin ma bëri: në Fier e ndaloi makinën te «Turizmi» për të pirë kafën dhe porositë shoferin të më çonte në maternitet. Rrugës shoferi më tha që përgjegjësi nuk ishte burrë i keq, por nuk besonte njeri. Bleva mollët dhe verën për lehonën. Kisha dëgjuar që birra shton qumështin e gjirit te nënat kur lindin. Kërkova birrë, por nuk gjeta. «Në fund të fundit, njëlloj është — më ngushëlloi shoferi. — Ç'bëri birra, ç'bëri vera. Ujë është, jo raki.»

Para maternitetit bëhej pazar i madh burrash, të rinjsh e nënash plaka. Të gjithë kërkonin nusët e bijat e tyre. Si gjithë të tjerët, thirra dhe unë dhe në një nga dritaret e katit të dytë u shfaq e shoqja e Antonit. Flokët e verdhë, kurorë, si të Premtinës. Nusja e Antonit që e bardhë si bora. Përsëri kish lindur vajzë. E urova nga zemra dhe nga e gjithë brigada. Kupto-

het që, së pari, nga brigadieri i saj. Qeshi e lumtur. Dhe mezi e dëgjova tek tha:

— Sa merak që ka, i shkreti!

Mollët dhe shishen e verës «Merlot» e futa në një rrjetë, që ma lëshuan nga dritarja tjetër, përbri katit të dytë. Mollët ngriheshin lart si me kovë pusi. Ato ngjanin si tullumbace të vogla që ngjiteshin qiellit. Të kuqe sa të verbonin, «Starking» Korçe tamam!

— Faleminderit, — thanë disa zëra grash, që ishin bërë tashmë nëna. Dhe zëri i gruas së Antonit u shkri midis tyre.

— Kujdes verën! — thirra unë nga poshtë.

— Ne jemi dehur edhe pa verë, — ma ktheu një nuse e re nga lart.

Isha i sigurt që ajo e dehura pa verë kish lindur fëmijën e parë. T'i rrojë!

Kjo qe e gjitha. Dhe as gruan e Antonit nuk e pashë më dhe as vetë atë, nikoqirin e saj. Dhjetë vjet.

Dhe ja tani, tok me shokët që na shoqërojnë, jam takuar me ustanë tim të para dhjetë vjetëve. Kujtoj fëmijët e tij dhe vajzën për të cilën duhej të isha bërë kumbar, po s'u bëra.

— Sa t'u bënë, Anton? — e pyet drejtori i sektorit. Jo ai i dikurshmi i kuadrit.

— Nja dhjetë, — ia kthen me turp ustai.

— Me siguri, e zbulove djalin më në fund, — e ngas unë.

— Dy, të pasmit fare, i kam djem, — thotë ai i kënaqur. — I duruari, i fituari. Të mira shumë janë vajzat, sidomos për nënat. Po për zanatin tim nuk bëjnë. Vajzat montatore martohen e të lënë shëndetin, si Premtina, të kujtohet? (Edhe pyet, mendoj unë.) S'kanë faj, zanat i rëndë për grua. Kurse unë tani kam kujt t'i mësoj sekretin. Kushedi ç'fat të madh do të kenë djemtë nesër. E mendon, xhan i vëllaït, kur të fillojnë ata, çunat e mi të montojnë, Shqipëria do të jetë patjetër vend hak i industrisë. Kur fillova unë punën, ishim akoma vend agrar. Ne e bëmë agrar-industrial apo industrial-agrar, ti i di më mirë këto, kurse ata do ta bëjnë top, industrial!

S'më kish vajtur mendja kurrë që etapat e zhvillimit të Shqipërisë t'i lidhja me zanatin e fëmijëve. Besoj se as juve nuk ju shkon mendja. Kurse Antonit i shkon.

— Vemi të pimë një kafe, — propozon drejtori i sektorit.

— Me bisht, — thotë njëri nga shokët që na shoqëroi.

— Pa bisht, — qesh Antoni. — Por me kokë!

Në klub takojmë ca djem të rinj, kuqo të nxirë, që ngrihen në këmbë. Më bëhet qejfi, kujtoj se më njohën mua ose drejtorin, e shumta. Jo! Ata i ngrihen në këmbë usta Antonit. Takohet me ta, si me miq të vjetër. Dëgjoj: «Ku jeni, ujqit e Moravës», thotë Antoni. «Këtu, or t'u mbylltë», thotë njëri nga djemtë. Ata qenkan kombajneristë.

— Usta, u bënë dy ditë që kemi ardhur nga Korça, — thotë ai që uron «t'u mbylltë».

— Ju lumshin këmbët! — përgjigjet Antoni.

— Dy ditë, bre usta, por s'na japin sipërfaqen që duhet të korrin. Presim e presim kot fare. Na hanë duart. Dietë marrim, rrogën po, kafën na e japin, se, helbete, kemi ardhur nga Korça për ndihmë. Miq të nderuar, hesapi. Por sipërfaqen, që t'i përvishemi grurit, s'na e japin!

— Kush nuk jua jep! — pyet i ngutur dhe i shqetësuar drejtori i sektorit.

— Komiteti ekzekutiv, — thotë i sigurt njëri nga traktoristët që quhen kombajneristë.

— Kush, kush në komitet ekzekutiv? Se, poetë jetë vetëm kaq sa thua, kjo është vetëm një fjalë goje, si çdo fjalë «komitet» dhe kaq! — interesohet Antoni.

Korçarët përmendin emrat e disave, me të cilët janë takuar e te të cilët janë ankuar.

— S'na mbetet gjë tjetër, veç të shkruajmë letra lart. — thotë dikush nga traktoristët.

«Letra. Përsëri letra», mendova unë.

— Mirë, mirë, — thotë Antoni. — Sonte bëhuni gati. Lërini letrat, se s'japim bukë ato. Dritat i keni gati për natën? Mprihini mirë dhembët, se do të ngopeni mirë.

Po ky njeri ku e gjente kurajën të angazhohet kështu para korçarëve?! Këtu ishte drejtori i ri dhe nuk fliste. Ishte çështje bujqësie dhe jo industrie kjo e miqve korçarë.

— Faleminderit, usta! Ta paçim borxh! — thonë ata. Duku prapë andejza nga ne.

— Do të dukem, — thotë Antoni. — Patjetër. Kur të zgjeroni kombinatin e sheqerit.

Kafja erdhi. Nuk e kuptova, drejtori apo Antoni e porositi. Asnjëri. Refleks profesional i kamerierit, po nderi duhej t'i bëhej drejtorit.

—Vulëhumburit! Burokratët e qyqes! Po ku pret gruri dot, xhan i vëllait. Ai është si grua-ja kur bëhet lehonë, — tha Antoni dhe u ngrit e mori telefonin te banaku i hotelit. Ç'bisedon, nuk dëgjohet. Banaku është në holl. Duket që i kërkon llogari dikujt. Me ç'të drejtë, cili është ai që duhet t'i japin llogari të tjerët? Kthehet. I ka ikur inati.

— U zgjidh dhe ky hall, djema! — thotë ai. Dhe nuk merret vesh kujt i drejtohet, neve apo traktoristëve korçarë, që pinë kafen bri nesh dhe u hanë duart për punë.

— Me bereqet sonte!

* * *

Dhe ja, u çmallëm dhe ndahemi me Antonin! Premtojmë që do të piqemi prapë. Mbase jo pas një ndarjeje kaq të gjatë, jo dhjetë vjet pa u parë!

— Dil nga Tirana një herë. Hajde të më takosh, të paktën kur të kesh ndonjë hall, — i them unë tek rrokemi për t'u ndarë.

— Ç'hall kam unë? — çuditet ai. — Jam i ri akoma! Por do të vij kur të kesh ndonjë sihariq a sebeb ti.

Dhe unë ia kthej monedhën nga ana tjetër.

— Ç'sebeb të kem unë! Jam tani në një mosshë kur fillojnë hallet.

— Jo, bre! — thërret Antoni. — Mos bre! Se nuk është koha të mendojmë pleqërinë. Shëndet e mirupafshim!

— Mirë ardhsh, usta!

* * *

Dhe u ndamë. Ai atje në montim dhe unë këtu në çmontimin e kujtimeve të mia.

Po Premtina? Ç'u bë me të? Po letrat anonime? Ahu, Premtina! Ajo u martua me Ndocin, hokatarin nga Shkodra. Këtë ma tha vetë i zoti, Ndoci, kur u takuam një herë tërvit në Koman, e më ftoi në Shkodër për krap tave. E qan me lot burrnesha ime! Bujrum!

Shtator 1987

Mos e zgjidhni atë!

A mund të turpërohet njeriu e të zbulohet thelbi i tij për një ditë, për një orë? Pak e vështirë, por ndodh. Njeriu nuk është si pema e fikut, aq e bukur në behar, hijeshumë dhe kokrraplot, që, kur mbaron vjeshta e afron dimri, i lëshon përdhe gjethet këmbëpata dhe shëmtohet tej e tej e degët e zhveshura duken si kryqe varrezash të harruara. Jo! Njeriu s'është i tillë, por megjithatë jorrallë ngjan kështu.

Po bëheshin zgjedhjet në institut dhe ai ishte kandidati kryesor. U vu në votë dhe, si nga herë, u shtrua pyetja: «A ka vërejtje?» Ishte një procedurë si për të gjithë dhe do të kalonte si për të gjithë. Nuk pritej të kishte kundërshtime. Dhe atë çast u ngrit shoku i tij, që gati sa s'thirri: «Mos e zgjidhni atë!». U dëgjua një pasthirmë, «ah» e gjatë, shumëzërash dhe u krijua pështjellim në sallë. E shoku i tij përsëriti: «Mos e zgjidhni atë!»

... Kemi qenë shokë të ngushtë. Më tepër se shokë. Në universitet na mbanin për vëllezër siamezë. Ishim gati si dy genie të gjalla, që jetojnë në simbiozë me njëri-tjetrin. Kudo bashkë. Ai përpara, unë pas. E admiroja tepër. Ishte fshatar, si unë, por i mori shpejt zakonet e qytetit. Vajzat e pëlqenin. Mbahej bukur, i pashëm, i shkathët, i zoti i gojës. Hazër xhevap. Ai ishte i adhuruari im, idhulli im. S'ia hante geni shkopin.

Unë kisha ende kompleksin e ndjenjës së inferioritetit, që ndien shpesh fshatari për qytetarin, konviktori për studentët tiranas. Ai përpigëj, jo me fjalë, por me shembullin e tij dhe deri-diku e arriti që të ma largonte këtë ndjenjë. Ai dinte të komunikonte me të gjithë si i barabartë me të barabartët. Me mua sillej si një vëlla i madh me të voglin. Dhe unë i pranoja me kënaqësi këto raporte, paçka se qemë moshatarë.

Studionim për gjuhë-letërsi. Dhe, siç mund ta merrni më mend; kishim filluar të dy të shkruanim dhe të botonim ndonjë vjershë, nga ato që botohen në gazetën «Studenti». Ai filloi të çajë dhe në organet e tjera. Po merrte hijen e poetit.

Në fillim, përherë, i lexonim njëri-tjetrit vjershat tona. Unë e përgëzoja, ai kënaqej. Më vonë, sa vinte e më shpesh; më tregonte për miqtë e rinj që kish njohur. Ai rritej përditë në sytë e mi. Sa shpejt që rritej! Shkrimtari i njohur iks më lavdëroi vjershat, që m'i lexoi në dorëshkrim: «Ke stof poeti, — më tha, — premtori

shumë. Vazhdo të shkruash dhe më sill poezi të tjera.» Do të të njoh edhe ty me të. «Falemin-derit», përgjërohesh unë. Herën tjetër. «Gazeta (kuptohet jo «Studenti») më kërkoi një cikël. Kryeredaktori më ka rezervuar një faqe të tërë. Presin! Le të presin! Do të të ndihmoj edhe ty të botosh diçka atje.» Çfarë shoku, gëzohesh unë. Nuk të harron kurrë.

Më duket se ishim në vitin e tretë, kur një ditë erdhi me ngut dhe më kërkoi kostumin hua. Ishte kostum i ri, e përdorja rrallë, e ruaja. «Ika, — më tha, — më kërkon zëvendësministri të pimë një kafe.» Dhe i zbriti shkallët e konviktit dy e nga dy me nxitim. Kur u kthye, më tregoi se zëvendësministri ia kish pëlqyer mjaft një shkrim për tekstin e antologjisë së klasës së tetë. Dhe se i paskësh thënë që krahas poezisë, të merrej edhe me studime. «Koha kërkon studime, ti ke tamam brumë për studime.» Kështu i kish thënë zëvendësministri.

Vjershat i shkruante vetë. Shkrimin për antologjinë, po ashtu. Por shkrimi që botoi që i do bët. Unë e kisha kënduar mirë antologjinë e klasës së tetë. Bënim praktikën pedagogjike në shkollat tetëvjeçare dhe nuk më kish pëlqyer ai tekst. Të shkretët nxënës sa vuanin me të! Kishte një përzgjedhje dhe përzierje të keqe pjesësh letrare. Për hir gjoja të tematikës, në të ishin zgjedhur e futur pjesë të vakëta, nga ato që me zor lexohen. Nga halli e jo nga malli.

Të vinte keq për nxënësit, që detyroheshin të komentonin e të mësonin përmendësh pjesë aq të dobëta. Njëra nga këto ishte e shkrimtarit të njohur N.N. Për çudinë time, pikërisht këto pjesë

të rëndomta shoku im i lavdëronte. «Kanë tematikë aktuale, të larmishme, interesante. Edukojnë!» Asgjë, asnjë fjalë për atë që u mungonte, për vlerat që s'i kishin fare.

Ia pata thënë mendimin tim për nxënësit fatkeqë, se duhej të mësonin përmendësh shumë pjesë të mjera të tekstit. Kanë ujë shumë. Kësh-tu i bëjmë fëmijët, që, qysh në shkollë, t'u zver-dhet letërsia. U bëjmë dëm. «Nuk ke kritere të drejta, — më kundërshtoi shoku im. — Dhe për-sa i përket pjesës së shkrimtarit të njohur N.N., mos harro se furra e tij nuk nxjerr kurrë bukë gulle.»

Si kish pirë kafënë e kish këmbyer bisedën me zëvendësministrin, erdhi dhe më tha: «E, a e sheh që kisha të drejtë? Duhet mbajtur mirë parasysh kriteret, i dashur. Ke mbetur pas nga shijet dhe kërkesat e kohës. O fshatari im i etur për kontradikta!» Dyshëva shumë në vlerësimin e tij, por autoriteti i atij që paskësh pëlqyer artikullin, ishte i madh. Peshonte. Mbase kish të drejtë! Punë kriterësh, që unë s'i kuptoja dot. Do-ja t'i kuptoja, por s'i kapja dot. Vërtet, mbase isha disi kontradiktor.

Zëvendësministri kishte një vajzë të urtë. E kishim shoqe kursi. Dhe ishte ajo që e kish njohur të atin me shokun tim. Mbas laydërimit të shkrimit për antologjinë orëzezë, shoku im filloi të lavdëronte shumë vajzën e zëvendësministrit. Paçka se ajo ishte vërtet studente e mirë, nuk ishte vështirë ta kuptoje përse. I bëri komplimentet që i meritonte dhe shpresonte shumë në miqësinë e saj. Ajo ishte vajzë shumë e urtë dhe

shumë e turpshme, skuqej menjëherë si vajzat tona të fshatit. Veçse u fejua jo me shokun tim, por me një student të inxhinierisë. Na erdhi mirë të gjithëve për të. «S'ke ç'bën, — tha shoku im aherë. — Janë në modë shkencat e sakta. Sot vlen më shumë fizika, se lirika. Është koha e levës së Arkimedit dhe jo e vargjeve të Homerit. Por s'ka gjë. Mos u mërzit, do ta shikojë ajo, do të vijë shpejt dita jonë, dita e poetëve.»

Ditët iknin dhe në vitin e fundit shoku im s'kapej më fare. Ishte kthyer në elektron të lirë. Vinte vonë në dhomë dhe ngrihej vonë. Na gjente në gjumë dhe e linim në gjumë. Mungonte shpesh në leksione, por arsyetohej me aktivitetet shoqëror. Ishte i ngarkuar shumë. Filloi të mban-te edhe fjalime, por më shumë të shkruante fjalime për të tjerët. Dhe kur qëllonte që të tjerët flisnin me raportet e tij, ai i lumtur më pyeste: «E, si t'u duk, o fshatar i mbarsur me kontradik-ta?! A e ndjeve stilin e autorit?»

Kishte filluar të fliste për stilin e vet!

Një mbrëmje vonë, nga ato të paktat që tani i kalonim bashkë, kur më kujtoi si gjithnjë me shaka origjinën time prej fshatari, e pyeta disi i pezmatuar: «Po ti, ç'je? A nuk je fshatar?» «Po, — m'u përgjigj, — veçse me një çikëz ndryshim: unë jam ish-fshatar i etur për progres!»

Ishte vonë, shokët flinin dhe kontradiktën time për progresin e tij nuk e shfaqta atë natë...

Në konferencën e talenteve të reja ishim ftuar të dy. Ai foli për nevojën e kulturës së gjërë të poetit dhe për studimin e përvetësimit e domosdoshëm të gjuhëve të huaja. Çdo gjuhë e huaj është një dritare në pallatin e poezisë. Kë-

shtu tha ai. Shumë kishin mendimin se shoku im zotëronte mirë spanjishten. Në raftin tonë të librave prej dy vjetësh kishim një vëllim me poezi të Lorkës. Nuk mbaj mend kush ia kish falur, por baladat me kuaj dhe ciganë spanjollë të Lorkës zinin vend mirë në raft. E dija që ai s'dinte as italishten televizive, por të gjithëve u kish mbushur mendjen top se po përkthente Lorkën. Filloi të qajej se spanjishtja s'është si italishtja, që zotërohet kollaj. Vërtet ngjajnë, neolatine janë të dyja, por, si është ajo fjala e mocme, motra janë e motra s'janë. Apo jo?

Nisa dhe unë të besoja se po përkthente Lorkën. Shoku im kishte një forcë të madhe induksioni.

Vitin e fundit, kur ai merrej më shumë me fjalimet sesa me mësimet, në provimin e semestrit të parë mbeti zbuluar, jo pa jorgan, por pa çarçaf fare. Dësh u prishëm atë ditë përgjithmonë. Kontradiktat po delnin sheshit. Nuk ishte përgatitur. Më kërkoi kopje. Më hodhi tezën dhe priste ta ndihmoja. Unë u hutova, u shkuqa, më erdhi turp. Ngurrova, Ai u zverdh nga marazi. C'prisja? S'kisha kurajo. Më dukej sikur po bëhesha hajdut xhepush. Ai priti dhe pak. Më pa me përcimim dhe, kur u bë gati t'ia kërkonte shërbimin shoces, sonë të urtë, bijës së zëvendësministrit, unë i bëra shenjë se tani po e hedh në letër përgjigjen e pyetjes. U ngrita të përgjigjesha dhe kalimthi i lashë shokut tim atë që më kërkonte. Pas ndieja shikimin e tij që me siguri thoshte: o bir i kontradiktave, fshatar! U përgjigja i hutuar dhe i tronditur, mora notën tetë. Shoku im ish përgjigjur i qetë dhe i sigurt, kish

marrë nëntë. «E pe? — më tha. — Unë bulmet kam sa të duash, qumësht deleje det, por më duhej pak majâ. Një lugë m'u desh dhe zura kosin si djathë!» Vërtet, kish të drejtë. Ai mori nëntë dhe unë tetë.

Më me kurajo do çarë në jetë, më jepte shpesh mësim ai. Jeta është e tëra provim dhe, sado të zot të jemi, s'mund të kalojmë pa ndihmën e njëri-tjetrit. Njëra dorë lan tjetrën, të dyja fytyrën. Dhe në provimet e jetës ai dilte me fytyrë të pastër, të larë dritë.

Ishte burrë i zoti.

Kur mbaruam studimet, ai u emërua në Tiranë, e mbajtën asistent pedagog. Ishte djalë me perspektivë. Mua më çuan në fshat, mësues gjuhe. Më erdhi mirë për të, u gëzova. Atij i erdhi keq për mua, u hidhërua. Më ngushëlloi të mos mërzitesha, jeta është e gjatë, nuk është thjesht një emërim. Kish të drejtë. Dhe më siguroi se në këtë jetë do të kisha gjithmonë ndihmën e tij. Ishim apo s'ishim shokë? Dhe më ndihmoi...

... Sapo kishte mbaruar simpoziumi ndërkombëtar në Tiranë. E kisha ndjekur në televizor. Isha kënaqur me ligjëratat e kumtesat dhe, mbi të gjitha, me shokun tim, që dilte herë pas here në ekran, se shoqëronte një profesor të huaj. E admiroja, sa mirë dinte të qëndronte para kamerës. Ishte mësuar me presidiumet...

Nuk e prisja që dy ditë pas simpoziumit të më vinte në fshat. Erdhi me «Pezho». E para veturë «Pezho» që vinte në fshatin tonë. E ndali makinën mu pranë pragut të derës së shtëpisë sonë.

U takuam, u çmallëm. Prindërit u hutuan,

që kisha një shok me kaq përgjegjësi. «Pezhoja» fliste qartë për këtë. S'kish nevojë për kallauz tjetër.

«Ja, sapo përcolla në kufi profesorin e huaj, — sqaroi shoku im, — dhe i dhashë porosi shoferrit ta kthente njëherë timonin këtej. Më kish marrë malli, bre! Dy vjet pa u parë, sa dy shekuj. Kemi ngrënë një furrë bukë bashkë, or t'u mbylltë!» Kurse nënës dhe babait i tha: «E kemi djallë të mirë këtë pjellën tuaj. Xhevahir, pa ankesa!» Ai e ndiente veten bos dhe unë isha tani për të një çun i mirë, si ata djemtë e shkollës, që u jap mësim. Paçka se ai e dinte fort mirë se ishte ndonjë vit më i vogël se unë.

Babai nxitoi e theri gjelin dhe, si në një këngë të fshatit tonë, ndodhi që «Më kokoshi s'na këndon, Mirë se erdhe, o gjiton!»

Nëna bëri fët e fët byrekun për merak. Dhe atëherë, tek kënaqte syrin e ngopte mullën me të mirat e kuzhinës së fshatit, shoku im tha, gjithë prush:

— Ç'më kujtuat fshatin tim, bre, nënën time, bre! Dhe ajo, ja, kështu si ti, o zonjë e shtëpisë, e qan fare byrekun!

— Lum ajo nënë që të ka, or bir! Rrofsh! — uroi nëna ime dhe i vuri përpara dy feta të tjera byreku.

— Më ka marrë malli, qamet! Por s'më bëhet mbarë. S'ka kohë fare të shkoj, — sqaroi shoku im.

— E mbara t'u bëftë mal! — uroi prapë nëna ime.

— Jemi mbytur në punë, moj nënë, deri në grykë. Studime, botime, ligjërata, fjalime, raporte...

Tani fliste me gjuhën e «Zylos» së Dritëroit.
— Ruaj shëndetin, o zemër! — u shqetësua ime ëme. — Raportet të mira janë, po me karar (kuptohet, që duhej ta kish fjalën për raportet e mjekut)!

— Me kandar, çdo gjë, — ndërhyri babai.

— Mirë thua, zotrote, po ku ta gjejmë kandarin, se? Në punët tona s'ka kandar, por hambar! — tha shoku im.

— Mashallah! Plastë syri i keq! — tha nëna ime.

Pimë kafën, ndezëm duhanin dhe ishte e qartë, ai mbeti i kënaqur te ne. Tani ishte radha e tij të uronte.

— Paçi e dhënçi! Buroftë në këtë shtëpi e mira!

— Të mira paç e të mira dëgjofshim për ty, biro! — pasoi nëna.

U duk se kaq që vizita e tij në fshatin tonë. Gjithçka vajti mirë, kur papritmas shoku im tha:

— Po ç'kemi këtej nga katundi juaj? Si e keni kryetarin, kryesinë, burra të zotë, për së mbari?

— Punëtorë, të drejtë, — tha im atë. — Hakun ta japin! — Dhe shihte me përgjërëm shokun tim. «I mençur ky shok, gjeti kohën të pyesë dhe për fshatin.» Unë s'flisja. Isha vetëm djalë i mirë.

— Dalim njëherë nga qendra e kooperativës. Dua të takoj kuadrot, — tha shoku im.

Desha t'i thosha: «po ti nuk i njeh, ç'do të bisedosh me ta»? Desha t'ia thosha, por e dija që kjo ishte një pyetje pa kuptim për të. Harrova për një çast se ai është i vetmi për komunikim

me kuadrot. Bile pata frikë se do të më thoshte «më njohin ata mua!», ndaj dërgova një djalë të vogël te kryetari dhe ai me shokët e pritën.

Dhe e vërteta është se shokët e kryesisë e pritën me qejf dhe u takuan me të si me një të njohur.

— Ku e keni limerin? — pyeti ai. — Zyrat ku i keni? Hajde të ulemi një copë herë, të këmbejmë dy llafe.

Vajtëm në zyrë, u ulëm, biseduam. Kryetari i foli për hallet e kooperativës, ai tundte kokën. Pastaj foli për simpoziumin, ngjarje e madhe për shkencat albanologjike. Shokët e kryesisë dëgjonin. «Pezhoja» rrinte përjashta në diell, vezullonte. Në fund shoku im tha:

— Më kënaqët, kryetar, me ato që më treguat. Faleminderit, por puna është të mos i ndajmë llafet nga veprat; vjeshta dhe hambari do të flasin më mirë. Apo e kam gabim?

— Jo, — tha kryetari, — llaf me konak!

— E po, zënë e mirë, kryetar, dhe mirupafshim! — uroi shoku im tek ngrihej. — Dhe shiko, kryetar, ma kini në kujdes mësuesin, — dhe tregoi nga unë. — E kemi djalë të shtruar në punë. Nuk është si disa, që në kohën kur duhet të ujitin misrin, ujitin karrigen e përcjellin delegacionet. — Dhe qeshi i lumtur me batutën e vet.

— Me kë e ka? — më pyeti nën zë babai. — Ç'pati?

Unë mendova që tani u bëra anëtar delegacioni, kurse shoku im ishte kryetar i tij. Bërte vapë e madhe, aq sa dëgjohej kondicioneri, që i kish hapur «Pezhosë» shoferi.

Kryetari i vërtetë, ai i kooperativës, nuk foli. E pa që shoku im kish harruar apo s'kish haber fare që në të tillë vapë misri ujitej natën, që të mos prishte uji i ftohtë akull rrënjët e ngrohta të bimëve. Kaq gjë në fshat, tek ne, e dinë edhe fëmijët e shkollës. Nejse! Njeri nuk foli. Dëshat'i kujtoja shokut tim se kur ujitej misri, por, kur të zotët e punës heshtën, heshta edhe unë.

Disa fëmijë i silleshin rreth e përçark «Pezhosë». Ai, si për t'u treguar atyre se erdhi i zoti i saj, i ra rrotull edhe një herë makinës. Pastaj u kthye dhe i dha dorën kryetarit dhe mua, ngjatjetoi të tjerët dhe, tek hapi derën e «Pezhosë», dëgjova që thirri:

— Kujdes mësuesin, kryetar! Dhe mos më harroni misrin, shokë!

Dhe iku. Çau tutje drejt qytetit.

— Paske shok të mirë! — tha përsëri babai.

Këtë e kam dëgjuar edhe herë të tjerë nga të tjerë për të.

— Qenka plep i lartë dhe s'duron ulli pranë, — më tha kryetari.

*
*
*

Kaq tha shoku ynë për kandidatin, shokun e tij të dikurshëm. Foli disi i hallakatur, natyrisht, i emocionuar, por thelbin e shqetësimit të tij e tha qartë: «Mos e zgjidhni atë»!

Mars 1988

Fëmijët e Aripës

Kisha kohë pa ardhur kësaj rruge. E dija që në dimër Qafa e Malit bllokohet shpesh nga bora. E kam provuar vetë këtë, ndaj s'kisha nevojë për kallauz, po s'më shkonte mendja që në fund të tetorit të këtij viti të ngrohtë do të fillonte bora. Tepër shpejt!

Nuk ishte tamam borë, qe më tepër zborinë ajo që binte dhe rrugën e kish bërë si të lyer me graso, shumë rrëshqitëse. Për çudi, asfalti i rrugës, i dëmtuar keqas nga skorjet e kromit që hidhen dimrit në akull për të rritur fërkimin e rrotave të makinës, po na ndihmonte.

Po zbrisnim ngadalë nga Qafa e Malit për në Fierzë. Kaluam hotelin e vogël të Lajthizës, që me siguri nuk kishte njeri, përderisa në sheshin para tij nuk kish ndaluar asnjë makinë.

Vazhdonim të udhëtonim teksa malet përreth kishin nisur të zbardheshin. Mullinjtë e qie-

llit po fillonin punën së mbari, plot me bereqet, dhe shkundnin miellin e parë, borën e parë të vitit. Anës rrugës shpesh duken arkat me kampionet stivë të sondave gjeologjike, që të kujtojnë arkat me domate eksporti. Dhe nuk i ngjet njeri.

— Para ca vitesh kjo ishte Rruga e Dritës, ta shti qenka bërë e gjeologjisë! — them unë disi i habitur nga arkat dhe sondat kreliuse të gjeologjisë.

Kampionet e mineraleve herë janë gri në blu, me kromite, e herë të kuq në të verdhë, me piritë, në sfondin e bardhë të borës; ngjyra e mineraleve që këmbehen: ku e kuqe e ku blu, të ngjajnë herë me flamur italian e herë holandez.

— Qenka rrugë e keqe, — thotë shoferi, që sapo pagëzohet në të.

— Ka dhe më keq! — them unë kot fare, sikur dua të mbroj rrugën dhe njerëzit që paguhen për mirëmbajtjen e saj.

Shoferi sheh pak i hutuar nga unë dhe ma kthen urtazi:

— Ka! Patjetër që ka! Po gjynah të lihet kështu! Sikur e kanë bombarduar aeroplanët.

Unë qesh. Shoferi pyet:

— Pse qeshni? Apo e kam gabim.

— Rrugët e bombarduara nga aeroplanët s'janë kështu. Ato kanë hone të thella bombash të mëdha, që duhet t'u shkosh rrotull, se ndryshe s'kalohen. I kam provuar dikur në Vietnam.

— Si?! Keni qenë në luftë të Vietnamit? — pyet shoferi me një ndjenjë nderimi, që nuk e fsheh.

— Kam qenë kur bombardohet nga Niksoni.

Sa herë kalonin bombarduesit e rëndë amerikane, detyroheshim të shtriheshim kanaleve anës rrugëve.

Në Miliskajë rrëzë gardheve të larta të shtëpive kanë dalë një tufë kalamaish. Sapo kanë mbaruar mësimin. Më të guximshmit prej tyre bëjnë me dorë, që të ndalojmë e ti marrim në makinë. Madje njëri syresh, një kokësac, i qethur zero, hedh para rrotave çantën e librave. Ndaluam. Kjo çantë para rrotave ishte postblllok.

Poshtë kokave të fëmijëve duket shkolla e Miliskajës. E mbaj mend mirë këtë shkollë, njëzet vjet të shkuar, para se të fillonte hidrocentrali i Fierzës; këtu kishin ngritur bazën e tyre gjeologët. Studionin shtratin e lumit në kërkim të vendit të përshtatshëm, ku do të ngrihej diga e madhe e Drinit. Shkolla e parë, ajo që kam njohur unë, ishte fillore, kjo e sotmja qenkësh tetëvjeçare. Këtë e mora vesh tani nga nxënësit, që presin të hipin në veturë.

Atë vit të shkuar këtu ishte mësuese për të katër klasat bashkë një vajzë nga Shkodra, e qeshur siç janë gjithë shkodranët. Ajo qe e para që na foli për dy mësueset, koleget e saj korçare në Fierzë. U qau hallin që po mbushnin pesëvjeçarin e tretë në Drin. Vetë shkodrania e shkathët si fërre, që na ngrohu grykën me çaj bjeshke, kishte tetë vjet mësuese në Miliskajë. Por qe e kënaqur se «jetonte si pashalleshë në një familje fshati. Kurse korçarkat janë ba murgesha, të shkretat!» Shkodranen e mbanin për merak miliskajorët. Helbete, cucë Shkodre! Kurse korçarkat flinin në qelën e priftit të Fierzës. Kishin dymbëdhjetë vjet që punonin arsimtare në fshatrat e Pukës.

Pa martuar. Prinsin transferimin. Puna për kërkimin vendit të digës së ardhshme e solli që pas ca ditësh të njihesha dhe me çupat e Korçës. U gëzuan atë natë, kur u thamë që do ngrihej hidrocentrali, e Fierza do bëhej qytet që do t'i jepte dritë dhe Korçës. Ndërsa sofrën ku po thanim darkë e ndriçonte zbehtë kandili.

... Shoferi, që pret urdhër për ti marrë kalamajtë e Miliskajës në makinë, ndërsa unë kam humbur në kujtime, thotë:

— Të hipin, apo jo?

Fëmijët e dëshiruar për veturë janë shumë, mbi dhjetë, dhe natyrisht nuk i marrim dot të gjithë, ndaj unë e shtroj çështjen kështu:

— Le të vijnë një katër a pesë, që e kanë shtëpinë më larg. — Paçka se ndenjëset pas kanë vend vetëm për tre vetë. Por ata janë të vegjël dhe mund të rrinë shtrënguar edhe cazë më tepër.

Dhe ndërsa fëmijët zgjedhin midis tyre «hallexhinjtë», më dalin përsëri para syve, si në një ekran të programuar të kujtesës, vajzat mësuese të Korçës. Ku janë vallë ato sot? A janë atje në Korçën e tyre, që qytet tjetër si ai s'ka, apo mos vallë janë martuar në ndonjë qytet a fshat tjetër, që duhet të jetë patjetër më i bukur nga Korça, përderisa rritin pjellën e tyre në të.

... Në ndenjësen e pasme të veturës hipin katër «fatlumët» e vegjël. Tri goca dhe një çun.

— Pra juve ju ra shorti të hipni në makinë!? — sqaron e pyet shofer Iliri.

— Domethënë ju i paskeni shtëpitë më larg, — shtoj unë.

— Jo, he burrë! — ma kthen çuni i vogël,

— këto vajzat i kanë larg fort kullat, kurse unë jo. Por ma lanë radhën shokët, se e kam nanën të pamundur e tatën lart në bjeshkë.

Në pasqyrën e kabinës ndjek lëvizjet e gjalla, zhivë, të çilimijve. Ata herë ulen e herë ngrihen, herë shtyhen majtas e herë djathtas, thua se s'po gjejnë rehat. Kokat e tyre të vogla me leshrat e verdha më duken si ftonj të pjekur.

Djalin e quajnë Manfred, vajzat Mari, Prenda dhe Drande. Drandja po kalon rrjebullën dhe lëkura i është molepsur me puçrra të qelbëzuara.

— A ke qenë te doktori, Drande? — pyes unë.

— Si mos me qenë. Ka qenë! — përgjigjet Maria në vend të Drandes. — Dhe i ka dhanë melhem.

Tani vë re, midis puçrrave, gjurmët blu të permanganatit.

— Me shëndet e të shkuara! — i uroj Drandes.

— Shëndet me gjithë ç'ka ke! — ma ktheu goca e vogël.

Më bën përshtypje emri i djalit, Manfred. Këtyre anëve ky emër nuk haset. Ndoshta është i vetmi Manfred në Alpe. E pyes çunin:

— Kush ta ka vënë emrin, kumbara apo probatini i babait? — (bëj unë lojë fjalësh).

— Ma ka vu tata, se kështu e thirrkan një mikun e vet vlonjak. Kanë ba ushtrinë bashkë.

— Ta gëzoç!

— Gëzim paç! — ma ktheu djali.

Makina ecën ngadalë, si veturë nusesh. Iliri bën kujdes në rrugën me akull.

— Nga jeni? — pyes unë. — Nga Miliskaja?

— Jo! Në Miliskajë kemi shkollën, kurse në Apripë kemi shtëpinë. Ndryshe s'kishim pse me lyp me hyp në makinë me shit burrni, — thotë Manfredi i vogël, si një burrë i madh.

— Aha, — them unë, — nga Apripa e Keqe! Fëmijët qeshën. Sigurisht u vjen mirë që e njihkam fshatin e tyre.

Drandja me rrjebull thotë disi me ngurrim:

— I kanë pasë thanë e keqe, po ne e mbajmë mend veç të mirë!

— Pse? — habitet shofer Iliri, — sa Apripa janë: Një e mirë dhe një e ligë? — Emrin Apripa ai e shqipton si Agripa, perandor i Romës.

— Asht dhe Apripa e Gurit, matanë Fierze, — sqaron Mara. — Por ata nuk kanë rrugë makine si na. Na e pruni hidrocentrali.

Nuk është tamam kështu, por më pëlqen krenaria e Marës së vocërr për fshatin e vet.

Dhe vras mendjen cila prej tyre ka qenë vërtet e keqe!?

Të katër fëmijët janë nxënës të një klase, të asaj të gjashtë. Ata pyesin e duan të dinë se kush jemi ne, miqtë nga Tirana, që i sajdisëm sot kështu.

Iliri i pyet në e kanë librin e këndimit me vete. Me siguri shpëson që në të do të ketë ndonjë pjesë tregimi nga të mitë. Dhe kështu nuk do të kish nevojë për prezatim tjetër. Fëmijët sqarojnë që sot nuk kanë pasur këndim, por edukatë morale dhe aritmetikë.

Unë u lutem fëmijëve:

— A s'më tregoni pak librat? A i keni të reja, a i mbani mirë?

Ata hapën shpejt e shpejt çantat e leshta, si

në garë, kush të dalë i pari. Dhe librat e mbështjellë me faqe revistash futen prapë në çantat me gjalmë dhe qëndrojnë atje ngrohtë e pastër, sa në asnjë bibliotekë të botës.

— I mbakeni xham fare, — i përgëzoj unë.

— Janë libra, or shoq! — thotë Manfredi, duke më lënë disi të habitur. Nuk e dinë ata që në jetë kam parë libra shumë më të vyer se këto tekstet e tyre shkollore që grisen e mbeten ligisht, madje dhe në vende të shenjta të dijes!

— Ja dhe Apripa jonë! — thërret Prenda, — A po vini për një kafe tek kulla? E kam, qe, këtu, bash te xhadja!

Falënderojmë Prendën për ftesën, por e kemi me ngut, se na presin në Fierzë.

— Si ta keni punën. U qoftë ditë e mbarët! — na uron Prenda.

Fëmijët falënderojnë në kor për nderin që u bëmë. U kishim kursyer një orë e gjysmë rrugë më këmbë. Kaq është udha që bëjnë ata dy herë në ditë, vajtja e ardhje, nga Apripa në Miliskajë. Ne ndezim makinën e bëhemi gati të nisemi përsëri. Manfredi papritmas troket fort në xham. Unë mendoj se mos vallë djali ka harruar ndonjë laps a fletore në makinë. Harrojnë të mëdhenjtë, jo më çiliminjtë! Hap xhamin dhe dëgjoj tek na thotë:

— Më prit, or, ti, shoku shofer, besa, vetëm një deqikë, se ia mbrrina!

Dhe iku me vrap.

Vë re që shoferi disi mërzhitet. Dyshon se mos ky qerrata Manfredi do të na japë «peshqesh» deri në Fierzë ndonjë pasagjer tjetër. Si duket, i pëlqeu vetura dhe do t'u bëjë nder dhe

të tjerëve. Vajzat e urta: Mara, Prenda dhe Drandja presin tok me ne. Dhe ja tek vjen me vrap Manfredi me kokën si ftua, që i lëshon shoferit në dorë një kokërr ftua të madh, më të madh se koka e tij. Tamam Joan Kryepreri, që të fal kokën e vet.

— Më falni, burra! Se për pak u koritëm!
— thotë ai.

Mua më vjen të qesh me krenarinë dhe bujarinë e tij. Shoferi sheh nga unë: a ta pranojë dhuratën? Unë mbyll sytë në shenjë miratimi. Bakshishin nga fëmija e pranon dhe mbreti, jo më shoferi.

Ne ikim dhe fëmijët mbetën pas me duart që i tundnin lart si degëza bredhi. Në kabinë vjen erë ftoi të pjekur mirë. Do bëj dimër sivjet, por me këta fëmijë ç'do dimër do ta ketë vështirë. Ata njëmbëdhjetë-dymbëdhjetë vjeçarët e Apripës bëjnë dy herë, çdo ditë, nga një orë e gjysmë në këmbë për të vajtur e ardhur në shkollë.

... Dhe makina edhe për shumë ditë të tjera mban aromë ftoi të shijshëm, një aromë dehëse, më të fortë se çdo deodorant i Evropës...

PËRSHKRIME

Ç'të rrëfej më për këto gra?

Isha lodhur disi. Bënte ftohtë. Kisha biseduar gjatë e gjerë me shokët e kryesisë të kooperativave të Lekbibajt dhe të Shëngjergjit. Isha gëzuar me shkollën e mesme të re, me tre mijë librat e saj, me fëmijët, që, megjithëse disa syresh i kanë shtëpitë dy orë e ca larg nga shkolla, pas mësimit i pastronin klasat për merak, i bënë dritë.

Më kish ardhur keq që në këto vise malorë të larta që gërvishtin qiejt, gjitonë me Dukagjinin (shpesh atje i marrin edhe nuset për djemtë e tyre) të ardhurat nga blegtorja i kishin të pakta, vetëm 24 për qind. Kanë vetëm pesë mijë dhi e dhen, kur njëzet vjet më parë kishin dhjetë mijë krerë e kushtet i kanë për tre katërfish. Kurse të ardhurat nga frutat edhe më pak, katër deri pesë për qind!

E pra, trojet e lashta të Nikajve dhe të Mërturajve, me fshatrat që ngjajnë si konstelacione yjesh të largëta, si Lekbibaj, Brisë, Salcë, Ferraj, Palç, Shëngjergj, Curri i Epërm etj. janë të veshura me gështenja, arra dhe dushk. Këtu rritet mirë kumbulla e hijeshon pjergulla me gjetthet këmbëpata. Pa folur për drurët e shkurret dhe lulet det të malit. Këto janë bjeshkë të begata, të ashpra dhe të sarta vërtet, po pëllëmbë e flori. Vend për mjaltin dhe bletën, virgjër nga pesticidet e insekticidet, por që, për çudi, kooperativat nuk mbajnë zgjoje fare.

Lart, në shpellën e Kak Verrit, ku venë për verim bagëtia, paska një lëndinë me ca lule «me lanë kokën», me të cilat bëhen barna të sojme për shërimin e njerëzve. Para luftës së madhe paska qenë një murg i vetmuar, që jetonte si eremit në shpellë dhe lulet e vyera i shiste në Helveti, në Zvicër, ku i bënë barna me famë të firmës «Ciba». Atje e kanë varrosur eremitin. A ke dëgjuar për varrin e murgut? Jo! Gjeolog kam qenë vërtet, po varrin e murgut nuk e di.

— Po «Gurin e Baronit», a e di? — vazhdojnë të më bëjnë provim vendasit. Baronin e marr me mend kush është. Ka qenë gjeologu i njohur dhe albanologu i shquar austriak Franc Nopça, që vishte tirq malësori dhe e fliste shqipen si mirditor. «E pra, bash ai ka vënë shenjë në një gur të këtyre bjeshkëve.» Ç'të jetë ai shkëmb me shenjën e tij, krom apo bakër? Sa punë ka ende për shokët tanë gjeologë në këto male, paçka se qysh tani këto vise jetojnë me minierat dhe sharrat!

Dëshiroja të shihja edhe «Gurin e Baronit»,

dhe lugun e luleve të murgut, por ishin larg, shumë lart, ndër maja. Bënte ftohtë dhe frynte erë. Dhe në fillim të nëntorit moti nuk ka besë atje. Kish filluar bora shpejt (dështim dimri kjo apo dëshmi e dimrit të fortë që po vjen) dhe i kisha zili fanellës së thurur me lesh të trashë të kryetares së këshillit, Shkurtës.

Nuk u ngjita dot në ato maja, mbase në beharin tjetër do kem fat të shkel mbi to, por u ngjita nga Lekbibaj për në Perraj që kumbis kokën si foshnjë në prehrin e bjeshkëve, midis Rrukut të Nikajve dhe Kores së Mërturajve.

Po gremisej dielli tej, në grykat e Dukagjinit. Ishte muzg, që ora pesë e pak pasdite, kur mikpritësit më thanë se kanë një kopësht fëmi-jësh e çerdhe bashkë në Perraj. Meqë kisha parë me merak shkollat, ndoshta deshën të më ushqenin edhe dashurinë për çerdhet dhe kopshtet, «fidanishtet» e shkollës. A, mbase, kushedi, kujtuan se do të përtoja. Ishte një orë larg dhe bënte ftohtë. Afshi i gojës ngrinte si spruco avulli në ajër. Por jo, nuk dua të besoj të ishte kjo arsyeja kryesore. Nuk besoj se deshën të më vinin mua, mikun, në provë.

Jam i bindur se ky mendim, zonjës së vendit, kryetares së shkathët të Këshillit, Shkurtës, i lindi kur hanim drekën në restorantin e Lekbibajt, tek mora vesh nga kamerierja me emrin e papritur Riva, që orizi për pilafin që shijoje, natyrisht, kish ardhur nga «Bajram Curri», por edhe preshi po nga «Bajram Curri»! Sikur të mos e dije që ka një qytet të bukur, ballkon i Alpeve, që quhet kështu se ai njeriu, burri që ka mbajtur këtë emër ka qenë një luftëtar i shquar

si lirisë, do të mendoje, tek dëgjoje kamerieren, se Bajram Curri ishte një ekonomist i zoti, që siguronte ushqimet deri edhe preshin për mensën e thellë të Lekbibajt!

— Pse? Nuk furnizoheni nga kooperativa me zarzavate? — pyeta unë i hutuar nga kjo e papritur.

Kameriere Riva qeshi hijshëm nën buzë dhe kryetaren Shkurtë e zuri lemza e kërkoi ujë. Ishite e qartë, pyetja ime binte në vesh të shurdhët.

Në këtë çast besoj, pra, se lindi mendimi i Shkurtës të ngjiteshim në Perraj për të parë kopshtin e fëmijëve.

Lëmë shtegun buzë kanalit të «Ujit të Zi» e mbajmë udhën tutje, sipër mbi fshat. Ku dreqin e kanë bërë këtë kopësht kaq larg? Ftohtë, po djersa më pikon mbi këmbët që rrëshqasin në rrëketë e ngrira. Po nënat me foshnjat në krahë si ia bëjnë kur ngjiten e zbresin dy herë në ditë këtu?!

Intuita e kryetares së këshillit është e habitshme. Ajo m'i ka regjistruar mendimet tek thotë:

— Mot, po, duam të bajmë një kopësht të ri, tek xhadja e madhe, midis katundit. Se edhe gratë lodhen... — dhe nuk vazhdon më tej. Dukët që s'do të më fyejë duke thënë: «Ashtu si dhe ti»!

Unë s'flas. Frymëmarrja ime e rënduar dhe tashmë tepër e nxituar flet vetë.

— A u lodhe? A shkojmë ma mirë të pimë një kafe te shtëpia e Shkurtës? Se kopësht kalamajsh ma asht ai! — më thotë një nga brigadierët, burrat e fshatit që na shoqërojnë.

Aha! Ja ku fshihet lepuri, mendoj unë me vete. Filluan hilet e zanatit të nëpunësit. Po hyn psikologjia e nëpunësit të vogël edhe në male?! Siç duket, ky kopësht është një sajese që s'ekziston fare. Këtë dyshim ma rrit përkujdesja e tyre e madhe për lodhjen time. Por kam edhe një shkak tjetër për të dyshuar në ekzistencën e këtij kopshti. Po vete ora gjashtë e darkës, është errur. Si mund të punojë ky i bekuar kopësht kaq vonë? Kam parë shumë kopshte fëmijësh në fshatra (ma do puna kështu), por janë shumë të rrallë ata që mund të punojnë në këtë orë. Dhe arsyeja e vetme që ata s'punojnë në këtë orë të vonë për fshatin, është se ata janë pa drekë. Bile, edhe në Tiranë, po të vesh në këtë orë të marrësh mbesën, kujdestaret të rrinë hundë e buzë (se kanë pritur shumë) dhe s'përtojnë të thonë: Ama, gjysh i mirë dhe ky, që kujtohet tani për fëmijën! Pra, si të mos dyshoj se kopshti-çerdhe i Perrajve të Nikaj Mërturit s'mund të punonte në këtë orë!

Mora inat dhe nuk u tërhoqa nga rruga. Arritëm më në fund në kopësht. Pashë dhe mësova atë që më pëlqen ta dini edhe ju. Kisha gabuar! Ai «ekzistonte» vërtet.

Ishte një shtëpi e vogël me dy dhomëza të vogla fare dhe një kuzhinë të vocërr me një sobë të madhe. Ishin tri gra që kujdeseshin për njëzet e tre fëmijë: njëmbëdhjetë të çerdhes në njërën dhomëz dhe dymbëdhjetë të kopshtit në dhomëzën tjetër. Në korridorin e ngushtë llamba elektrike ndriçonte ca këpucka dhe opinga llastiku përtokë, te pragu i derës, dhe ca pallto e fanella leshi fëmijësh, varur në gozhdë. Ishte e

qartë që matanë, në ato dy dhomëza, kish zjarr të ngrohtë. Të dukej vetja, tek shihje këtë gardërobë fëmijësh, si në një fuaje fatlume teatri kukullash. Por ky s'ishte teatër kukullash, po çerdhe-kopshti i kalamajve të Perrajve!

Hoqëm këpucët, sipas shembullit të kalamajve, trokitëm në derë dhe hymë brenda. Rreth tavolinës së madhe, ulur në stola të gjatë, hanin darkën dymbëdhjetë fëmijët e kopshtit. Pjatat e mëdha, që pasqyronin dritën e poçit të llambës dhe atë të zjarrit të sobës së hapur, këndonin me zhurmë nga lugët e rënda që trokitnin e goditnin herë pas here si xhezband nga duart e njoma të fëmijëve. Kam parë afresket e «Darkës së fundit» të Rafaelit dhe për një çast të vetëm më vajti vetëtimthi mendja te shënjtoret e tij. Por jo, këta s'qenë as shënjtore me brerore, as engjëj me krahë. Ata qenë fëmijë të shëndetshëm, që hanin me qejf supën me barishte në Perraj! Atë supë që unë s'e hëngra dot në Lekbibaj.

Për darkë-fëmijët kishin supë me barishte dhe sultjash. Pra, kopshti dhe çerdhja e Perrajve punonte deri vonë. Nën atje s'kishin shqetësim për të vegjlit e tyre dhe çerdhja e kopshti kishin qumësht, derisa u bëhej sultjashi (kurse në Lekbibaj s'kishte kos në mensë), kishin zarzavate, derisa hanin supë me barishte.

U habita dhe pyeta kujdestaret se kush i furnizonte kaq mirë. Prapë «Bajram Curri»?

M'u përgjigjën se qumështin ua jep kryesia e kooperativës dhe brigada, kurse zarzavatet i rritin vetë kuzhinierja dhe kujdestaret. Të parën e besova, të dytën jo. Ç'ishin këto kujdestare

dhe kjo kuzhinierë kopshti fëmijësh që selitnin vetë perimet? Pse paguheshin ato, për kujdestare fëmijësh apo për brigadë perimesh?

Fëmijët katër-pesëvjeçarë u ngritën më këmbë kur vajtëm ne, «xhaxhallarët», dhe pastaj me fjalën e kujdestares u ulën e vazhduan të hanin supën e ngrohtë. Më erdhi rëndë prej tyre, se në atë të ftohtë brisk që na përcolli jashtë, atje brenda të shkrihej gjaku në rremba nga të ngrohtët e të vinte oreksi, sa ta kishte ënda të haje një pjatë supë bashkë me ta.

Nga turpi hoqa sytë nga pjatat e tyre dhe padashur pashë përjashta nga dritarja hënën e madhe sa kazani i supës së fëmijëve. Në dritare dy xhama qenë të thyer dhe në vend të tyre një dorë e shkathët nikoqireje kish rregullar mirë si dantella dy copë celofanë.

— Ka ba murlan e xhama s'mujtëm me gjetë, — shfajësohet kot kujdestarja e vëmendshme, që ka ndjekur shikimin tim në dritare. — Në vend të tyre ngjitëm qese sheqeri.

— Ku-ku! — thotë Shkurta, kryetarja. — Marre për mua, gra, që s'kam vue re këto letra. Nesër kam me jua sjellë xhamat!

Me siguri, Shkurta do t'i sjellë xhamat... Ne jse, e kishë fjalën, ç'qenë këto perime? Nga dolën këto kështu papritur?

Më ftuan në kuzhinë dhe atje mbi sobën e madhe kuzhinierja më vuri përpara dy arka me domate sa një top futbollli, po them, dhe më varën në dorë vargjet me qepë të bardha si topa bore e me spëca të kuqe si bozhuërë.

— A do me i provue një fiie, or mik? — tha kuzhinierja duke më afruar arkën me domate.

Lirova duart nga qepët dhe specat dhe nuk ngurrova, s'kisha më paragjykime e dyshime, dhe fëmijët s'qenë pranë që të më vinte turp.

— Ku i keni mbjellë? — pyes unë.

— Nji ktu, mbas kopshtit. Kemi një fije bahçe sa oda e kalamajve, — ma kthen kuzhinierja.

«Kopshti» i kopshtit, dukej nën dritën e sermtë të hënës, mu para nesh nën dritaren e kuzhinës. Ishte sa një zyrë nëpunësish tregtie. Në të ajo me dy shoqet e saj kishin rritur domatet të shoqëruara me fasule, bishtaja, qepët dhe specat.

— Kënaqen kalamajtë me to (tregon perimet kuzhinierja) e na kënaqemi me kalamajtë, që i kemi si top sheqeri. «Si kokrra e mollës», — shton ajo me hak, thua se tha pak për ta «top sheqeri»!

— A jua vjedhin? — pyeti një nga shokët që kish ardhur me mua nga «Bajram Curri».

— Jo, bre burrë, se asht gjynah!

— Nuk ka si me vjedhë kush kopshtin te na, kur ka kalamajtë e vet, — sqaron Shkurta, kryetarja.

— Yti është ky? — pyes kujdestaren, duke përkëdhelur foshnjën gërnjare që mban ajo në duar.

— Mos e thuej atë fjalë, — skuqet ajo. — Fëmijët, e mi i kam të rritur e më shkojnë në shkollë.

— Ani, moj! — ia kthen Shkurtë kryetarja. — Fuqia e gruas te djepi matet.

Gëzohem me këto gra dhe më vjen të qesh,

me këtë njësi të re matëse të fuqisë së gruas. S'më kish shkuar mendja për të.

— Sa për bahçen, — thotë, si për të ndërruar muhabet kuzhinierja me përparëse të bardhë të zbërthyer, nën të cilën duket futa e zezë e malësores, — nuk ka qenë kuvendi ynë. I ka shkue mendja së pari kryetares, Shkurtës sonë, kur na ka porositë e na ka thanë: pse mos me i ba vetë njomishtet për vocrrakët? Ajo e pleqnoi kështu e na ia pamë shpejt hajrin fjalës së saj. U nderuam me nanat e fëmijëve dhe, pse jo, edhe me ju, baballarët e tyne! — u drejtohet ajo dy shokëve të fshatit që na shoqërojnë.

— Po, moj, po! — gati sa nuk briti kryetarja Shkurtë. Porosi na të gjitha japim e dimë me dhanë edhe ma shumë, por puna asht kush di me ba zarzavatet! Unë llafin e ti punën! Dhe sa për fjalë, oj ti, Shaqe e Martin Çamit, nuk i kemi ba, bash, kështu si kuvend kostarësh të urtë, por me do inat.

— Inat me bereqet, — e përkrah kuzhinierja kryetaren.

— A të kujtohet ç'të thashë asaj dite: «O të rritësh njomishtet për kalamajtë, a, përndryshej, a unë, a ti në punë të shtetit! Ose ti dorëzo grykësen e bardhë e faqja e zezë, o unë dorëzoj çilësat e këshillit dhe harram vota e popullit!» Po ty të lumtë, edhe shoqeve u lumtë, se e kenë hallall bukën. E kabull llafet që kemi ba. Kështu, or ti, shoq! — më drejtohet mua tani kryetarja Shkurtë. — Fjalët dimë t'i themi të gjithë bukur fort, besa dhe ma mirë se ai që i thotë lajmet në telvizor, por i zoti asht ai që ban punën e ushqen kalamajtë. Apo e kam gabim, bre, burrë i dheut!

Hiç fare s'e ke gabim, o shoqja Shkurtë, që, siç ke emrin, ke edhe llafin e t'i pret drutë shkurt e drejt, — bëj t'i them Shkurtës e s'i them dot, se, ndërkaq, një nga çunat e kopshtit del e thërret në korridorin e vogël sa një tavolinë bilardoje:

— Oj, nanë, a të dal përjashta, se ka ardhë dada?

«Nënë» çuni i vogël thërriste kujdestaren, kurse të ëmën që e kish pjellë e që kish ardhur ta merrte, e quante dadë?

Ç'të të rrëfej më për këto gra? Ç't'ju them akoma! Ato nuk kanë nevojë, mbase, fare për nderimin tim, se ato i nderojnë nënat që u kanë besuar fëmijët e gjirit. Por shpresoj që fjala e mirë për to nuk do vejë si dhjamë qeni për të tjerët. Mbase ata që kanë më shumë fuqi e mundësi se këto gra të urreta të Perrajve, do të vihen të mendojnë: pse nuk ngjajnë një çikë me to!

Ah, po, se për pak harrova t'i vë kokën tregimit, t'u them emrat e tyre. Kuzhinierja e kopshtit të Perrajve quhet Shaqe Martin Cami, kujdestaret janë Shkurte Mucaj e Drane Pervataj dhe kryetare e këshillit Shkurte Gjoni.

Ju dëgjofsha gjithnjë të mirën, o gra kapedane! Dhe më falni nëse ju rëndova disi me dyshimin tim të parë. Të shkuara e të harruara! Kurse ju të tjerët paçi fat e ú takofshi me to!...

Nëntor 1988

Mos ik nga Vlora, pa takuar Nestorin!

Sa herë dëgjoj për Llakatundin, më kap një nostalgji për fëmijërinë. Është pak e pabesueshme, por nuk gaboj kur them se mua më ka qëlluar që, përpara se të shoh fshatin e lindjes së prindërve të mi, kam shkelur Llakatundin.

Miku im, piktori i njohur Skënder Kamberi, me atë temperamentin e rrallë të tij, më dha lajmin e gëzuar që Nestor Jonuzi, piktor tjetër vlonjat me zë në artet tona, hapte ekspozitën vetjake në Llakatund. «Do bësh gabim të madh po ike pa e parë. S'ta fal dot po ike», përsëriti ai. Dhe unë nuk ika nga Vlora pa vajtur rishtas në Llakatund.

Gjatë 35 vjetëve që kur udhëtova për të parën herë atje, s'më kish rastisur të kaloja andej. Ekspeditat gjeologjike dhe në Romësin pra-

në tij më shpunë, por ja që atje, në vetë Llakatundin s'kisha shkelur dot më. Pra, kisha mall dhe një borxh për të larë. Ca më tepër që kishte dhe një dasmë të tillë, ekspozitë pikturë. Dhe që të jem i sinqertë deri në fund, me vete kisha dhe djalin tim katërmbëdhjetëvjeçar, që s'e kish parë as Risilinë e as Llakatundin. E përmend tim bir vetëm si sebeb, për të kuptuar që 35 vjet të shkuar, kur unë isha një çik më i madh se ky, pashë për të parën herë këtë fshat.

... Atë korrik të vitit 1948, martohej halla ime në Vuno. Nga dera jonë u hë do të isha krushk i dytë; krushk i parë ishte barba im, snofer në Vlorë, tek i cili kisha hedhur spirancën e bujta disa ditë, para se të ngrihesha në përgjegjësinë e lartë të krushkut të dytë në dasmë. Barbës tim i duhej të merrte leje nga parku, unë isha me pushime shkolle. Për të mos u mërzitur i vetëm në shtëpi, në vapën vlonjate (në plazh barba s'kishte kurajë të më linte të shkoja pa njeri), ai më mori e më gjezdişi ato ditë në sharrat e Llogarasë; aso kohe atje priteshin trungjet e pishave për hekurudhën, më thoshte barba, siç duket për traversat e saj. Atje u njoha me pishën-flamur dhe me malet e Çikës e Qorrës, me Palikonjën e Palickën, me Ravenën e Karaburunin. Sot Llogaraja është park kombëtar që mbrohet nga shteti. Qeshë disa herë në Lumë të Vlorës dhe u dashurova me të për tërë jetën. Pra, siç e shihni, unë shëtita e shkela sterenë, kurse deti ma bënte me sy. Dëgjova më përpara për bejlerët e ligj të Risilisë, sesa për kocet e Dukatit, në udhën gjithë pluhur të Llakatundit. Dhe pikërisht këtu, në këtë rrugën me

gropa dhe që zgjaste shumë, në kabinën e «Renaultit», që asnjë nuk i thoshte «Reno», barba më pyeti:

— A të ka thënë mëma me kë martohet hallajote dhe motra ime?

— Posi, — iu përgjigja më i sigurt, — me një burrë...

— Me burrë po, xhanëm, se smartohet vajza me grua, — më ndërpreu dhe qeshi ai, — por...

— Me oficer, — shtova unë një informacion më të saktë.

— Mirë, oficer, mirë, — tha ai, — po mysliman, këtë a e di?

— Nuk e di, — i thashë unë. Po bukur fare, se do shqepemi me bakllava për bajram.

Ai qeshi me të madhe. Nuk e priste bajramin e bakllavanë. Ai vetë s'vuante as për bajramin, as që kunatin e kish mysliman, vetë ishte komunist, por e hante merakun mos nëna ime kishte ndonjë paragjykim ndaj burrit të hallës, myslimanit nga Tepelena. Barba im i dashur nuk e dinte që gjithë gjitonët tanë në rrugën e Kusit, prapa Shkollës së Kuqe në Tiranë, ishin të gjithë muhamedanë, tiranas safi, dibranë dhe çamër muhaxhirë. Dhe unë bonjaku i kaurtë festën më të madhe kisha bajramin, se çdo nikoqire e tyre më qeraste me bakllava ose kadaif. Dibrankat bënin të lezetshme shumë dhe sheqerparen. Për mua festa më e madhe që ajo, dhe kam frikë se unë qeshë më i privilegjuari fëmijë i mëhallës ato ditë. Kështu që muhabeti, dhe barba im dhe unë, sa herë që bisedojmë sot për hallën time e motrën e tij, e kujtojmë «hallë

«bakllavaja», aq sa disa herë e ngatërrojmë e na tingëllon si hallvë bakllavaja.

E bëra këtë prolog të vocërr, sepse thashë që me mua këto ditë në Llakatund qe dhe çuni im, që e dëgjoj këtë bisedë, bashkë me Skëndër Kamberin dhe shoferin.

Pra e kuptoni tani pse është i dashur Llakatundi për mua, për hallën time të urtë, që e para në fshatin tonë u martua me një mysliman. Këtë kujtoj unë për të nga fëmijëria ime, kurse im bir do të kujtojë me nipërit e mbesat e tij, kur të bëhet plak, që ne vajtëm atje për ekspozitën e Nestor Jonuzit, e pamë dhe na pëlqeu. Dhe tani le të futemi në shtegun që duam.

Ekspozitë, pikturë në fshat sot nuk është një gjë e jashtëzakonshme, por dhe e rëndomtë fare nuk është.

Unë nuk fola për atë që sheh njeriu rrugës, për në Llakatund, për grurin dhe pjeshkët, për ullinjtë në të dalë të Risilisë dhe rrugën me asfalt, për kodrat e kthyerë të gjitha në brezare, që duken si katundarë të Shqipërisë së Mesme, që e kanë pështjellë brezin e stërgjatë disa herë rreth mesit. Nuk ju fola për detin që duket tutje thellë, kur hipën në këto kodra dhe as për malet e Drashovicës që ngrihen matanë. As për Vjosën që të verbon më tej. Nuk ju fola, mbledhë të gjitha, as për njerëzit e Llakatundit sot, fermës më të vjetër bujqësore të rrethit të Vlorës. Të

gjitha këto, po të doni t'i njihni, i shikoni, më mirë se ç'mund t'i përshkruaj unë, në ekspozitën e Nestorit.

Ekspozita është e madhe, 70 punime me bojëra vaji, 10 akuarele dhe po kaq skica. Në to kudo ndien zemrën e ngrohtë dhe dorën e shka-thët të mikut artist për njerëzit dhe bukuritë e fshatit. Për mua më të bukurat vepra në ekspozitë janë peizazhet. Ka diçka në to nga gjerësia e Mios, diçka nga faktura e Sali Shijakut, por gjithçka nga origjinaliteti i Nestorit. Peizazhe gjithë dritë, ku prarojnë pjeshkët e qershitë me lule, që ngjajnë si nuse me vello mbushur dantella e qëndisma të rralla, ku bie erë gruri dhe ku gruri vetë ta bën me sy dhe t'i ndien në të erën e bukës së pjekur. Dhe një zë i largët i të lashtëve të vjen të thërrasësh «Mashallah, plastë syri i keq!» Njerëzit janë të pikturuar në portrete: të mençur, të thellë (mbase dhe sepse Nestori ua vizaton sytë pak si të vegjël, si sytë e vet), që të shpojnë tej për tej e duket sikur të peshojnë se sa të vlen lëkura. Njerëz të tillë ka në portretet e tij, që dëshiron patjetër t'i njohësh nga afër, të bisedosh me ta jo në telajo, por në një konak për ndonjë hall që ke. Janë të tillë, që u beson dhe bëhesh pak ziliqar që Nestori ka miq të tillë. Në këto raste ngushëllohesh me urimin: «Paça dhe unë miq e shokë të tillë!»

Ekspozita u hap sapo kish mbaruar korrja e grurit, lëmenjtë ishin plot dhe atje bëhej festa e bukës së re. Plot ishte dhe lëmi i Nestor Jonuzit, ekspozita e tij e pasur që po përurohej dhe vetvetiu atë ditë në Llakatund bëhej dhe festa e artit. Dhe kjo korrje e bollshme e Nestorit ishte

fryt i punës së një stine. Ai punoi në këtë fshat katër muaj. Dhe besoj se kanë të drejtë shokët e Shtëpisë së Kulturës, kur shkruajnë në fletëpalosjen e ekspozitës se në portretet e realizuara me mjeshtëri të piktorit njih njerëzit e mirë, bujkun e nderuar, heroin e punës, njih ata që i marrin tokës prodhime të begata. Po të pasqyrojnë që të gjithë punëtorët e dalluar të fermës, piktorit do t'i duhej një jetë e tërë. Kjo është e vërtetë, por është edhe më shumë e vërtetë ajo që Nestori këtu zbuloi një minierë të madhe, ku ka vend për të nxjerrë «mineral» jo vetëm ai, por dhe piktorë të tjerë. Patjetër galeria e vetë Nestorit do të pasurohet në vitet që vijnë me vepra të tjera, portrete e peizazhe më të bukura, që do të kenë frymëzim këtu në këtë tokë, te ky gëzim i grurit dhe i jetës, te kjo begati e ditëve të Partisë, te këta njerëz që ngrenë botën e re.

Nestori është sot para një ngjarjeje të re, ekspozita po e po, por dhe ajo që këtu në fshat ai gjeti «studion» e vet, gjeti modelet, atë për të cilën vuajnë sot disa piktorë e skulptorë. Ai s'ka nevojë të riprodhojë fotografitë në telajo, siç bëjnë disa që s'lidhen me modelet e jetës, ai hedh me dashuri e gjerësi në kanavacë jo fotografinë, po vetë jetën, natyrën dhe njerëzit e saj. Kjo është gjë e madhe për artin, për artistin, se kështu, në këtë rrugë dhe vetëm në këtë rrugë, ai s'bie në skematizëm, në natyralizëm, në shabllone bëjate, gjëra që sa vjen e më fort po i kritikojnë masat e gjera dhe vetë njerëzit e artit. Vetëm kështu ai siguron atë lëngun e madh të jetës, që është gjaku që mban të gjallë artin për jetë të jetëve.

Natyrisht, një jetë të tërë Nestori nuk do të punojë vetëm me Llakatundin, jo. Por një jetë të tërë ka rëndësi që ai të lidhet me njerëzit e punës dhe këtu ai tashmë vërteton se e ka gjetur çelësin e florinjte. Le të mos e humbasë këtë çelës, pa të tjerat vijnë vetë dhe me siguri nesër pasnesër përsëri do flasim për të.

Gusht 1983

Njeriu i 110 fytyrave

Kur ishim fëmijë, në vitet e para të Çlirimit, shpesh luanim me pllaka guri dhe kush fitonte prej nesh, kishte kënaqësinë t'i merrte shokut ndonjë copë filmi me artistë kinemaje. Të gjithë artistët ishin të huaj, nga Çineçitaja deri tek Hollivudi. Ndërronim asokohe një Sharlot me dy ose tre «I holli me të trashin», një Geri Kuper me dy Linstroken, pesë Tom Tylerë me një Tarzan. Emrat e tyre i njihnim, portretet e tyre i shihnim përditë në copat e filmave që mbanim nëpër duar si letra bixhozi, po filmat e tyre nuk i shihnim dot. Nuk kishin prindërit tanë të holla për një luks të tillë, për bileta kinemaje. Ç'eshtë e vërteta, ngandonjëherë, çanim nëpër këmbët e të rriturve, para syve të portierve, vjedhurazi, për të parë ndonjë film në kinema... Atëherë kam parë për të parën herë Kadri Roshin, që punonte si biletashitës në kinema -Glo-

ria», sot «Republika», në Tiranë dhe çoku na fuste ndonjëherë, më të rrallë, për mik pa biletë. Kadriu s'mban mend, por i vogli nuk e harron dot më të madhin...

Më vonë pasioni ynë për portrete artistësh vazhdoi dhe u rrit në dashurinë për filmin e teatrin. Ishin ato vite kur filloi te ne të flitej për këtë ose atë artist të huaj, që ishte njeriu i dyzet fytyrave, i pesëdhjetë fytyrave deri dhe i njëqind fytyrave. Ishin rolet që kishin luajtur ata në filma. Sa për filmin, artistët tanë shqiptarë nuk kishin aso kohe asnjë «fytyrë», sepse nuk kishim fare kinematografi tonën. Dhe pa kaluar mirë një çerek shekulli nga filmi ynë i parë artistik «Tana», ku Kadriu luajti rolin e parë, ne sot flasim me gojën plot për artistin e njëqind e dhjetë fytyrave, për Kadri Roshin.

Kur ishim ne fëmijë, njihnim vetëm artistët e huaj të botës. Fëmijët sot njohin, si prindërit e tyre, artistët tanë. Portretet e tyre nuk i sheh në xhepat e pantallonave të shkurtra të çunave, por në albumet e nxënësve të shkollave dhe në xhamat e makinave të vëna nga shoferët sev-dallinj të kinemasë. Kanë ndryshuar kohërat, kanë ndryshuar dhe zakonet e lojërat e fëmijëve.

Kemi dëgjuar shpesh e shumë nga ne e dimë që Dhimosteni, oratori i madh i Greqisë së lashtë, vuante nga belbëzimi. Atij i merrej goja dhe me të tillë huq zor e kishte të mbante fjalime, ndaj, për të shkoqitur fjalët, thonë, përditë të tëra ushtrohej buzë lumit a anës detit për të dëgjuar jehonën e fjalëve të veta. U mundua shumë greku i shquar dhe arriti një ditë atë që kërkonte, forcën aktorese të oratorit. Por,

në fund të fundit, Dhimostenit i mjaftonte dhe kaq, boll të hidhte në papirus mendimet apo idetë e tij dhe prapë do të mbetej në histori si një mendimtar i zoti, si shumë grekë të tjerë të mënçur.

Kujtoni tani sa vështirë, gati të pabesueshme, e ka pasur Kadriu ynë, i cili në fëmijërinë dhe rininë e vet po kështu i merrej goja, si grekut të dëgjuar, por që po kështu, në mos më shumë, luftoi të bëhej jo orator, por aktor. Dhe ç'aktor se, një nga nikoqirët më të zotë të skenës dhe të ekranit tonë! Konkuroi për të hyrë në trupën e Teatrit Popullor dhe dy herë radhazi u rrëzua në provimet e artit, dhe jo pa arsye, siç ndodh ngandonjëherë sot me komisionet e provimit në Institut të Lartë të Arteve, por se kishte cenin më fatkeq për teatrin. Ç'vullnet dhe dashuri për teatrin duhej të kishte ky njeri, që të kapërcente gati të pamundurën! Dhe arriti më në fund atë që dëshiroi prej vitesh. Sikur vetëm vullneti dhe pasioni i Kadriut t'u shërbente model artistëve të rinj, çfarë çudirash mund të bënin ata sot në art!

Nuk e teproj dhe as ngurroj të them që Kadri Roshi është pa dyshim një nga ato talente që kanë malet e artit me një punë titanike.

Dua të tregoj diçka nga jeta e tij, jo për t'i bërë biografinë, por për të argumentuar atë që sapo thashë, punën e mundin që i është dashur për artin. Dhe si për çdo gjë, por mbi të gjitha për artin duhet punë, punë dhe sakrifica. Nejse... Ai lindi në fshatin e djeshëm. të humbur, të Ballshit, jo në atë të përpunimit të thellë të naftës, siç është sot. Dymbëdhjetë vjeç mbeti jetim

pa nënë, gjashtëmbëdhjetë vjeç, sikur nuk i mjaftonte vdekja e nënës, mbeti edhe pa baba. Më i vogli nga fëmijët, më shëndetligu ndër ta, detyrohet të fillojë punën e punëtorit të krahut në Kavajë. Mbas disa muajsh, si rolet në premiera të reja, ndërron zanat e bëhet pjatalarës në Durrës. Pastaj kthehet e bëhet çirak e shegert (besoj se e kuptoni pse aq bukur e luan Osipin tek «Hlestakovi») gjithnjë i uritur dhe punëtor ngarkimi-shkarkimi i çimentos. Punon dhjetë deri dymbëdhjetë orë çdo ditë. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, arrestohet e burgoset disa muaj nga pushtuesi. Punon pastaj si biletashitës në kinema «Gloria». Unë e kuptoj mirë atë, që ai nga fëmijëria mban mend vetëm atë dëshirën, më budallaqe për fëmijët e sotëm, të vishte qoftë dhe për një të diel këpucë! Kur Kadriu u fut punëtor teatri dhe prej andej shkoi për studime në shkollën e lartë dramatike, ishte një diçka pa precedent, ai kishte bërë vetëm shkollën fillore!

Gjithsesi kjo jetë tepër e zymtë, por bukur shumë e pasur me ngjarje, njerëz, e jetë e ndihmoi dhe e ndihmon atë që të jetë mjaft realist në lojën e vet.

Në gjashtëdhjetë vjet të jetës së vet, gjysmën, plot tridhjetë i ka kaluar si aktor i Teatrit Popullor. Ai e ka filluar punën si artist, pa dyshim, ca si vonë, tridhjetëvjeçar, por ama në këto tri dekada të jetës prej aktori ka punuar me një inat e merak të tillë, sikur ka dashur të mbushte atë boshllëk që i qe krijuar në këtë vonesë kaq të madhe në orarin e trenave të skenës dhe të ekranit. Dhe kjo përpjekje e tij, për ta

mënjanuar këtë vonesë duket qoftë edhe me faktin që ai luajti në tridhjetë vjet tetëdhjetë role në teatër dhe tridhjetë në kinematografi. Pra, gati çdo vit nga tre role. Tepër për një kohë të shkurtër, vetëm për një njeri, qoftë ai dhe aktor i talentuar shumë; pak për pasionin, sedrën dhe punëdashjen e Kadriut. Në këto role ai luajti nga të gjitha llojet e karaktereve njerëzore, nga përfaqësuesit e të gjitha klasave, nga figurat dhe personalitetet e të gjitha kohërave të historisë, nga më të mirët deri te më të ligjtë. Sillni ndër mend Kadriun dhe vetvetiu do kujtoni Abdyl Frashërin e Haxhi Qamilin, Ezopin dhe Arturo Uinë, Hamletin dhe Jagon, Bektash Shkozën e Murat Bënçën, Marko Ruvinën e Mithat Beun e shumë e shumë të tjerë, që, po t'i renditnim, do zinin faqe të tëra të shkrimit tonë. Por siç është i kursyer Kadriu për veten, le të jemi dhe ne të kursyer në listat për të.

Artisti i Popullit Kadri Roshi është nga artistët më kombëtarë e më të dashur të skenës e të ekranit tonë. Natyrisht, jo vetëm për numrin e madh të roleve, kurrsesi jo! Ka dhe aktorë të tjerë që mund të kenë shumë role, mbase edhe më tepër se ai, por që nuk kanë mundur të skalitin portretin e tyre në pllakën e gurtë të kujtesës së popullit. Kadriu është i tillë, ai është i dashur për çdo shtëpi tonën, se ka botë të madhe ndjenjash, ka jetë nga jeta jonë, ka dëshirat dhe ëndrrat e gjithsecilit prej nesh, se ai është nga ata që janë majaja që mpiks brumin e bukës së artit tonë.

Ndoshta është forca e madhe e fjalës së tij, që, siç thotë regjisorin ynë Piro Mani, ka një vle-

rë vepruese të pashoqe. Paradoksi i paradokseve! Pikërisht ai që nuk shqiptonte dikur tamam fjalën, është sot mjeshtri, ustai më i madh i fjalës së kënduar. Nuk lajthit që them *i fjalës së kënduar*, se vërtet gjuha jonë, shqipja jonë merr ritmin e këngës, merr ngjyrat e saj, kur del nga goja e tij. Në fjalën e tij ka kaq gjerësi e hapësirë polifonike, sa shpesh të kujton këngët labe a harmoninë e zileve e këmborëve të tufave të Nemërçkës dhe Malit të Gjerë. Kush e dëgjo një herë recitimin e poezive të Naimit nga Kadri Roshi dhe i harroi? Kujt i kumboi një herë në teatër fjala e tij dhe s'deshi ta shijonte prapë? Kush pa filmat e tij dhe përtoi t'i shihte përsëri? Askush dhe kurrë s'ka ndodhur e s'ndodh me të një e tillë gjë. Ai është patriarku i fjalës artistike.

Dritëro Agolli ka thënë njëherë se, kur sheh si i luan rolet Kadriu, të bën të dëshirosh që edhe ti të jesh aktor si ai. Por ja që dëshirat shpesh mbeten vetëm dëshira, qofsh ti dhe kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Të jesh aktor i madh, duhet të jesh martir i artit, të flijosh për të nga jeta jote. Dhe nuk e teproj kur pohoj se Kadri Roshi është nga të tillët, martir i së bukurës në art. Ai e shokët e tij më të shquar të skenës dhe të ekranit arrijnë atë që thotë shoku Enver Hoxha se «.... për ne bukuria qëndron në radhë të parë në interpretimin e artistit në mënyrë sa më të përsosur, sa më natyrale, sa më afër njeriut, që takohet realisht në jetë, në punë, në përpjekje, të shkrirë me mendimet dhe me aspiratat e tij. Për ne jashtë këtij realiteti të pasqyruar edhe në ekranet tona, nuk

ka bukuri. Po nuk pati këto karakteristika, po nuk u panë në sytë e tij ajo bukuri dhe freski mendimi, ajo pastërti e jetës së njerëzve tanë, artisti, sado i bukur që të jetë fizikisht, nuk vlen».

Një nga këta njerëz të afirmimit të së bukurës sonë socialiste, të shpirtit të pastër në art është dhe Kadri Roshi. Pa dyshim, ai nuk shquhet për bukuri fizike apolloniane, por ka bukurinë e rrallë e të madhe të shpirtit e mendimit të njeriut që i do dhe sakrifikon për njerëzit, të artistit që çdo gjë të mirë të tij e ka vënë në shërbim të popullit. Është kjo bukuri e pashtershme shpirtërore prej artisti të vërtetë, jo mikroborgjez, që e bën atë të shprehet, siç tha në ditën e kremtimit të 60-vjetorit të lindjes se «... ne artistët shqiptarë kemi fatin e madh që na frymëzon dhe na edukon publiku ynë i mrekullueshëm, populli ynë i madh, Partia dhe sho-ku Enver, që na respektojnë e na vlerësojnë aq shumë, siç na falin po ashtu aq shumë, sa na bëjnë borxhlinj të përjetshëm me një borxh që nuk lahet «kurrë»! Kështu thotë artisti Kadri, dhe ne do të shtonim: borxhe të tilla si ai paçim dhe, ne miqtë e dashamirësit e tij, gjithë jetën.

Unë nuk jam ziliqar, por, tek shoh e dëgjoj Kadriun, nganjëherë them me vete: «Ja, të tillë fat të kesh në minierën e thellë të artit, siç ka ai, që në çdo rol gjen një damar floriri.»

... Kam qenë në Libohovë shpeshherë. Kam pasur fat! Atje kam parë për herë të parë ko-

buren me të cilën Avni Rustemi vrau Esat Pashën në Paris. Atje kam prekur gunën me të cilën Avniu mbulohej netëve në malet e Tepele-
nës, tek bënte zanatin e mësuesit. Atje kam parë kalanë e Ali Pashë Tepelenës dhe varrin e Shani-
shasë, motrës së tij. Atje, tek shikoja rrënojat e kullës së tij, kam marrë me mend gjëmimin e sahatit të Libohovës, që thonë se dëgjohej deri në Gjirokastër e në Delvinë. Atje kam ngrënë bukën gjithë aromë e shije, më e lezetshme se dhe «keku» më i mirë i furxhinjve libohovitë, që janë mjeshtrit më të aftë të gatimit të saj në Shqipëri! Jo, në gjithë Ballkanin. Thonë se sekreti i kësaj buke është tek ai uji i jashtëzakonshëm, akull e i lehtë sa s'bëhet më, që buron terrapi i lashtë e i madh sa një mal i Libohovës e që i mpleksen degët e rrëmbat si degët e dhrisë e gërshetat e vashave, e që, kur i sheh poshtë nga burimi te këmbët e tij, duken si ornamente të tavaneve gjirokastrie të qëndisura në qiellin e kurores së tij. Thonë se, ngaqë është uji kaq i mirë, bëhet dhe buka kaq e shijshme. Llafe! Nuk besoj dhe as ju mos e besoni. Ujëra të tilla si këtu, e psejo, edhe më të mira, ka në shumë male të Shqipërisë. Unë që i kam provuar, di se ç'flas. Ujëra si këto ka shumë, furxhinj si libohovitët ka pak. Ç'lidhje ka kjo Libohovë me Kadriun, do të thotë ndokush. Prit, bre shok, mos u ngut! Mos jini kaq i rreptë me mua. Bëj durim dhe ca. Besomë se ka një lidhje midis tyre, dhe aspak të vogël! Vërtet Kadriu ka lindur në Ballsh, por tatën e mëmën i kish nga Libohova dhe këtë e mora vesh një vit kur pashë muzeun e saj dhe zbulova që Muhin Roshi, gjyshi i Kadriut, na kish pasë luaj-

tur në «Besën» e Sami Frashërit deri në qytetin e Janinës, në kohën e xhonturqve, më 1908. Ja, pra, që paska lidhje Libohova me tradita me artistin Kadri. Dardha nën dardhë bie. Nuk thohet kot «bëmë, o baba, — më falni, — bëmë, o gjysh, të të ngjaj»! Mbase atij Muhinit të Roshet, gjyshit që luante teatër deri në vilajet të Janinës, i ngjan Kadriu? Si do që të jetë, ai pasion i tij aq i madh për teatrin, saqë e bëri të shesë bileta kinemaje dhe, kur s'fitoi konkursin për aktor, filloi të punojë edhe si punëtor skene, me siguri lidhet me këtë traditë familjaro-libohovite për teatrin.

Kadri Roshi për mua është nga ata që s'ngopet kollaj me lëngun e jetës artistike dhe as kënaqet me veten e me atë ç'ka bërë. Kjo është themelore. Ca kohë më parë ai na tregonte pse s'ishte i kënaqur kurrë nga vetja si aktor. Pak a shumë i kishte ndodhur kjo ngjarje:

Ai, krahas teatrit, që është vetë jeta e tij, do shumë dhe natyrën. Dhe nga kjo dashuri për natyrën i ka lindur prej kohësh ai «hobi», sic thonë anglezët, për peshkimin.

Kish dalë një ditë për peshkim në Brezhdan të Beratit. Jo tek Ura e Osumit, as tek Ura e Pashait në Goricë, por te rezervuari i Brezhdanit. Në Berat xhirohej filmi; deri në Brezhdan një orë punë është në këmbë. Nuk e dinte apo bënte sikur nuk e dinte, se kur vjen puna për peshk dhe Artistët e Popullit «harrojnë» diçka

nga rregullat, por puna është se në rezervuar nuk duhej peshkuar, se sapo ishte lëshuar peshku në të. Ç'ta zgjatim, Kadriu hodhi grepat dhe e zuri rojtari i rezervuarit.

— Ç'bën, more, kështu? Ku ke marrë leje që gjuan këtu? Nuk e di ti që sapo kemi lëshuar peshkun? — i thirri rojtari.

— Nuk e di, — u shfajësua Kadriu, — ku ta di unë i varfri. Unë vij nga Tirana. Pashë rezervuarin, ujë plot. Takova fëmijët, i pyeta a ka peshk, më thanë «peshko, o xhaxhi, peshko» dhe ja, erdhe ti e më zure, erdhe ti e më qorton.

— Ashtu?! — u çudit rojtari me naivitetin e artistit. — Erdha unë e të qortoj! Ç'qortim, more? Nuk ke turp, pse kalamaqërit beson ti? Ka zot vendi, dëgjon!

— Më fal, or mik, nuk e dija... — deshi ta merrte me të mirë rojtarin e sertë.

— Ç'mik, more! — kundërshtoi me tërsëllëmë rojtari. — Nga na dole mik! Gjuan peshk kontrabandë dhe më thua mik. Mik u thua j shokëve të tu ti dhe jo mua! Dëgjove? Dëgjova, thua!

— Dëgjova! — tha Kadriu. Kaq deshi ai që të vinte maraz me rojtarin. Si nuk e njohu fare! Ku vanë gjithë ata filma? E kuptoi, ishte zhveshur nga brezi e lart, me kapelë kashte mbi krye, kështu që zor ta njihte edhe shoku i tij i ngushtë Lazër Filipi e jo më rojtari i Brezhdanit. Veshi shpejt e shpejt këmishën, hoqi kapelën e kash-tës dhe, duke tërhequr gjithë zemërim fildispanjën, tha si për vete, por që ta dëgjonte dhe ai tjetri, rojtari: «Tërhiq, Tare, tërhiq, se atje kam peshkun e ngordhur unë.»

— Ou, — tha rojtari. — Edhe tallesh tashti! Më luan edhe teatro. Nuk është ashtu siç thua ti, o kontrabandist rezervuari! Jo! Ai në film i thotë «Gërmo, Tare, gërmo, se atje kam qenin e ngordhur unë!» Ja, kështu i thotë, e mos shit mend kur nuk e di, o kontrabandist!

— Jo, more! — bëri sikur u habit Kadriu dhe e pa me atë shikimin gjithë ironi e tërbim, që sheh ai kulaku i filmit «Përballimi», kur i gjejnë grurin.

Vetëm atëherë rojtari e vuri re kush ishte. E njohu që ishte artisti i filmit, që ai pëlqente aq shumë dhe tha:

— Pika mua! Pika, o Ahmet, me kë bëj muhabet. Por ti qenke kulaku, bre! Ja Abaz Ali, ja Çukë e Tomorrit! Po ti qenke i ligu që fshihte grurët, a të hëngërsha grurët! Ec përpara, — urdhëroi si me inat, duke vënë buzën në gaz rojtari. Kadriu, që më në fund arriti të «dema-skojë» veten dhe të bëhet i njohur nga rojtari, i tha:

— E, më në fund, më njohe tashti. Dhe thua se s'më ke mik. Po mua çdo javë më ke mik në shtëpinë tënde, herë me film e herë me teatër në televizion.

— Llaf me mend, — i dha të drejtë rojtari artistit, — llaf me konak. Kabull! Mik të kam dhe ç'mik se! Se për ty kalamajtë lënë mësimet e zihet plaka me ta, që në vend të këndojnë de-tyrat e mësueses shohin xha Kadriun, herë si vritesh e herë si ngjallesh. Pa, pa, pa, ç'burrë i zoti që je, për çdo javë ndërrohesh si me magji!

Kadriu qeshi. U gëzua dhe s'i vinte hiç keq që e zuri ky rojtar i çuditshëm.

— Hajde, — i tha rojtari, — hajde, aman, për darkë sonte tek unë. Do të kënaqen çilimijtë dhe do patakset gjithë fshati për një mik si ti.

Dhe artisti vajti për darkë te miku i ri. Gëzoi me fshatarin rojtar, me fëmijët dhe me gjitonët e tij. U bë vetvetiu një mbrëmje e gjatë «tematike», një nga ato diskutimet krijuese më të bukura për teatrin e kinematografinë, sa t'ia ketë zilinë edhe klubi i Shkrimtarëve dhe Artistëve në Tiranë, jo më vatra e kulturës së fshatit.

Dhe tek darkonin fëmijët bashkë me nikoqirët e shtëpisë, Kadriu përsëriti atë frazën e njohur të kujdestarit të filmi «Lulkuqet mbi mure»: «Hani, ju, hani!» Dhe shtoi nga xhepi, jashtë skenarit të filmit: «Po unë pa peshk mbe-ta». Qeshën fëmijët, qeshën dhe nikoqirët. Dhe pa dashur dola tek ajo, që në disa raste Kadriu i përsërit fjalët dy herë: «Hani, ju, hani», «Gërmo, Tare, gërmo!» etj. Mos kjo është forma relikte e fosilizuar a mbase një lloj atavizmi i kohës kur atij i merrej goja? Jo! Nuk është, natyrisht, kjo. E shumta, nëse i ka vlejtur kjo ish-dobësi e tij ndonjëherë në teatër, është vetëm në rastin e rolit të Mithat Frashërit, që i merret goja tek «Epopeja e Ballit Kombëtar» të Shevqet Musarajt. . . Ja, pra, kjo përsëritje e qëllimtë e tij bëhet kur di se si, dhe fjalë fare të rëndomta, të zakonshme sa nuk ka ku të vejë më, t'i bësh me jetë, t'i gjallërosh, t'i rritësh, t'i bësh të peshojnë rëndë si gurë.

Kadri Roshi ka gërmuar tërë jetën në malin e artit dhe thashë diku më parë se ka qenë minator me fat, se në çdo rol ka zbuluar damar floriri. Dhe në këtë minierë të pashtershme të artit

shqiptar të realizmit socialist ai ka për të hapur
edhe shumë galeri të tjera, se ai është usta i
rrallë i kësaj miniere, që vitet nuk e largojnë,
por e afrojnë sa vjen e më shumë me zemrën e
minierës së arit të artit, popullin. Mot e më shu-
më i urojmë ne, mot e më shpesh në skenë e në
ekran. Gërmo. Kadri, gërmo e mos vdeksh kurrë!

Dhjetor 1984

Nderim për mësuesin

Para pak ditësh në studion e piktorit të njohur Zef Shoshi, tek shfletoja albumin e tij, hasa në një fotografi të vjetër të klasës së parë të vitit shkollor 1945-1946. Ne kemi qenë aherë me Zefin në një klasë. Në fotografi jemi disa çuna e goca të vocrra, të pastër akull, të urtë si jetimët, të dashur si fëmijët. Midis nesh në fotografi feks si një llambë e madhe, gjithë dritë, mësuesja jonë e parë, ajo e klasës së parë.

Si gjithnjë në të tilla raste, kujtojmë shokët ku janë, por mbi të gjitha kujtojmë mësuesen e parë, atë që e rrethojmë në fotografi nga të gjitha anët. Pse e sjell ndër mend atë si mëmën time?

Asokohe, kur unë vazhdoja klasën e parë fillore, nëna ime sapo kish filluar kursin kundër analfabetizmit. Nuk bëj paralelizëm letrar, por është e vërteta açike e jetës sonë, në vitet e para

të pasqirimit: të dy mësonim shkrim e këndim. Por si ajo edhe unë nuk kishim as libra, as fletore. Sime mëje i qe vrarë burri, ajo ishte e ve e unë isha bonjak. Aherë mësuesja më fali librat e saj. Abetaren e parë e pata dhuratën e parë në jetën time.

Atë vit bënte shumë ftohtë. Thahej druri e guri nga grica. Klasën e parë e kujtoj shpesh si sinonim të të ftohtit. Ne, fëmijët, duart i kishim gjithnjë gjak të kuqe, si mish krap.

Mësuesja vinte para nesh në klasë, një orë ose gjysmë ore, (mbase ngrihej herët, që me natë, se mbante radhën e gjatë për bukë në furrë) dhe na ndizte sobën. Përjashta ishte akull, por ajo klasa jonë e vogël, ajo ish-baranga e mura-torëve të pallateve të «Moskatit» qe e ngrohtë, e ngrohtë si në rroba të leshta. Më e ngrohtë se shtëpitë tona? As diskutohet!

Unë dhe sot nuk e di se si i siguronte ajo drutë për sobën fatlume të klasës. Ç'mundim e përpjekje i duheshin asaj për t'i gjetur, kur në shtëpi atë dimër festën më të madhe e kisha kur nona, gjyshja ime e fortë, vinte ngarkuar nga Selita me dru koçimare. Ndaj jam i sigurt që fëmijët e barkut të saj, foshnjat e mësueses, në shtëpi nuk duhej të kishin dru. Ishte vit i një varfërie të madhe, sapo kishim dalë nga lufta.

... Zefi ngrohej dhe vizatonte shokët dhe mësuesen. Aherë ajo «profetizoi» që ai do bëhej piktor i zoti. Siç tha ajo, u bë! I doli fjala asaj dhe jo ndonjërit nga ne çapaçulët, që e tallnim Zefin. Ajo na mësoi shkrimin e këndimin, pra na dha çelësin e parë të kalasë së dijes. Edhe për

kaq njeriu duhet t'i jetë mirënjohës përjetë asaj. Por ajo na mësoi edhe diçka tjetër, që është leva e Arkimedit në jetë; na mësoi të duam shoqi-shoqin dhe të çmojmë gjithnjë njeriun e punës. Ajo kishte një kult në jetën e vet: punën! Me të ajo maste vlerën e kujtdo dhe mbi të gjitha vinte atë që e mundonte më shumë, atë punën «e thjeshtë» të mësuesit. Unë nuk e di dhe sot e kësaj dite ç'aktiviste që ajo në lagje. Por e di mirë që asaj nuk ia hante qeni shkopin kur ishte halli për ne fëmijët e saj dhe punën. Ajo na foli e na tregoi për gjyqin e armiqve të popullit. Nuk kishim as gazetë e as radio ta merrnim vesh. Ajo e kërkonte nënën time në mbrëmje vonë në shtëpi apo në turnin e dytë në fabrikë për t'i thënë se djali mësonte mirë, apo mund të mësonte edhe më shumë. Ajo nuk hante «miqësi» e as i vinte nota më të mira sesa neve çunit të ministrit apo gjeneralit, kur ai s'që i përgatitur e përgjigjej keq. Ajo i vinte «dyshkë tamam» kujtdo e kurdo që e kishte hak.

Prej saj mësuam atë që «kush humbet kohën kot, është ose budalla, ose maskara!». Me siguri, ky mësim proverbial i saj na vlejti të gjithëve neve, nxënësve të saj. Ne patëm fat të madh me të.

Vitet shkojnë dhe ne mbetemi çdo ditë borxhëlinj para saj. Në atë kohë kur ajo na mësonte shkrimin dhe këndimin e gjuhës së mëmës dhe të tatës, Partia ngulte këmbë që «mësuesi është çdo gjë...!» Ajo ishte nga ata mësues që e zbatonte mirë porosinë e shokut Enver se «mësuesit duhet të jenë pjesëtarë aktivë të punës së madhe shoqërore-politike dhe kulturore-arsimo-

re në mes të popullit dhe të fitojnë dashurinë dhe respektin e popullit tonë.» Ajo ishte e tillë dhe gëzonte atë autoritet të lartë, të domosdoshëm të mësuesit, jo me vrazhdësinë e rreptësinë e dembelit dhe të të paaftit, por me mundin dhe merakun e saj të thellë.

E kujtojmë sot atë si një njeri të nderuar, zonjë grua, të mençur sa hahej me burrat; e kujdesshme për ne sa hahej me nënat tona; këshilltare sa gocat tona, kur rriteshin, i merrnin mendimin për hapin e madh të jetës, martesën. Nuk është nostalgjia e natyrshme për mësuesen e parë që më shtyn të shkruaj kështu, jo, është serioziteti me të cilin ajo e trajtonte rolin e vet në shoqëri. Kam pasur, si të gjithë, dhe shumë mësues të tjerë, të cilët i kam dashur dhe respektuar, po atë, mësuesen time të klasës së parë — mbi të gjithë.

*
* *
*

Mësuesi duhet të jetë gjithnjë në pararojë të kulturës së një populli. Ky është vendi që atij i takon, por që duhet ta meritojë.

Sot arsimtarët tanë, sa i përket dijeve profesionale e nivelit arsimor, janë shumë më lart sesa ajo mësuesja jonë e parë që vinte partizane nga malet dhe sesa tërë mësuesit e atyre viteve. Kjo s'ka nevojë për kallauz. Shumica e tyre përpiqen ta ruajnë e ta pasurojnë vit pas viti edhe pasionin e mësuesve të atyre viteve, që zbritën nga malet bashkë me lirinë.

Në një klasë të parë fillore të Larushkut kam njohur një mësues që ishte artist i vërtetë në dhënien e mësimit. Shkronjat e shqipes atij i këndonin, me plot fjalën, si në skenë të teatrit të fëmijëve. Madje, do të thosha që dhe vetë kalamajtë e klasës ishin aktorë, pjesëmarrës tepër të gjallë në orën e mësimit, dhe mësuesi një regjisor i shkëlqyer. Të dëgjoje si e jepte ai mësimin, ishte një kënaqësi dhe për burrat më me kërkesa që mund të jenë. Unë u kam zili atyre fëmijëve për mësuesin e tyre.

Këtu e shtatë vjet të shkuar mësuesit e Kabashit të Pukës, Kabashit të «Lulit të vocërr» të Migjenit, mësuesit e pasionuar pas vendlindjes së nxënësve të tyre, bënë simpoziumin e parë të studimeve të toponimisë shqiptare. Nuk e teproj, ai simpozium ku kumtuan dhe akademikët, i tillë ka hyrë në shkencat tona gjuhësore. Dhe këtë traditë ata e vazhdojnë dhe sot me simpoziume të tjera. Të tjerët mund t'i bëjnë edhe më mirë, po ata qenë «kolombët» e parë.

Në Lukovë është një mësues i letërsisë që prej vitesh studion terminologjin detare të së folmes së Arbrit. Fjalori i tij jo vetëm u fut fëmijëve të shkollës dashurinë për detin, por pasuron dhe atë punën e vyer të Institutit të Gjuhësisë në Tiranë.

Shkolla «10 Korriku» në Berat me siguri, si çdo shkollë në raste festash e gëzimesh, merr urimet e veta nga ish-nxënësit e saj. Por ajo është nga më fatlumet, që merr dhurata nga gjithë Shqipëria me lloje të florës e faunës sonë për mësuesin e mrekullueshëm të biologjisë, se atje është një mësues i merituar, që bën shken-

tur pastaj nxënësit e mësuesin tok me ta se si i thonë siliciumit shqip dhe, për t'i ndihmuar, kam shtuar: cili mal është (jo një copë shtresë) me silic në fshat të tyre, dhe kanë ngritur supet të gjithë, tok me mësuesit, thua se i pyesje për viset e mikmakëve (fiset eskimeze në Groenlandë) e jo për truallin që e shkelnin përditë me këmbë, kur vetë shkolla dhe ata qëndrojnë mbi shpatin e malit me strall, pra me silic. Mund të vazhdoj kështu t'ju mbaj gjatë, mund të tregoj edhe për mësuesen e historisë në shkollë të Barbullushit, që nuk dinte nga vinte ky emër, i cili në regjistrimet osmane e latine qysh më 1432 shfaqet si Barbarosa, ngaqë kështu pushtuesit venedikas të Shkodrës i thërrisnin banorët e tij sepse qenë të bardhë e me mjekër të kuqe, etimologji që prej kohësh e ka shpjeguar prof. E. Çabej. Por s'është puna as te mjekra e as te mustaqet e tyre, por tek ajo që ata ishin arbëreshë. Nuk ka gjë më fatkeqe për mësuesin sesa, kur ai bëhet «mik» në fshatin e vet, kur ai bëhet i huaj për hallet e të tjerëve, aherë atë s'do ta besojnë as prindërit e as fëmijët. Kështu nuk do ta respektojë njeri. Mjerë ai! Mësuesi s'mund të jetë i tillë, jo, ai duhet të punojë e të përpiqet që t'i dëgjohet fajla kudo dhe që fjala e tij të peshojë e të zërë vend mirë në shoqëri. Kjo peshë e fjalës së tij ka të bëjë dhe me autoritetin e tij, që shpesh humbet, kur ca më shumë këtë e ushqen dhe mikroborgjezi që ka pranë.

«Mësuesi nuk është zyrë e strehimit, ai s'është shitës, ai s'është i zyrave të punës, që të të sigurojë një vend të rehatshëm. Ai mëson fëmijët, u jep dije e kulturë». Por nuk mendon

kështu mikroborgjezi, prandaj dhe fërkon duart e i bie në qafë mësuesit, e godet në «thembrën» e Akilit të tij, në notën, në vlerësimin e fryrë të dijes së djalit apo vajzës së vet. Dhe bëhet pastaj mësuesi i paformuar, pa personalitet e vlerë shoqërore, pre dhe viktimë dhe i bie vlera atij dhe shkollës.

Vërtet mësuesi nuk jep as shtëpi, as punë, vërtet mësuesi mëson vetëm fëmijët, por ai bën kështu pikërisht atë më të rëndësishmen gjë, që mëson, edukon dhe rrit njerëzit e rinj, që, midis të tjerash, të mos jenë nesër-pasnesër, hatërshinj e të allishverisheve, të jenë të ndershëm e trima, të luftojnë kudo e kurdo atë mikroborgjezin e lig, që e godet shkollën në pikën e saj të dobët e do t'i vërë minën asaj. Pra, mësuesi militant rrit njerëz militantë, që së toku e mbrojnë dhe e ruajnë shkollën dhe shoqërinë të pastër e të shëndoshë siç kërkon e lufton populli me Partinë në krye.

Shoqëria ka për detyrë të ndihmojë në forcimin e autoritetit të mësuesit, por detyrë numër një kjo është së pari për vetë mësuesin. Kali i mirë e bën vetë tagjinë, prandaj dhe është detyrë e vetë mësuesit që ta ngrejë më lart dhe ta çojë më tej rolin e personalitetin e tij se haraçet, përndryshe, i paguan gjithë shoqëria. Duhet të luftojmë të gjithë që çdo mësues ta kemi gjithnjë të nderuar e të respektuar. Për këtë kujdes duhet bërë nga të gjithë, si nga organet e Partisë ashtu dhe nga organizmat shtetërorë dhe të mos ndodhi si me disa propozime për dekorime të Ministrisë së Arsimit e Kulturës, për titujt e lartë «Mësues i merituar» e «Mësues i popullit»,

ku flitej për shumë gjëra, por për atë se si kanë dalë nxënësit e tyre në jetë dhe ç'rol luajnë ata si veprimtarë shoqërorë s'thuhej gjë fare. Harresë, do thoni ju, Jo! Jemi para asaj që na shqetëson, që armatën e arsimitarëve duhet ta vëmë më mirë në frontin më të vështirë të luftës sot. Dhe mundësitë janë. Në Memaliaj një mësues i biologjisë, që jep mësimin mirë prej njëzet e pesë vjetësh, i ardhur atje nga një qytet i madh, luante në kontrabas në koncertin e klubit «Mustafa Matohiti» bashkë me nxënësit e tij, që i kishte mësuar vetë dhe nxënësit e tij i binin mandolinës. Për të s'kujtohet njeri për ta dekoruar. Por si ai janë me mijëra ata të urtit, të thjeshtit, të papërtuarit mësues, që meritojnë të gjithë titujt, por mbi të gjithë të lartin e të shenjtin titull — mësues!

Tetor 1984

Robert Ndrenikës

I dashur Robert,

Të erdha në shtëpi e s'të gjeta. Ti ishe me xhirimet e filmit të ri. Urimet për fejesën e vajzës ia bëra zonjës së shtëpisë. Përderisa urimet ia bëra asaj, atëherë pse ta shkruaj këtë kartë? Ja pse, miku im Robert!

Para dy-tri javësh isha në fshatrat dhe minierat e thella të Burrelit, Dibrës dhe Kukësit. Pashë si venë hallet tona të kulturës dhe artit. Takova njerëz të mirë e të zot, Servet Kosiqin e Ilir Xholin me shokë, miq të vjetër e të rinj. U kënaqa me punëra të mbara, por pashë dhe punë shkeleshko e të pagoditura. Mësova shumë e u përpoqa sa munda të ndihmoja nga Guri i Bardhë i Burrelit, ku ka lindur Pjetër Budi e deri në Kishaj të Gurit të Hasit të Kukësit, ku ka predikuar Pjetër Bogdani, që këtë vit i kujtojmë

300-vjetorin e vdekjes. Pra, pashë viset tona, nga Budi te Bogdani, dhe u kënaqa.

Më erdhi mirë që në shumë takime e biseda, kur binte fjala për artistët, njerëzit shpesh të zinin në gojë dhe ty. Ti mbase nuk e di sa njiheni dhe në ato anë të thella, ju, mjeshtrit e filmit. Televizori ju bën shërbesë të madhe për këtë. Robert, duhet të jesh nga më fatlumët. Bukur shpesh, ata që takova përgjërroheshin për lojën tënde. Aq sa, disa herë, edhe unë, i thekuri për interpretimet e tua, jam gjendur bosh për ndonjë rol filmi që s'ta mbaja mend. Nuk ta fsheh dot, të pata zili dhe më erdhi keq që s'u bëra aktor. Por tani është tepër vonë të ndërroj zanat dhe rolin tim edhe sot po e luaj me atë që kam, me penë.

Merakun që më ha, mund të mos e shprehja në letër. Mund të takoheshim e të bisedonim por jo në klubin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, se Tirana s'vuan për lokale.

Por po i bie pragut të dëgjojë dera

Në Zall-Dardhën e Dibrës, buzë Drinit, ndanë Rrugës së Rinisë Kukës-Peshkopi, të rrahur pak nga makinat, sapo ish ndërtuar një shkollë e re e mesme, bujqësore e gjimnaz bashkë. Shkollë e bukur shumë, me mësues dashamirë të zjarrtë të kulturës dhe nxënës të etur për art, tamam sfungjer i pangopur. Këtë vit atje festohet 40-vjetori i ansambilit folklorik të tyre. Sa për ta ditur, shumë nga këngëtarët me nam të Dibrës janë nga Zall-Dardha. Pra, shkurt muhabeti, janë fshat që s'kanë nevojë për kallauz.

Më gëzoi sa s'thuhet kopshti botanik i shkollës, biblioteka e pasur e saj, më preku thellë

mirësjellja, pastërtia dhe kureshtja e rrallë e të rinjve. Veç më trishtoi e më pikoi në zemër muzëu i fshatit, që ë kishin lënë të mjerë dhe të harruar. Por jam i bindur që, me siguri, tashmë do të kenë vënë dorë mbi të. Janë njerëz të besës dhe fjalën e dhënë e mbajnë.

Por ajo që më «patakxi», siç thonë mëmat tonë të ërta, ishte dëshira e madhe e nxënësve për të qëndruar më gjatë e për të bërë një bisedë për lefërsinë dhe artet. Kjo lloj kërkese, natyrisht, s'të habit dhe është diçka krejt e natyrshme, kudo sot te ne. Por më shushatën fare kur më thanë motivin e këmbënguljes së tyre; këta djem e vajza 18-vjeare ende s'kishin takuar shkrimtarë e artistë të gjallë. Tamam kështu, «të gjallë»

Pra, ato donin të këmbenin dy fjalë me një njeri të librave e të artit. Dhe më qëlloi shorti mua! Desha s'desha, qëndrova e bisedova paksa, piva një kafe me ta. Kohë s'kisha të qëndroja gjatë. Më prisnin shokët në Kukës dhe s'doja t'i lija në rrenë. Këtë e pranuan dhe ata, miqtë e Zall-Dardhës, dhe biseda me ta qe e shkurtër, por një dialog i këndshëm; ata pyet e unë përgjigju! Fati im i mirë dhe i keq bashkë, atë ditë qeshë «viktimë» jotja dhe e shokëve tanë artistë e shkrimtarë, që s'kishin shkelur kurrë në Zall-Dardhë. Ja kështu, Robert Ndrenika, bëja të ikja dhe s'ika.

Atje më pyetën prapë dhe gjatë për ty, të njihnin më shumë nga ekrani i vogël i televizorit sesa nga ai i madh i kinemasë. Po të jap të fjalat. Të presin!

Do ta kisha harruar këtë vëmendje të veçantë të çunave dhe gocave të Zall-Dardhës për

artistët dhe shkrimtarët, apo mbase do ta kishin marrë si një dëshirë të nderimit disi të fryrë, e do të ngushëllohesha me atë që, siç dëgjojmë, e na thonë, ta zëmë për të vërtetë, s'ka se si çdo fshat, nga 2800 që ka Shqipëria, ta vizitojnë artistët e shkrimtarët tanë, ca më tepër Zallin e Dardhës buzë Drinit, në çip të Shqipërisë.

Por jo, nuk qe e thënë kështu. Emri yt më ndoqi pas përsëri! U gjenda në Krumë të Kukësit, që ka një nga konviktet më të moçme të Shqipërisë. Merre me mend, ka qenë, thonë, atje dhe Avni Rustemi dhe Ali Kelmendi. Edhe këtu godina është e re, me dritë, paçka se s'kish nikoqire të afta që ta mbanin nuse, si e re që ishte. Nejse, nuk e kam këtu hallin. Në fjetoret e konviktorëve u hasa ballazi prapë me ty e shokët e shoqet e tu artistë. Por tani me fotografitë tuaja, të varura në mure si ikona. Këtë e has shpesh dhe në kabinetet e letërsisë në shkolla, krahas Naimit, Migjenit, De Radës. Brezi i ri e zakone të reja. Herë më dilje përpara me ngjyra e herë pa ngjyra, herë plak e herë djalë, herë fshatar e herë qytetar, herë me shkollë të lartë e herë fare pa shkollë, herë i qeshur e herë i zemëruar (sipas roleve që luan), prerë me merak nga revistat «Skena dhe ekrani» dhe «Ylli». Të shihja në muret e konviktit të Krumës dhe m'u fanëps e m'u kujtua fëmijëria, kur mblidhnim fotografitë e copat e filmave të huaj. Ishim çunakë të vegjël, dilnim nga lufta e për ne kishin vlerë më shumë trimat sesa bukuroshet, qofshin ato dhe yjet e botës. Apo ndoshta ishim jetimë dhe mungesën e baballarëve të vrarë e kompensojmë me fotografitë e «heronjve» të filmave. Ndoshta, ku ta

dish tani! Veçse ne atëherë e dinim mirë, as ëndërronim e as na shkonte ndër mend të takonim një ditë artistët e filmave së gjalli. Na mjaftonin fotografitë. Hane Hollivudi e hane Bishti i Lanës!

Por çunat e gocat e sotme me të drejtë s'mendojnë kështu. Nuk është se u mungon «modestia» e kanë pretendime shumë! Jo! Është realiteti i sotëm që i bën me më shumë kërkesa e dëshira. Se ja që dhe në Krumë të rinjtë prapë e prapë më thanë: që kishin mall për një artist të gjallë. Kjo, pak a shumë, më ndodhi dhe në Shënmëri dhe në Peshk të Martaneshit. Disa herë u bëra kosisoi zëdhënësi yt dhe i shokëve tanë të letërsisë dhe artit, nara auditorëve të improvizuar rastësisht, por tepër pasionantë!

Unë e di fort mirë që ti dhe shokët t'eni të ngarkuar shumë. Unë e di edhe më mirë që dhe ju lëvizni në ovtete e rrethe të ndrvshme. Ti ca më shumë. Por Shoqëria s'është vetëm Tirana dhe as ovtetet e saj. Është fshati mbi të gjitha, që na mban me bukë, ianë edhe malët dhe minierat e Verilindjes, që na mbajnë me krom e bakër e minerale. Atie të presin e kanë mall për tv dhe shokët e tu e të mitë, artistë e shkrimtarë, piktorë e kompozitorë, skulptorë e aktorë, gjithë ç'janë. Nuk ka nevojë për shfaqje të mëdha, të rënduara me rekuizitë elefantinë, kanë nevojë t'ju shohin e t'ju dëgjojnë, në rastin tënd, qoftë me një skeç a recitim të bukur, qoftë për një kafe a një këmbim llafi të mençur, qoftë për një dialog si me njerëz të gjallë. Ata e meritojnë këtë nder dhe nderi ynë po kështu e kërkon. U jemi borxhlinj përjetë. Ata kanë ç'të mësojnë

nga ne; por dhe ne kemi shumë më tepër ç'të përfitojmë prej tyre.

Në këtë jetë s'mbetet borxh pa larë. Por jeta është e shkurtër dhe zanati i gjatë. Mos humb kohën kot! Këtë nuk e them unë, s'është nga xhepi im. Këtë e ka thënë greku i madh, Hipokrati, që shëronte njerëzit.

Të mos e humbim kohën kot, pra, Robert, të lëvizim, se lëvizja është vetë jeta. Të vemi tek ata, që na duan e na çmojnë më shumë. Në pastëri burokratë që të të pengojnë e të të vënë stërkëmbësin, që duan të mos të lejojnë të marrësh «udhën e gjatë», tregoj vëndin! Vëru kufirin te thëna!

Arti i madh lind gjithnjë me gëzimet e mëdha ose me hidhërimet e thella të njerëzve të punës. Të parin ta garantoj në këto vise që të presin, të dytin s'ta uroj kurrë!

Gjithë të mirat e zënë e mirë përherë!

Janar 1989

P È R M B A J T J A

Kur mbaron dhe kur vdes burri	5
Gabelja e Skavicës	37
Pushkatimi	65
Bora e parë	90
Portokalli i Alpeve	106
Heshtja e gjatë sa një shekull	124
Mos e zgjidhni atë!	146
Fëmijët e Apripës	157
Ç'të rrëfej më për këto gra?	167
Mos ik nga Vlora, pa takuar Nestorin!	177
Njeriu i 110 fytyrave	184
Nderim për mësuesin	197
Robert Ndrenikës	207